

SI NDËRVEPROJNË MIGRIMI, KAPITALI NJERËZOR DHE TREGU I PUNËS NË KOSOVË

Ardiana Gashi

Qershor 2021

Report drafted by Ardiana Gashi for the European Training Foundation, under the supervision of the Vienna Institute for International Economic Studies (wiiw).

Manuscript completed in May 2021.

The contents of this report are the sole responsibility of the author and do not necessarily reflect the views of the ETF or the EU institutions.

© European Training Foundation, 2021

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged.

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
Parathënie.....	4
Përmbledhje ekzekutive	5
1. Hyrje	8
2. Faktet themelore mbi trendet dhe politikat e migrimit.....	10
2.1. Roli i jashtëzakonshëm i Gjermanisë si vendi kryesor i destinacionit	16
2.2. Politikat e migrimit në Kosovë	17
3. Shpërndarja e fuqisë punëtore dhe migrimi.....	19
3.1. Mospërputhja ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë	21
3.2. Kushtet e pakënaqshme të punës	22
3.3. Punësimi dhe papunësia sipas profesionit: karakteristikat kryesore.....	24
4. Formimi dhe migrimi i kapitalit njerëzor	26
4.1. Rrjedha e migrimit sipas nivelit arsimor	27
4.2. Programet për arsim dhe aftësim të (bashkë)financuara ndërkombëtarisht	28
4.3. Efekti i përzier i migrimit në arsim	31
5. Marrëdhëniet trekëndore	32
6. Ndikimi i pandemisë COVID-19	34
7. Konkluzionet dhe implikimet politike.....	34
7.1. Konkluzionet	34
7.2. Implikimet politike.....	36
Referencat.....	39
Aneksi 1 – Analiza statistikore e qasjes së grupit	43
Aneksi 2 – Tabelat statistikore	44
Aneksi 3 – Sistemi i Kosovës për arsim dhe aftësim.....	49

Lista e shkurtesave

ADC	Korporata Austriake për Zhvillim
ALLED	Përafrimi i arsimit dhe aftësimit me nevojat e tregut të punës
ALMPs	Politikat aktive të tregut të punës
BMZ	Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
DESTATIS	Zyra Federale Gjermane e Statistikave
APRK	Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës
EMIS	Sistemi i informacionit për menaxhimin e punësimit
EPIK	Instituti i Politikave Evropiane
EPPC	EP & Partners Consultancy (burimet njerëzore, trajnimi, stafi me qira)
ERP	Programi i Reformave Ekonomike
ETF	Fondacioni Evropian për Trajnime
EU	Bashkimi Evropian
FES	Friedrich-Ebert-Stiftung (Fondacioni Friedrich Ebert)
FDI	Investimi i huaj i drejtpërdrejtë
FSSHK	Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës
GAP	Instituti GAP për studime të avancuara
GDP	Prodhimi i Brendshëm Bruto
GIZ	Korporata Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ABF	Anketa e Buxhetit të Familjes
IAB	Instituti për hulumtime të punësimit (Gjermani)
ICM	Lëvizshmëria ndërkombëtare e kredive
ICT	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
IPA	Instrumenti për ndihmën e para-anëtarësimit
ISCO	Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Profesioneve
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KHDR	Raporti i Zhvillimit Njerëzor i Kosovës (UNDP)
KIESE	Treguesit kryesorë të arsimit, shkathtësive dhe punësimit (ETF)
AFP	Anketa e fuqisë punëtore
LuxDev	Agjencia e Luksemburgut për Zhvillim
MCC LFTUS	Anketa e fuqisë punëtore dhe shfrytëzimit të kohës e Korporatës Sfidat e Mijëvjeçarit
MEST	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MLSW	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NEETs	Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk shkojnë në shkollë apo në trajnim
NQA	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit
RPL	Njohja e mësimit paraprak
RCC	Këshilli për bashkëpunim rajonal
SILC	Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetës
STEP	Shkathtësitë drejt studimit të punësimit dhe produktivitetit (Banka Botërore)
STIKK	Shoqata e TIK-ut e Kosovës
SVR	Këshilli i Ekspertëve të Fondacioneve Gjermane për Integrim dhe Migrim
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
AAP	Arsimi dhe aftësimi profesional
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
WBR	Rregullorja e Ballkanit Perëndimor
wiiw	Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare

Parathënie

Vendet e Ballkanit Perëndimor karakterizohen nga popullsia në rënie e shtyrë nga niveli i ulët i lindjeve, plakja e popullsisë dhe migrimi i vazhdueshëm. Emigrimi nga rajoni ka qenë konstant që nga vitet 1990, duke evoluar nga migrimi i parregullt i fuqisë punëtore me kualifikim të ulët e të mesëm deri te ribashkimi i rregullt familjar, studentët ndërkombëtarë dhe, së fundi, migrimi i fuqisë punëtore me kualifikim të lartë.

Në vitin 2020, Fondacioni Evropian për Trajnime (ETF), bashkë me Institutin e Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (wiiw), filluan një studim rajonal të titulluar “Dinamikat e migrimit nga perspektiva e kapitalit njerëzor në Ballkanin Perëndimor”. Qëllimi i studimit është të hidhet dritë mbi marrëdhëniet trekëndore ndërmjet formimit të kapitalit njerëzor, tregjeve të punës dhe migrimit, dhe të përcaktojë si ndikon funksionimi aktual i sistemit arsimor dhe i tregut të punës në migrimin në secilin vend.

Ky raport, që është një nga gjashtë raportet e vendit të prodhuara brenda kontekstit të studimit, u hartua nga Ardiana Gashi duke u bazuar në një kornizë të përbashkët analitike të zhvilluar nga ETF-ja dhe wiiw-ja. Studimi ka përfshirë një analizë të gjerë të literaturës dhe të raporteve ekzistuese dhe zhvillimin e mjeteve për ta analizuar rrjedhën dhe të dhënat për numrin e migrantëve kosovarë duke u bazuar në statistikat ndërkombëtare në dispozicion.

Një analizë e veçantë statistikore e bazuar në të dhënat nga Anketa e Fuqisë Punëtore të Kosovës (2015–2019) është realizuar duke e përdorur qasjen e grupit, të udhëhequr nga Sandra Leitner e wiiw-së, e cila i prodhoi gjetjet kryesore të përdorura në këtë raport. Autorja gjithashtu ka zhvilluar intervista të hollësishme me përfaqësuesit e Agjencisë së Punësimit të Kosovës.

Draft raporti përfitoi nga diskutimet, udhëzimet dhe komentet e gjera të bëra nga ekipi i wiiw-së (Michael Landesmann, Hermine Vidovic, Sandra Leitner, Isilda Mara) dhe ekipi i ETF-së (Ummuhan Bardak, Mariavittoria Garlappi, Cristiana Burzio, Evelyn Viertel dhe Mirela Gavoci). Raporti përfundimtar u prezantua më 27 maj 2021 në një uebinar online për palët kryesore të interesit në vend, përfshirë përfaqësuesit e institucioneve publike dhe të shoqërisë civile, dhe hulumtuesit.

ETF-ja dëshiron t’i falënderojë të gjitha institucionet dhe individët në Kosovë që kanë ndarë informacione dhe mendime gjatë gjithë studimit dhe gjatë uebinarit online të ETF-së. Në veçanti, ETF-ja, wiiw-ja dhe autorja u janë mirënjohës Agjencisë së Punësimit të Kosovës, si dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës, që siguruan qasje në bazën e të dhënave të Anketës së Fuqisë Punëtore (2015–2019) në dhomën e tyre të sigurt, sipas rregullave të tyre të brendshme. Raporti gjithashtu ka përfituar nga komentet dhe sugjerimet e profesorit William Barlett, nga LSE-ja, dhe Nora Latifi Jasharit, nga Instituti GAP për Studime të Avancuara. Ky raport nuk do të ishte i mundur pa kontributet e përmendura më lart.

Përmbledhje ekzekutive

- Emigrimi në Evropën Perëndimore mbetet karakteristikë e rëndësishme demografike e popullsisë së Kosovës, numri i tyre vlerësohet të jetë gati sa gjysma e popullsisë vendore. Shifrat zyrtare, që bazohen në të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, tregojnë se rreth 550.000 kosovarë jetojnë jashtë vendit, mbi 35% e të cilëve jetojnë në Gjermani, pasuar nga Zvicra (rreth 23%), Italia, Austria dhe Suedia.
- Të dhënat më të reja të Eurostat-it nga viti 2019 konfirmojnë se 321.486 shtetas kosovarë kanë leje të vlefshme qëndrimi brenda BE-28, me shumicën e mbajtësve të lejeve që jetojnë në Gjermani (58%) dhe Itali (15%). Përbërja e tyre ka ndryshuar edhe më shumë në rastin e lejeve të qëndrimit për herë të parë në BE, të lëshuara për kosovarët në vitin 2019: 69% e kosovarëve që emigruan për herë të parë shkuan në Gjermani, ndërsa 9% shkuan në Kroaci dhe 9% në Slloveni. Për dy vendet e fundit, numri i emigrantëve kosovarë në Kroaci u rrit nga 339 në vitin 2017 në 6.369 në vitin 2019, ndërsa shifra për Slloveninë u rrit nga 2.016 në 5.862 gjatë të njëjtës periudhë. Arsyet e lidhura me punën për migrim po rriten me një ritëm të shpejtë, duke përbërë 38% të lejeve për herë të parë në BE në vitin 2019 krahasuar me 17% në vitin 2010, ndërsa arsyet e lidhura me familjen kanë rënë nga 63% në 41% gjatë të njëjtës periudhë.
- Siç tregojnë qartë shifrat, Gjermania është një nga vendet kryesore të destinacionit. Rritja e fundit filloi në vitin 2015 me Rregulloren e Ballkanit Perëndimor, dhe Ligji i Gjermanisë për imigrimin e kualifikuar, i vitit 2020, i ka lehtësuar procedurat për punëtorët e kualifikuar, duke vënë leje pune në dispozicion për këdo që arrin ta marrë një kontratë pune në një nga profesionet e mbuluara. Lidhjet e forta me diasporën në Gjermani do ta mbështesin emigrimin e kosovarëve pas përfundimit të krizës COVID-19. Megjithatë, vendet e tjera, si Kroacia, Sllovenia dhe Franca, po bëhen tërheqëse për kosovarët.
- Kosova tani ka popullsinë më të re në Evropë, gjysma e popullsisë së saj është nën moshën 25 vjeçare. Megjithatë, një pjesë e madhe e kësaj pasurie mbetet e papërdorur dhe ka tendencë të lartë për të emigruar. Flukset e emigrimit neto janë më të fortat ndërmjet grupmoshave 15–19, 20–24 dhe 25–29 vjeç. Shtytësi më i rëndësishëm i këtij modeli është situata e dobët në tregun e punës për të rinjtë, e cila pasqyrohet me një shkallë jashtëzakonisht të lartë të papunësisë së të rinjve, me gati 50% në vitin 2019 dhe një pjesë në rritje e sipër e të rinjve kosovarë që nuk shkojnë në shkollë, nuk janë në punë ose trajnim (mbi 34% në vitin 2019). Vetëm një nga katër të rinj të moshës 15–24 vjeç ishte aktiv në tregun e punës në vitin 2019.
- Rezultatet e analizës së qasjes së grupit (bazuar në mikro të dhënat e AFP-së) gjithashtu konfirmojnë se rreth 53.000 kosovarë emigruan jashtë vendit në periudhën 2016–2018. Pothuaj gjysma e këtyre emigrantëve ishin kosovarë me arsim të përgjithshëm të nivelit të mesëm (26.000 persona), të pasuar nga kosovarët me arsim të ulët (17.000) dhe me arsim të lartë (11.000). Në këtë mënyrë, emigracioni neto është më i larti midis atyre me nivel të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe të ulët, kurse ata me tituj profesionalë përfundojnë imigrim neto.
- Rritja e qëndrueshme ekonomike e Kosovës nuk është përkthyer në më shumë vende pune. Tregu i punës karakterizohet nga nivelet e larta të pasivitetit dhe papunësisë, dhe nga nivelet e ulëta të punësimit. Përveç kësaj, vendet e punës në Kosovë janë të cilësisë së dobët, që karakterizohen nga mungesa e kontratave të punës, siguria e ulët në punë, kushtet e pafavorshme të punës dhe pagat e ulëta. Situata është veçanërisht e pafavorshme për gratë dhe të rinjtë, të cilët përballen me sfida të shumta kur përpiqen të fitojnë qasje në tregun e punës. Mungesa e mundësive për punësim, pagat e ulëta dhe kushtet e përgjithshme të këqija të jetesës janë faktorët kryesorë shtytës për emigrim.
- Edhe pse arritja arsimore është rritur me kalimin e kohës, cilësia vazhdimisht e dobët e arsimit dhe mospërputhja ndërmjet kërkesës për punë dhe ofertës për trajnim janë sfida urgjente për ekonominë e Kosovës. Si rrjedhojë, një pjesë e madhe e individëve punojnë në punë që nuk lidhen me fushën e tyre të studimit, ndërsa punëdhënësit operojnë me punë që nuk i plotëson kërkesat e tyre. Të dhënat e pamjaftueshme sistematike për nevojat e tregut të punës dhe bashkëpunimi i kufizuar ndërmjet sistemit arsimor dhe punëdhënësve, bashkë me mungesën e një vizioni afatgjatë për sistemin arsimor, e kanë penguar Kosovën që t'i trajtojë sfidat e arsimit dhe t'i rrisë përfitimet që individët dhe vendi si tërësi mund t'i marrin nga investimi në arsim.
- Migrimi i përkohshëm për qëllime arsimore është një opsion i mundshëm për kosovarët që janë të lidhur me familjet e tyre. Duke qenë se shumica e studentëve që studiojnë jashtë kthehen në Kosovë dhe gjejnë punë të përshtatshme, këshillohet të zgjerohen ofertat për të studiuar jashtë në kritere të bazuara në merita. Disa praktika të mira përfshijnë programet e lëvizshmërisë Young Cell dhe Erasmus+, të cilat kanë kontribuar në ndërveprimin ndërmjet migrimit, kapitalit njerëzor dhe tregut të punës. Skema Young Cell, e cila financohet nga Komisioni Evropian, ka ofruar mundësi studimi për kosovarët, të cilët pas përfundimit të studimeve janë

të detyruar të punojnë për qeverinë për disa vjet. Megjithatë, përpjekjet e tjera që kërkojnë ta stimulojnë kthimin e akademikëve dhe ekspertëve nga diaspora, që mundësojnë bartjen e njohurive dhe forcimin e lidhjeve me diasporën nuk janë treguar të suksesshme.

- Një zhvillim tjetër interesant (dhe pozitiv) është fakti se nënkontraktimi i biznesit dhe shërbimeve të TI-së po bëhet trend i ri në Kosovë. Në vend që të emigrojnë jashtë vendit, disa të rinj kosovarë gjejnë punë në tregje ose kompani ndërkombëtare, të cilat jo vetëm që kontribuojnë në punësim, por gjithashtu ushtrojnë presion për ta avancuar kapitalin njerëzor në mënyrë që Kosova të bëhet një nga destinacionet më tërheqëse për biznes dhe shërbime të TI-së. Faktorët kryesorë kontribuues për sukses raportohet të jenë efektiviteti i kostos, profesionistë të TI-së shumë të kualifikuar dhe të arsimuar, shkathtësitë gjuhësore, zona e përshtatshme kohore dhe lehtësia e fillimit të një biznesi dhe e të bërit biznes. Një model i ngjashëm mund të zhvillohet dhe mbështetet edhe për sektorë të tjerë.
- Edhe pse ballafaqohet me një rrezik të njohur të emigrimit të të rinjve, qeverisë së Kosovës i mungon një politikë gjithëpërfshirëse e migrimit që i merr parasysh marrëdhëniet trekëndore ndërmjet migrimit, kapitalit njerëzor dhe tregut të punës. Në vend të kësaj, institucionet private të arsimit të lartë kanë nxituar me oferta në sërë profesione që kërkohen në tregjet e BE-së (kryesisht në sektorin e shëndetësisë në Gjermani), duke e mbështetur arsimimin e të rinjve që janë të interesuar për të emigruar. Nisma të tjera për ta përgatitur fuqinë punëtore për Gjermani përfshijnë përpjekjet e GIZ-it për të trajnuar individë të interesuar për migrim si në Kosovë, ashtu edhe në Gjermani (në sektorët e ndërtimit dhe shëndetësisë), në mënyrë që ata të mund të migrojnë më pas në Gjermani për qëllime pune.
- Kosova duhet ta zhvillojë një politikë për migrimin ekonomik dhe një qasje ndërinstitucionale për ta trajtuar atë. Ekziston nevoja për ta themeluar një organ për ta zbatuar një politikë të tillë dhe për t'u koordinuar ngushtë me të gjithë aktorët përkatës. Është me rëndësi që zhvillimet të kihen parasysh dhe politikat dhe ndërhyrjet t'u përshtaten rrethanave. Plani i veprimit për punësimin e të rinjve duhet të jetë dokumenti udhëzues për të gjitha institucionet e përfshira.
- Ndërsa menaxhimi i migrimit për punë është i rëndësishëm, fokusi kryesor duhet të vihet në krijimin e vendeve të punës (me kualifikim) në ekonominë e Kosovës. Tërheqja e investitorëve të huaj në Kosovë duhet të jetë përparësi për qeverinë e Kosovës. Për të krijuar vende pune (me kualifikim), Kosova duhet t'i mbështesë NVM-të ekzistuese, t'i shndërrojë ato në kompani me rritje të shpejtë në sektorë premtues, të zhvillojë politika industriale, të ndërmarrë hapa konkretë për të përfituar nga dhjetë "zonat ekonomike" ekzistuese dhe të planifikuara rishtas. Mësime mund të nxirren nga vendet fqinje me përvojë të ngjashme, si Maqedonia e Veriut dhe Serbia.
- Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë hapa konkretë për ta harmonizuar më mirë arsimin me nevojat e tregut të punës të vendit. Kjo kërkon krijimin e aleancave të forta me punëdhënësit dhe angazhimin e tyre të plotë e cilësor në proces. Më e rëndësishmja, nevojitet një monitorim sistematik i tregut të punës në Kosovë përmes parashikimit të nevojave të tregut të punës në sektorë të ndryshëm dhe identifikimit të mangësive profesionale. Ndonëse disa projekte diskutojnë për pilot iniciativë në këtë fushë (p.sh. planet për prodhimin e një barometri të tregut të punës), ai është larg nga profesionet dhe shkathtësitë për të cilat dihet se mungojnë për shkak të migrimit të fuqisë punëtore.
- Për shkak të shkallës shumë të lartë të papunësisë së të rinjve, të rinjve kosovarë duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë, dhe zbatimi i masave të ngjashme me skemën "Youth Guarantee" [Garancia për të Rinjtë] të BE-së është në diskutim në kuadër të Programit IPA 2022. Kjo do të thotë që të rinjtë duhet të kenë qasje në një ofertë cilësore për punësim, arsimim të vazhdueshëm, punë praktike ose trajnim brenda një periudhe të shkurtër kohore pasi të kenë mbetur pa punë ose pasi ta kenë mbaruar arsimin formal. Për këtë kërkohet përditësimi i ofertës për trajnim i Qendrave për Aftësim Profesional dhe zbatimi i trajnimit përmes ofruesve privatë, përmirësimit të udhëzimit dhe këshillimit për karrierë dhe mbështetjes për ndërmarrësi.
- Zgjerimi i politikave aktive të tregut të punës ka rëndësi të madhe për ta rritur shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, e cila ishte 40.5% në vitin 2019 dhe vetëm 21.1% për gratë. Përditësimi i skemave ekzistuese të trajnimit është një nga qëllimet e përcaktuara në Strategjinë Sektoriale 2018-2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, nuk është bërë asnjë përparim që vlen të përmendet dhe Qendrat për Aftësim Profesional vazhdojnë të ofrojnë trajnime tradicionale që kanë lidhje të kufizuar me nevojat e tregut të punës.
- E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, Kosova duhet të mbledhë të dhëna sistematike për emigrantët dhe kthimin e emigrantëve. Të dhënat e tilla do ta ofronin një bazë për hartimin e politikave të informuara.

Regjistrimi i ardhshëm i popullsisë, që është planifikuar për vitin 2022, mund ta plotësojë këtë boshllëk nëse mbledhen informatat përkatëse. Pyetësi ekzistues i regjistrimit për të afërmit e familjeve që jetojnë jashtë Kosovës për më shumë se 12 muaj kërkon informata për moshën, vitet që kur janë larguar nga Kosova, arsyet e largimit nga Kosova, marrëdhëniet me kryefamiljarin dhe shpeshtësinë e vizitave në Kosovë. Mirëpo, mund të shtohen më shumë pyetje për t'i trajtuar arritjet arsimore dhe përvojën e punësimit të emigrantëve dhe të të kthyerve kosovarë.

1. Hyrje

Republika e Kosovës i ka 1.81 milionë banorë (ASK, vlerësim i vitit 2021). Kjo është pak më shumë se numri prej 1.74 milionë banorëve të regjistruar në regjistrimin e parë të popullsisë në prill 2011 (me përjashtim të Veriut të Kosovës), që u mbajt disa vjet pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008¹. Ndërsa popullsia po rritet me një shkallë të lindshmërisë të vlerësuar në 2.4 fëmijë për grua, shkalla e rritjes së popullsisë është ngadalësuar viteve të fundit.

Rritja ekonomike e Kosovës ka qenë e qëndrueshme dhe përgjithësisht rreth 4% në vit gjatë pesë vjetëve të fundit (shih Tabelën 1). Pjesa më e madhe e zhvillimit ekonomik ka ndodhur në sektorët e tregtisë, shitjes me pakicë dhe ndërtimtarisë. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), sektori i shërbimeve përbënte 57.9% të vlerës së shtuar bruto në vitin 2019, i pasuar nga sektori industrial, përfshirë ndërtimtarinë (32.6%) dhe bujqësinë (9.5%). Përqindja e punësimit sipas sektorëve e ndjek të njëjtën renditje: 67.1% e punësimit të përgjithshëm është në shërbime, e pasuar me 27.6% në industri dhe 5.2% në bujqësi. Kosova varet shumë edhe nga remitencat nga diaspora, flukset e investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD) dhe flukset e tjera të kapitalit. Mesatarisht, flukset e IHD-ve përbëjnë rreth 4% të PBB-së². Ato gjenerohen kryesisht nga diaspora dhe drejtohen kryesisht në sektorin e patregtueshëm, posaçërisht në patundshmëri dhe shërbime.

Edhe pse rritja e PBB-së është pozitivisht e qëndrueshme, varfëria mbetet e lartë. Bazuar në Anketën e Buxhetit të Familjeve (ABF) të vitit 2017, vlerësohet se 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin kombëtar të varfërisë, dhe 5.1% jeton nën kufirin e varfërisë ekstreme. Sipas Anketës së vitit 2018 mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (SILC), 47.3% e familjeve nuk do të mund ta përballonin një shpenzim të papritur prej 100 eurove duke i përdorur burimet e tyre (ASK, 2020). Për 44% të familjeve, kryerja e pagesave të nevojshme është e vështirë ose shumë e vështirë. Tregu i punës i Kosovës karakterizohet nga kushtet e këqija të tregut të punës. Papunësia e lartë ka një histori të gjatë në Kosovë, ka arritur deri në 36% edhe në kulmin e industrializimit të vendit në vitin 1988 (Banka Botërore, 2010). Në vitin 2019, shkalla e aktivitetit (15+ vjet) ishte 40.5%, vetëm 30.1% e popullsisë në moshë pune ishte e punësuar, dhe shkalla e papunësisë ishte 25.7%. Situata në tregun e punës është veçanërisht e pafavorshme për gratë dhe të rinjtë, të cilët kanë parë vetëm përmirësime shumë të vogla me kalimin e kohës: në vitin 2019, vetëm 21.2% e grave ishin aktive në tregun e punës, vetëm 13.9% ishin të punësuar dhe 34.4% ishin të papuna. Shkalla e papunësisë së të rinjve ishte 49.4% në 2019.

Tabela 1: Treguesit makroekonomikë dhe të tregut të punës, 2012–2019

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
PBB (rritja e vërtetë vjetore)	2.8	3.4	1.2	4.1	4.1	4.2	3.8	4.0
Hyrjet e IHD-ve (milionë euro)	229	280	151	308	220	255	272	272
Remitencat (milionë euro)	516	573	622	666	691	759	801	852
Remitencat si pjesë e PBB-së, %	14.5	15.0	14.9	15.1	14.7	15.3	15.6	15.8
Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore, % e popullsisë 15+	36.9	40.5	41.6	37.6	38.7	42.8	40.9	40.5
Shkalla e pasivitetit, % e popullsisë 15+	63.1	59.5	58.4	62.4	61.3	57.2	59.1	59.5
Proporcioni i punësimit të popullsisë (shkalla e punësimit), % e popullsisë 15+	25.5	28.4	26.9	25.2	28.0	29.8	28.8	30.1
Shkalla e papunësisë, % e fuqisë punëtore 15+	30.9	30.0	35.3	32.9	27.5	30.5	29.6	25.7
Shkalla e papunësisë së të rinjve (15–24 vjeç)	55.3	55.9	61.0	57.7	52.4	52.7	55.4	49.4
Përqindja NEET e popullsisë së të rinjve (15–24 vjeç)	35.1	35.3	30.2	31.4	30.1	27.4	30.1	32.7
Punësimi i cenueshëm (të vetëpunësuar pa punëtorë dhe punëtorë të papaguar të familjes)	16.8	23.6	24.9	22.7	22.9	23.1	19.6	18.8

¹ Sipas regjistrimit të popullsisë, shqiptarët përbëjnë shumicën në Kosovë me mbi 93% të popullsisë së përgjithshme; në pakicat domethënëse përfshihen boshnjakët (1.6%), serbët (1.5%) dhe të tjerët (ASK).

² Llogaritja është bazuar në të dhënat e siguruar nga Banka Qendrore e Kosovës.

Punësimi joformal (pa kontratë të punës), %	16.6	18.0	15.5	15.5	26.3	21.5	14.0	13.4
Punësimi i përkohshëm, % e punëtorëve të përgjithshëm	73.0	68.2	71.6	72	70.5	70.6	74.5	54.7
Shkalla e varfërisë (bazuar në konsumin e familjes)	23.7	17.8	21.5	17.6	16.8	18.0	-	-

Burimi: ASK, Anketa e fuqisë punëtore 2012–2019; të dhënat për IHD-në dhe remitenca nga Banka Qendrore e Kosovës: https://bqk-kos.org/repository/docs/time_series/33%20Foreign%20direct%20investments%20-%20by%20sector.xls; rritja e PBB-së nga ERP 2018–2020; 2019–2021 dhe 2020–2022 marrë nga <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2,28>; shkalla e varfërisë, shifrat më të fundit të publikuara kanë të bëjnë me vitin 2017: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/210201560762490515/pdf/Consumption-Poverty-in-the-Republic-of-Kosovo.pdf>; remitenca si përqindje e PBB-së: <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.DT.GD.ZS?locations=XK>

Sipas regjistrimit të vitit 2011, diaspora e Kosovës vlerësohej në 703 978 persona, nga të cilët 153 978 ishin lindur jashtë vendit, duke e çuar numrin e emigrantëve të vlerësuar në 550 000. Më shumë se gjysma e emigrantëve të Kosovës jetonin në Gjermani dhe Zvicër (35%, përkatesisht 23%). Diaspora e Kosovës mbetet një kontribuuese e rëndësishme në ekonominë e vendit, me remitenca që përbëjnë rreth 15% të PBB-së (shih Tabelën 1). Remitenca kanë mbetur të rregullta gjatë krizës COVID-19. Sipas Bankës Qendrore të Kosovës (2020), fluksi i remitencave në periudhën janar-gusht 2020 ishte më i lartë se në të njëjtën periudhë në vitin 2019: 608.6 milionë euro, përkatesisht 533.1 milionë euro. Në tetor 2020, remitenca arritën në 800 milionë euro³. Megjithatë, kuptohet që remitenca kanë ndikim edhe negativ në aktivitetin e marrësve të remitencave, duke e rritur pagën rezervë dhe duke e inkurajuar pasivitetin. Sipas Anketës së fuqisë punëtore dhe shfrytëzimit të kohës, të vitit 2017, të mbështetur nga Korporata Sfidat e Mijëvjeçarit (MCC LFTUS)⁴, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për individët që u përkasin familjeve që marrin remitenca ishte 2.5 pikë përqindjeje më e ulët se për individët që u përkasin familjeve që nuk marrin remitenca, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore e të cilëve ishte 51%.


Kosovës i mungojnë të dhënat e përditësuara kombëtare për profilin e migrantëve. Përkundër përpjekjeve të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Kosova nuk ka arritur ta regjistrojë diasporën e saj. I vetmi burim zyrtar për profilin e migrantëve është regjistrimi i popullsisë i vitit 2011, por informacioni është në dispozicion vetëm sipas gjinisë, moshës dhe arsyes së migrimit.

Ky raport synon ta analizojë migrimin nga perspektiva e kapitalit njerëzor duke i bashkuar emigrimin, kapitalin njerëzor dhe shpërndarjen e fuqisë punëtore në Kosovë gjatë dekadës së kaluar. Marrëdhënia trekëndore, që është fokusi i hulumtimit tonë, paraqitet në Figurën 1.

Figura 1. Paraqitja skematike e marrëdhënies trekëndore ndërmjet kapitalit njerëzor, tregut të punës dhe migrimit

³ Intervistë me Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti.

⁴ Kjo ishte një anketë përfaqësuese e familjeve në nivel kombëtar dhe rajonal me 8 533 familje duke përdorur një mostër të shkallëzuar të klasifikuar në grupe për secilin nga shtatë rajonet e Kosovës. Të dhënat u mbledhën ndërmjet 31 marsit dhe 4 gushtit 2017, kur ekipi hulumtues mbledhi informacione për punësim për 32 742 individë dhe zhvilloi 8 604 intervista të zgjatura (Siddiqui et al., 2018).



Burimi: wiiw

Studimi është organizuar me sa vijon. Seksioni 2 i përcakton trendet themelore të emigrimit, si numri dhe struktura e emigrantëve nga Kosova, bazuar në të dhënat në dispozicion nga Agjencia e Statistikave të Kosovës dhe anketat e kohëpaskohshme të mbështetura nga institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare dhe Eurostat. Në këtë drejtim, vëmendje i kushtohet rolit të jashtëzakonshëm të Gjermanisë. Seksioni 3 i lidh trendet e migrimit me zhvillimet dhe tiparet strukturore të tregut të punës në Kosovë. Seksioni 4 i lidh trendet e migrimit me strukturën dhe rezultatet e sistemit arsimor. Në këtë seksion, ne i përdorim gjetjet e një analize të realizuar nga Sandra Leitner duke e përdorur Anketën e Fuqisë Punëtore (për më shumë informata, shih Leitner 2021). Seksioni 5 i diskuton karakteristikat kryesore brenda lidhjes së migrimit, kapitalit njerëzor dhe tregut të punës, dhe Seksioni 6 i përcakton implikimet e politikës dhe konkluzionet.

2. Faktet themelore mbi trendet dhe politikat e migrimit


Migrimi në vendet e Evropës Perëndimore ka qenë tipar i shquar i ekonomisë së Kosovës së paku që nga vitet 1960 (Banka Botërore, 2017). Siç është raportuar nga UNDP-ja (2015), kanë qenë katër valë kryesore të emigrimit, të cilat përshkruhen më poshtë:

- **Para vitit 1989:** djem të rinj të pakualifikuar, me pak shkollim, emigruan nga Kosova rurale në Gjermani dhe Zvicër si punëtorë mysafirë, kryesisht në vitet 1960. Gjatë kësaj vale, ata që emigruan dërguan para në shtëpi, të cilat u përdorën në pjesën më të madhe për të investuar në shtëpi. Fluksi i migrimit shënoi rënie në vitet 1970 kur u krijuan vende të reja pune në sektorin publik dhe në ndërmarrjet shoqërore në Kosovë. Në atë fazë, Kosova e fitoi statusin politik autonom brenda ish-Jugosllavisë dhe pozita e përgjithshme politike dhe ekonomike e shqiptarëve të Kosovës u përmirësua (shih Figurën 2).
- **Periodha prej vitit 1989 deri në vitin 1997:** Kosovës iu hoq autonomia dhe më shumë se 150 000 punëtorë shqiptarë u pushuan nga sektori publik dhe ndërmarrjet shoqërore. Të rinj të kualifikuar dhe të shkolluar nga zonat rurale dhe urbane migruan në vendet e Evropës Perëndimore për të gjetur punë dhe për të shpëtuar nga shërbimi ushtarak jugosllav. Migrimi u pa si mënyrë për t'i shpëtuar varfërisë dhe për ta përmirësuar cilësinë e jetës për anëtarët e familjes që i kishin lënë pas duke u dërguar remitenca.

- **Periodha prej vitit 1998 deri në vitin 1999:** si rezultat i luftës së vitit 1998–99, mbi 800 000 veta u larguan si refugjatë, kryesisht në Shqipëri, Evropën Perëndimore ose Shtetet e Bashkuara. Pas konfliktit (qershor 1999), Kosova përjetoi një kthim të shpejtë të popullsisë së zhvendosur.
- **Pas vitit 1999:** kjo valë emigrimi përbëhej kryesisht nga migrimi për qëllime të ribashkimit familjar, migrimi i parregullt i të rinjve të pakualifikuar dhe të pashkolluar dhe migrimi i ligjshëm (i përkohshëm) i individëve me arsim të lartë përmes marrëveshjeve për studime ose për punë.

Për sa i përket shkallës së emigrimit në të katër valët, regjistrimi i vitit 2011 tregon se migrimi më i madh ndodhi në vitet e nëntëdhjeta, që arriti kulmin gjatë luftës së vitit 1998-1999 (mbi 50 000 migrame u raportuan në periudhën dy vjeçare të konfliktit). Pas konfliktit, numri i emigrantëve filloi të bjerë (shih Figurën 2). Në vitin 2015, një numër jashtëzakonisht i madh i kosovarëve, që vlerësohet deri në 100 000, migroi bashkë me refugjatët sirianë për të kërkuar azil, kryesisht në bazë të paligjshme (FES, 2015)⁵. Kjo rritje e emigrimit u është atribuuar disa faktorëve, nga të cilët më të rëndësishmit janë: (a) kushtet e vështira ekonomike dhe politike dhe perspektivat e dobëta të punësimit; dhe (b) një lehtësim i kufizimeve të udhëtimit në Serbi, e cila e hapi një rrugë kalimi përmes Hungarisë për në BE që pritej të mbyllej përsëri në të ardhmen e afërt (Banka Botërore, 2017).

Figura 2: Emigrimi i kosovarëve, 1969–2010 (numri i njerëzve)



Burimi: ASK, 2014: Migrimi i kosovarëve.

Shënim: shih Figurën 3 për informata të tjera për periudhën pas vitit 2010, por sipas një baze tjetër të të dhënave.

Kosova ka popullsinë më të re në Evropë, por kjo pasuri është shumë e papërdorur. Sipas vlerësimeve të ASK-së, në vitin 2020, 68% e popullsisë ishte në moshë pune (15-64 vjeç), 21.2% ishin nën 15 vjeç dhe vetëm 10.8% ishin 65 vjeç ose më të vjetër (ASK, 2021)⁶. Ndërsa kjo lë të kuptohet që një pjesë e madhe e popullsisë mund të kontribuojë në ekonomi, kjo gjithashtu lë të kuptohet se ekziston një numër i madh i njerëzve që mund të migrojnë për qëllime pune nëse nuk ka mundësi pune në vend.

Sipas Eurostatit, në vitin 2018 ishin 321 486 shtetas të Kosovës me leje të vlefshme qëndrimi brenda BE-28, që është rreth 17 000 më shumë se në vitin 2017 (shih Tabelën A1). Shumica e atyre që kishin leje qëndrimi në BE-28 jetonin në Gjermani (58%) dhe Itali (15%). Gjatë periudhës 2013–2017, rreth 40 000 shtetas të Kosovës e fituan shtetësinë në BE-28 (shih Tabelën A2). Në vitin 2018, kishte 3 295 azilkërkues nga Kosova në vendet e BE-28, duke pasqyruar një rënie të ndjeshme nga viti 2014 dhe 2015 kur ishin regjistruar 34 115, përkatësisht 66 885 kërkesa (Eurostat, 2019). Siç tregon Figura 3, në vitin 2019 kishte 43 677 leje të lëshuara për herë të parë në BE-28 (shih


⁵ Vala e emigrimit u nxit nga një kanal i hapur përmes kufirit serbo-hungarez, i mbështetur nga një rrjet i trafikantëve. Raportet e mediave e përshpejtuan vendimin për të emigruar, që e përshkruanin kanalin e emigrimit si të lehtë dhe të lirë.

⁶ Për krahasim, pjesa e atyre nën moshën 15 vjeç përbënte 15.1% në BE-27 në vitin 2020:

<https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/tps00010/default/table?lang=en>

Tabelën A3 për leje sipas vendeve), 26% më e lartë se në vitin 2018 (34 591 individë). Gjysma e lejeve për herë të parë janë lëshuar nga Gjermania.

Figura 3: Lejet për herë të parë për qytetarët kosovarë në BE-28



Emigrimi ka qenë një karakteristikë e rëndësishme demografike e popullsisë së Kosovës. Sipas Eurostatit, ndryshimi i popullsisë në lidhje me migrimin u vlerësua të jetë minus 11.9% në vitin 2018 (shih Tabelën 2, informata të hollësishme për parashikimet e popullsisë dhe përbërjen e moshës janë dhënë në Tabelat A14–16).

Tabela 2: Popullsia dhe migrimi jashtë Kosovës, 2011–2019

	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Popullsia më 1 janar (mijëra)	1 794	1 780	1 816	1 821	1 805	1 772	1 784	1 799	1 796
Ndryshimi natyror i popullsisë (numri)	20 515	20 426	22 192	18 295	16 392	14 921	14 681	18 562	n.d.
Migrimi neto dhe korrigjimi statistikor (numri) ⁷	-34 674	15 159	-17 167	-33 982	-49 732	-2 994	294	-21 402	n.d.
Ndryshimi i popullsisë si rezultat i migrimit (për 1000 banorë)	-19.4	8.4	-9.4	-18.7	-27.8	-1.7	0.2	-11.9	n.d.

Burimi: Eurostat (kodi i të dhënave në internet: demo_gind)


Sipas regjistrimit të vitit 2011, përbërja gjinore e popullsisë migrante të Kosovës ishte 56.7% meshkuj dhe 43.3% femra (ASK, 2014)⁸. Në përgjithësi, 80.6% e emigrantëve i përkisnin grupmoshës 15–64 vjeç: më konkretisht, 47% e emigrantëve ishin 25–44 vjeç, 12.7% ishin 30–34 vjeç, dhe vetëm 1.3% ishin më të vjetër se 65 vjeç. Vlerësimet e prodhuara nga ASK-ja në vitin 2017 vunë në pah se 62.7% e migrimit neto ishin meshkuj, ndërsa 37.3% ishin femra (ASK, 2017). Sipas regjistrimit të vitit 2011, pjesa më e madhe e emigrantëve deri në vitin 2011 i përkiste grupmoshës 30–39 vjeç, që përbënte rreth një të katërtën e të gjithë emigrantëve (shih Figurën 4). Sipas vlerësimeve të vitit 2017 të migrimit neto për periudhën 2011–2016 (shih Figurën 5), përqindja më e lartë i

⁷ Migrimi neto është ndryshimi ndërmjet numrit të imigrantëve dhe numrit të emigrantëve. Migrimi neto plus rregullimi statistikor është nxjerrë duke e marrë dallimin ndërmjet ndryshimit të përgjithshëm të popullsisë dhe ndryshimit natyror. Statistikat mbi 'migrimin neto plus rregullimin statistikor' ndikohen nga të gjitha pasaktësitë statistikore në të dy përbërësit e ekuacionit, veçanërisht ndryshimi i popullsisë. Nga një vend në tjetrin, 'migrimi neto plus rregullimi statistikor' mund ta mbulojë, përveç dallimit ndërmjet migrimit të brendshëm dhe atij të jashtëm, çdo ndryshim tjetër të vërejtur në shifrat e popullsisë ndërmjet 1 janarit për dy vjet rresht që nuk mund t'u atribuohet lindjeve, vdekjeve, imigrimit dhe emigrimit.

⁸ Në vitet 2000–2004, përbërja gjinore ishte mjaft e barabartë, ndërsa në periudhën 2005–2010, femrat mbizotëruan në emigrim, duke përbërë 52.9% të emigrantëve krahasuar me 47.1% që ishin meshkuj, me martesat/bashkimin familjar që raportoheshin si një nga arsyt kryesore për emigrim (ASK, 2014).


përkiste grup moshës 20–30 vjeç. Shifrat arritën kulmin në moshën 25 vjeç dhe u ulën në mënyrë të vazhdueshme pas kësaj, duke u bërë të papërfillshme mbi moshën 55 vjeçare (ASK, 2017, f. 19). Kjo gjendje konfirmohet edhe nga rezultatet e marra nga qasja e grupit, e zhvilluar dhe e realizuar si pjesë e këtij projekti.

Figura 4: Numri i emigrantëve sipas grupmoshës, në % (regjistrimi i popullsisë i vitit 2011)



Burimi: ASK, 2014

Figura 5: Migrimi neto sipas grupmoshës dhe gjinisë (në %), 2011–2016




Burimi: ASK, 2017

Prandaj, grupet më të reja e kanë tendencën më të lartë për të emigruar. Qasja e grupit (Leitner, 2021)⁹, e cila përdor mikro të dhënat e AFP-së për Kosovën (2016–2018), tregon se periudha prej vitit 2016 deri në vitin 2018 karakterizohet nga emigrimi i konsiderueshëm neto, i cili vlerësohet në rreth 53 000 njerëz në përgjithësi. Me mbi 20 000 njerëz, emigrimi neto ishte më i larti midis grupeve më të reja, veçanërisht tek ata në fillim të njëzetave deri në fillim të tridhjetave (d.m.th. grupmoshat 15–19 dhe 20–24 vjeç) ndërmjet vitit 2016 dhe 2018 (shih Figurën 6). Një shtytës i rëndësishëm që qëndron prapa këtij modeli është situata e dobët në tregun e punës për të rinjtë, veçanërisht një shkallë jashtëzakonisht e lartë e papunësisë së të rinjve dhe perspektivat e dobëta për punësim në

⁹ Për metodologjinë, shih Aneksin I.

të ardhmen. Nga ana tjetër, kishte imigrim neto ndër dy grupmoshat më të vjetra, veçanërisht grupmoshës së dytë më të vjetër të njerëzve, d.m.th. grupmoshës 30–34 vjeç, ndërmjet vitit 2016 dhe 2018.

Figura 6: Migrimi neto sipas grupmoshës, 2016–2018



Burimi: Leitner (2021), llogaritjet janë bazuar në të dhënat e AFP-së, të siguruar nga ASK-ja.

Shënim: Kllapat e moshës i referohen moshës në fillim të periudhës në vitin 2010. Prandaj, të gjitha grupmoshat janë ndërmjet gjashtë dhe tetë vjeç deri në periudhën 2016-2018. Qasja e grupit e përaftron migrimin neto përmes ndryshimeve në madhësinë e grupit ndërmjet dy vjetëve radhazi. Prandaj, viti 2016 – viti i parë i raportuar këtu – i referohet ndryshimit ndërmjet vitit 2015 dhe 2016. Numrat negativë tregojnë emigrimin neto, kurse numrat pozitivë tregojnë imigrimin neto.

Për shkak të mungesës së të dhënave arsimore në raportet e ASK-së, profili arsimor i migrantëve bazohet në të dhënat e mbledhura përmes anketave. Një anketë e Pulsit Publik 2015 (UNDP, 2015) për emigrantët që u larguan nga Kosova në gjashtë muajt para shtatorit 2015¹⁰ zbuloi se shumica ishin burra (75%). Për sa u përket niveleve arsimore, 77% kishin të kryer shkollën e mesme të lartë, të pasuar nga ata që kishin kryer vetëm shkollën fillore (13%). Vetëm rreth 10% e tyre kishin diplomë universitare ose të arsimit të lartë.

Emigrimi i punëtorëve të kualifikuar përbën një sfidë të rëndësishme për perspektivat afatmesme ekonomike (KE, 2020a). Kjo është posaçërisht e vërtetë për profesionistët shëndetësorë. Të dhënat e paraqitura në Tabelën 3 tregojnë se Kosova ka vetëm 170 mjekë për 100 000 banorë, 22.6 dentistë, 29.7 farmacistë, 552.6 profesionistë të infermierisë dhe 4.9 mami. Këta numra janë më të ulët se në vendet fqinje. Paga mujore e mjekëve të specializuar është 611 euro, ndërsa infermierët paguhen ndërmjet 377 dhe 425 euro. Gjatë nëntorit 2020, një numër shtesë i mjekëve dhe i personelit tjetër mjekësor u punësuan, dhe Ministri i Shëndetësisë theksoi se edhe 1 600 mjekë e infermierë të tjerë do të punësohen gjatë mandatit të tij.

Tabela 3: Personeli shëndetësor në raport me numrin e popullsisë (numri për 100 000 banorë), 2017/2018

	Mjekë	Dentistë	Farmacistë	Profesionistë të infermierisë	Mami
EU-27 ⁽¹⁾	372.0	74.0	89.0	577.0	38.0
Mal i Zi ⁽²⁾	276.4	4.7	19.3	488.6	39.1
Serbi ⁽³⁾	295.9	27.5	28.0	83.1	36.1
Bosnje-Hercegovinë ⁽⁴⁾	211.4	24.2	13.0	567.0	30.1
Kosovë	170.0	22.6	29.7	552.6	4.9

¹⁰ Anketa përdori një mostër shumëfazëshe të 1 306 ekonomive familjare përfaqësuese në Kosovë. Intervistat u zhvilluan me individë të moshës 18 vjeç e lart.

(¹) 2017. Vlerësime të rrumbullakësura bazuar në periudhën më të afërt të referencës në dispozicion për secilin shtet anëtar të BE-së. Shifra për profesionistët e infermierisë nuk i përshin Belgjikën, Çekinë, Letoninë dhe Holandën.

(²) Dentistët: vetëm për nivelin terciar të kujdesit shëndetësor të hapur për të gjithë qytetarët e siguruar.

(³) 2017.

(⁴) 2017. Personeli që punon në institucione publike.

Burimi: Eurostat (kodet e të dhënave në internet: hlth_rs_phys, hlth_rs_prs1, hlth_rs_prsns and T01 demo_pjan)

ipas të dhënave të regjistrimit të vitit 2011, mbi 35% e popullsisë së përgjithshme të emigrantëve të Kosovës jetonte në Gjermani, e pasuar nga Zvicra (rreth 23%), Italia (mbi 7%), Austria (5.6%) dhe Suedia (5.1%). Sipas Eurostatit, në vitin 2019 tri vendet kryesore pritëse të BE-28 për migrantët nga Kosova me leje të vlefshme qëndrimi ishin Gjermania (58.1%), Italia (14.6%) dhe Austria (7.6%), siç tregon Tabela A1. Në vitin 2019, 69% e migrantëve kosovarë për herë të parë shkuan në Gjermani, ndërsa në Kroaci dhe Slloveni shkuan nga 9% (shih Tabelën A3). Ndërmjet vitit 2017 dhe 2019, numri i emigrantëve kosovarë në Kroaci u rrit nga 339 në 6 369, ndërsa numri që shkonte në Slloveni u rrit nga 2 016 në 5 862. Këto shifra u gjetën gjithashtu në anketën e UNDP-së (2019) dhe provat e marra nga Ambasada kroate që lëshoi më shumë viza pune për qytetarët e Kosovës. Ky emigrim është për shkak të faktit se vetë Kroacia vuan nga emigrimi i fuqisë punëtore dhe ka mungesë të punëtorëve në disa fusha. Në vitin 2018, Franca u bë vend i synuar për 66% të azilkërkuesve kosovarë¹¹, krahasuar me 17% që aplikonin në Gjermani.


Regjistrimi i vitit 2011 gjithashtu tregon se pothuaj gjysma e migrantëve emigruan për shkaqe familjare (kryesisht martesë ose ribashkim familjar), ndërsa 38% emigruan për shkaqe ekonomike dhe 8% për shkak të luftës. Të dhënat e Eurostatit për lejet për herë të parë tregojnë se përqindja e lejeve për herë të parë për shkaqe të lidhura me punën u rrit për 19 pikë përqindjeje prej vitit 2010 deri në vitin 2019, ndërsa emigrimi për shkaqe familjare ra për 22 pikë përqindjeje gjatë të njëjtës periudhë (shih Figurën 7¹²). Emigrimi për shkollim mbeti i njëjtë, dhe përbënte vetëm 2% të lejeve për herë të parë në vitin 2010 dhe 2019¹³.

Figura 7: Shkaqet për migrim, lejet e qëndrimit për herë të parë, 2010 dhe 2019

¹¹ Edhe pse Kosova tani është vend i sigurt, kosovarët ende mund të kërkojnë azil, por marrja e azilit është e vështirë. Siç thuhet në raportin e vitit 2016 [‘Vendet “e sigurt”: Mohimi i të drejtës së azilit’](#): "Zbatimi i konceptit vend i sigurt në lidhje me vendet e prejardhjes bën që shtetasit e vendeve të përcaktuara si të sigurt të përjashtohen automatikisht nga marrja e statusit të azilit/refugjatit në vendet pritëse ose, të paktën, duke u ngritur kundër pretendimit të tyre një prezumim të statusit jo-refugjat të cilin ata duhet, me vështirësi, ta kundërshtojnë".

¹² Nuk ka informata për ‘shkaqe të tjera’, por arsyet që lidhen me shëndetin mund të jenë një arsye.

¹³ Hyrja për ‘shkollim’ nuk e ofron pasqyrën e plotë të të rinjve që migrojnë për studime ose trajnime të tjera jashtë vendit, pasi kjo nuk e përjashton që kategoria ‘ribashkimi familjar’ mund ta përfshijë një numër të madh të të rinjve që shkojnë për shkollim ose trajnim të mëtejshëm.



Burimi: Eurostat 2020, nxjerrë më 27 janar 2021, marrë nga:

https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_resfirst&lang=en

Lidhur me kohëzgjatjen e lejeve të punës, të dhënat e Eurostatit tregojnë se në vitin 2019, 63% e lejeve për herë të parë janë lëshuar për 12 muaj ose më gjatë (69% janë lëshuar nga Gjermania, 9% nga Sllovenia, 5% nga Kroacia), 27% janë lëshuar për 6 deri në 11 muaj dhe 10% janë lëshuar për 3 deri në 5 muaj, shih Tabelën A4).

Ka mungesë të informatave sistematike për kthimin e migrantëve (Banka Botërore, 2017). Studimi i fundit që u përqendrua në kthimin e migrantëve u realizua në vitin 2009, i mbështetur nga Banka Botërore dhe i zbatuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës¹⁴. Sipas anketës së vitit 2009, Gashi dhe Adnett (2015) zbuluan se, sipas familjeve migrante në Kosovë, 12% e migrantëve planifikonin të ktheheshin brenda pesë vjetëve të ardhshme. Pak më shumë se 10% e migrantëve kishin fituar shkollim shtesë gjersa ishin jashtë vendit, që arrin mesatarisht në një vit shtesë të shkollimit (p.sh. kalimi nga arsimi i mesëm në arsim të lartë të përfunduar). Anketa gjithashtu zbuloi se migrantët më të arsimuar dhe migrantët që kishin marrë arsim shtesë gjersa ishin jashtë vendit kishin më shumë gjasa të ktheheshin, ndërsa ata që ishin emigrantë për periudha më të shkurtra kohore dhe ata që e kishin fituar statusin e rezidentit të përhershëm dhe e kishin familjen me vete kishin më pak të ngjarë për t'u kthyer. Siç pritej, sa më të forta të ishin lidhjet familjare të një migranti me vendin e tyre, aq më të mëdha ishin gjasat që të ata ktheheshin. Më në fund, migrantët të cilët pritej të investonin në biznese në Kosovë ishin më të gatshëm për t'u kthyer.

2.1. Roli i jashtëzakonshëm i Gjermanisë si vendi kryesor i destinacionit

Migrimi për punë, veçanërisht në Gjermani, ka shënuar rritje viteve të fundit. Të dhënat e regjistrimit të vitit 2017 nga Zyra Federale Gjermane e Statistikave (DESTATIS) zbuluan se rreth 433 000 kosovarë jetonin në Gjermani, nga të cilët 66% u raportuan të jenë të punësuar (GAP, 2020).

Në tetor 2015, Gjermania propozoi një skemë të re të migrimit të fuqisë punëtore, të njohur si Westbalkanregelung, ose Rregullorja e Ballkanit Perëndimor. Skema e re, e cila i mbulonte shtetasit e Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, u miratua në tetor 2015 dhe hyri në fuqi që nga janari 2016 (Biter dhe Ziebarth, 2018). Skema ishte përgjigje ndaj numrit disproporcionalisht të lartë të kërkesave për azil të paraqitura pas krizës së refugjatëve të vitit 2015, kur vetëm në nëntë muajt e parë të vitit 41% e të gjithë azilkërkuesve për herë të parë në Gjermani erdhën nga Ballkani Perëndimor, por më pak se 1% i plotësuan kriteret për mbrojtje (OECD, 2020). Sipas skemës, çdo azilkërkues nga rajoni i cili menjëherë e

¹⁴ Raporti nuk është publikuar, por të dhënat u vunë në dispozicion për qëllime të hulumtimit.

tërhoqi kërkesën e tij dhe u largua nga Gjermania kishte të drejtë të kthehej sërish në vend. Kjo u mundësoi qytetarëve nga rajoni të punonin në Gjermani nga viti 2016 deri në vitin 2020.

Rregullorja e Ballkanit Perëndimor nuk kishte asnjë kufizim lidhur me nivelin e shkathtësive ose kualifikimeve të një aplikanti për sa kohë që kishte një ofertë të vlefshme të punës. Aplikimi i nënshtrohej një testi të tregut të punës që kërkonte nga punëdhënësit gjermanë të provonin se asnjë punëtor vendas, i BE-së ose refugjat i pranuar nuk mund ta plotësonte vendin e lirë të punës. Në profesionet ku kishte mungesë akute të fuqisë punëtore të kualifikuar, si TI ose shërbime të kujdesit, aplikantët që ishin pranuar për një punë nuk kishin nevojë të siguronin prova për kualifikimet e tyre. Ndërsa Rregullorja ishte planifikuar të përfundonte në vitin 2020, për shkak të kërkesës së tregut të punës u lejua të vazhdonte deri në vitin 2023, por me kusht që jo më shumë se 25.000 aprovime pune në vit t'u jepeshin vendeve të Ballkanit Perëndimor nga Agjencia Federale Gjermane e Punësimit. Ky kufizim pritet ta zvogëlojë emigrimin nga Kosova, duke pasur parasysh faktin se pothuaj një e treta e kontratave të punës u dorëzuan nga kosovarët ndërmjet viteve 2016-2019 dhe rreth një të katërtës së tyre u janë dhënë viza pune (GAP, 2021). Përveç kësaj, shkalla e papunësisë në Gjermani u rrit për shkak të krizës COVID-19, duke arritur kulmin në 6.4% në gusht 2020.

Prej janarit 2016 deri në shtator 2019, Gjermania dha 77 092 para-aprovime për aplikacionet e kosovarëve, kryesisht për punë në ndërtimtari, shërbime akomodimi dhe ushqimore, dhe shërbime administrative dhe mbështetëse, ndërsa profesionet që merrnin më pak aprovime ishin financat dhe sigurimet, energjia elektrike, gazi, arsimi dhe administrata publike (GAP, 2020). Ndonëse migrantët kosovarë marrin një pagë mesatare më të lartë në Gjermani, ata paguhën më pak se vendësit gjermanë. Pabarazia është raportuar në dy gazeta të Kosovës, të cilat zbuluan se vendësit gjermanë marrin një pagë mesatare mujore prej 3 509 eurove, kurse punëtorët nga Kosova marrin 2 522 euro, ose rreth 1 000 euro më pak në muaj¹⁵. Dallimi është gjithashtu i lartë ndër specialistë, paga mesatare mujore e të cilëve është 4 400 euro, ndërsa ata nga Ballkani Perëndimor marrin 1 000 euro më pak në muaj (3 476 euro). Dallimi është më i vogël për punëtorët mbështetës nga Kosova (paga mesatare mujore e të cilëve është 2 352 euro).

Ligji i ri për imigrimin e kualifikuar, i njohur si Fachkräftezugewanderungsgesetz, hyri në fuqi në mars 2020. Ligji i ri, i cili synon të tërheqë punëtorë me kualifikime të larta, i lejon të huajt me kualifikime të caktuara të aplikojnë për leje pune dhe të lëvizin në Gjermani përmes kanaleve ligjore, të cilat e lehtësojnë edhe migrimin e punëtorëve të kualifikuar me aftësim profesional, jo-akademik nga vendet që nuk janë anëtare të BE-së për qëllime të punës. Sipas kushteve të ligjit, lejet e punës janë në dispozicion për këdo që arrin ta marrë një kontratë pune në profesionet e mbuluara. Punëdhënësit gjermanë nuk duhet t'u japin më përparësi shtetasve gjermanë ose të BE-së me kualifikime ekuivalente. Ata që nuk kanë kontratë do të lejohen të aplikojnë për një vizë gjashtëmujore për punëkërkues nëse e plotësojnë kërkesën kryesore të kualifikimeve profesionale në fushat në të cilat bizneset gjermane po luftojnë për të gjetur aplikantë të kualifikuar. Ligji i ri përcakton gjithashtu që aplikantët për leje pune duhet ta dëshmojnë së pari njohjen e gjuhës gjermane. Kjo rregullore dhe rregullorja paraprake i kanë nxitur shumë kosovarë, veçanërisht të rinjtë, që të regjistrojnë kurse të gjuhës.

Agjencia Federale e Punësimit e Gjermanisë vazhdimisht i vlerëson dhe parashikon nevojat e tregut të punës, duke krijuar dhe përditësuar një listë të mungesës së profesioneve dhe duke kryer teste të tregut të punës (GAP, 2020). Bazuar në këto nevoja, agjencia i miraton ose i refuzon aplikimet e migrantëve. Nga ana tjetër, Agjencia e Punësimit e Kosovës nuk bën një analizë të ngjashme ose nuk ka ndonjë informatë mbi profesionet që mund të çojnë në ikjen e trurit. Duke pasur parasysh pezullimin e aktiviteteve të ambasadës për shkak të COVID-19, migrimi jashtë është ndalur, duke e ulur drejtpërdrejt rritjen e mundshme të të ardhurave nga emigrantët e rinj.

2.2. Politikat e migrimit në Kosovë

Duke pasur parasysh diasporën e saj të madhe, Kosova kishte një Ministri të Diasporës deri në vitin 2019, kur u bashkua me Ministrinë e Punëve të Jashtme. Megjithatë, bashkimi është kritikuar gjerësisht me arsyetimin se e ka dobësuar rolin e Ministrisë ndaj diasporës. Fokusi i Ministrisë së Diasporës kishte qenë ta lehtësonte ruajtjen,

¹⁵ Shih: <https://www.drenicapress.info/sa-paguhën-kosovaret-ne-kosove-sa-ne-zvicer-e-sa-ne-gjermani/>

kultivimin dhe zhvillimin e gjuhës dhe kulturës amtare si thelbësore për ruajtjen e identitetit kombëtar, mirëmbajtjen e marrëdhënieve me Kosovën dhe sigurimin e informatave për mundësitë për investim. Ministria e re nuk ka qenë e angazhuar në fushën e emigrantëve të rinj, qoftë për ta mbështetur ose për ta parandaluar emigrimin e tyre.

Deri më tani, Kosova i ka hartuar katër dokumente strategjike në fushën e migrimit. Strategjia Kombëtare për Migracionin 2009–2012 u përqendrua në transparencën dhe efektivitetin në administrimin e migrimit të ligjshëm dhe në uljen e të gjitha formave të migrimit të paligjshëm. Një fokus i fortë i strategjisë ishte zhvillimi i një sistemi efektiv për emigrimin dhe imigrimin. Strategjia për Migracionin 2013–2018 u përpoq ta avancojë dhe lehtësojë migrimin legal, duke e kthyer migrimin në një faktor pozitiv për zhvillimin ekonomik dhe identifikimin e mundësive për ta zbatuar menaxhimin bilateral dhe rajonal të migrimit. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Migracionin 2013–2018 u përqendrua në administrimin e migrimit dhe bashkëpunimin ndërinstitucional me vendet fqinje, qëllimi kryesor i të cilës ishte parandalimi dhe luftimi i migrimit të parregullt dhe kontrabandimi i migrantëve. Strategjia kishte tri objektiva strategjike: (i) parandalimin dhe luftimin e migrimit të parregullt; (ii) përmirësimin e menaxhimit të migrimit legal dhe qarkor; dhe (iii) transformimin dhe zhvillimin e migrimit në një faktor pozitiv ekonomik. Në mungesë të monitorimit dhe vlerësimit¹⁶, arritjet e strategjisë mbeten të paqarta.

Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2018-2022 synon të sigurojë riintegrim të qëndrueshëm socio-ekonomik për personat e riatdhesuar përmes përmirësimit të vazhdueshëm dhe avancimit të një sistemi efektiv dhe efikas të shërbimit të përqendruar në nevojat e të kthyerve. Objektivat kryesorë të strategjisë janë avancimi i sistemit të riintegrit për personat e riatdhesuar duke zbatuar një qasje të orientuar në nevoja; mbështetja e riintegrit të qëndrueshëm socio-ekonomik të personave të riatdhesuar; avancimi i bashkëpunimit gjithëpërfshirës në fushën e riintegrit; forcimi i kapaciteteve për të siguruar qasje të integruar për një sistem riintegrit; dhe forcimi i monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të politikave të riintegrit. Drafti i Strategjisë për Diasporën 2019–2023 (Qeveria e Kosovës, 2019)¹⁷ synon t'i promovojë dhe avancojë të drejtat politike dhe sociale të diasporës, ta ruajë identitetin dhe t'i forcojë lidhjet me diasporën, dhe ta inkurajojë diasporën që të integrohet në vendet pritëse. Megjithatë, strategjia parashikon edhe masa stimuluese për t'i angazhuar anëtarët e diasporës në Kosovë, pasi përfshin një masë për ta sjellë stafin akademik nga diaspora në arsimin e lartë. Nuk ka asnjë provë nëse ndonjë nga këto masa janë zbatuar. Një aktivitet të cilin Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike e ka zbatuar është sigurimi i vendeve të papaguara të praktikës për studentët e diasporës, edhe pse nuk ka prova të ndonjë ndikimi që kjo masë mund të ketë pasur në të kthyerit potencialë. Emigrimi ekonomik nuk adresohet në strategji.

Institucionet e Kosovës ofrojnë shërbime për ta mbështetur emigrimin legal. Divizioni për Shërbime të Migracionit në Agjencinë e Punësimit të Kosovës ofron informata për migrimin dhe mbështetje për individët e interesuar për migrim përmes 14 këshilltarëve për shërbime për migrim në shtatë zyrat për punësim. Mbështetja përfshin përgatitjen e CV-ve dhe sigurimin e informatave lidhur me profesionet që kërkohen dhe çështje të tjera. Agjencia ka përgatitur udhëzues dhe rregullore mbi rregullat e migrimit në Austri, Gjermani, Slloveni, Kroaci dhe Zvicër. Në tetor dhe nëntor 2020, këshilltarët u trajnuan për t'i përditësuar njohuritë e tyre për ndryshimet e fundit të legjislacionit në Gjermani dhe në vende të tjera. Mirëpo, bazuar në një intervistë me një përfaqësues nga Agjencia e Punësimit, duket se mbështetja nuk është shumë e strukturuar dhe informatat për kushtet e tregut të punës në vendet e destinacionit nuk përditësohen rregullisht. Mbështetja për emigrantët sigurohet edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme, ndërsa Departamenti i Çështjeve Konsullore certifikon dokumente të ndryshme me apostil (për të vërtetuar se janë origjinale), përfshirë vulat apostile për diploma dhe certifikata të arsimit të lëshuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimit.

¹⁶ Asnjë vlerësim përmbledhës nuk u prezantua në Draft Strategjinë për Diasporën 2019–2023.

¹⁷ Strategjia është hartuar, por ende nuk është miratuar: http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/11-39-02-21062019/State%20Startegy%20on%20Migration_18_06_19_ENG%20-.docx

Kosova ka nënshkruar marrëveshje ripranimi me 24 vende, përfshirë 20 shtete anëtare të BE-së dhe anëtare të Zonës Shengen, por nuk ka asnjë marrëveshje me BE-në si tërësi (Komisioni Evropian, 2020a). Pritet të miratohet një Strategji e sapo-zhvilluar për Riintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar në Kosovë 2019-2023 (Qeveria e Kosovës, 2018). Në vitin 2018, 7 985 kosovarëve ose iu refuzua hyrja në shtetet e BE-së, pasi u zbulua se kishin qëndrim ilegal, ose u deportuan nga vendet e BE-së dhe Zona e Shengenit (Ministria e Punëve të Brendshme, 2018). Ky numër ishte shumë më i madh në vitin 2015, 40 005 individë, dhe në vitin 2016, 23 038 individë (Ministria e Punëve të Brendshme, 2018). Për sa i përket ripranimit, 1 536 kosovarë u riatdhesuan nga shtetet anëtare të BE-së dhe Zona e Shengenit në vitin 2019, krahasuar me 2 395 në vitin 2018; rreth 70% e individëve të riatdhesuar janë burra të moshës 18–34 vjeç, që tregon tendencë më të lartë të rinjve për të migruar. Për dallim nga vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, BE-ja nuk ka nënshkruar ende asnjë liberalizim të vizave me Kosovën. Megjithatë, kosovarët gëzojnë qasje pa viza në vendet fqinje, përveç në Bosnje dhe Hercegovinë. Qasja pa viza është e rëndësishme për emigrimin e përkohshëm dhe sezonal të kosovarëve në vendet si Mali i Zi dhe Shqipëria.

3. Shpërndarja e fuqisë punëtore dhe migrimi

Kosova është një ekonomi e vogël, e hapur, e prekur nga zhvillimet e jashtme ekonomike përmes tregtisë, remitencave dhe investimeve të huaja. Gati 80% e IHD-ve në periudhën janar-tetor 2019 ishte drejtuar në aktivitete të patundshmërive dhe të dhënies/marrjes me qira, ndërsa 7.5% për shërbime financiare (ERP 2020-2022). Kosova varet nga importet, të cilat u vlerësuan në 3,273 milionë euro për mallra dhe 762 milionë euro për shërbime në vitin 2019, ndërsa eksportet e mallrave ishin vetëm 398,2 milionë euro dhe eksportet e shërbimeve ishin 1,744 milionë euro në vitin 2019, duke çuar në një bilanc negativ tregtar për mallra dhe në bilanc pozitiv për shërbime (ERP 2020–2022). Firmat e Kosovës në sektorin zyrtar janë të vogla dhe dominohen nga mikro-ndërmarrjet, të cilat përbëjnë 91% të firmave dhe vetëm 36% të vendeve zyrtare të punës (Banka Botërore, 2019). Firmat në Kosovë nuk janë integruar mirë në ekonominë globale, e kjo çon në një kufizim në krijimin e vendeve të punës. Vetëm 4% e firmave janë eksportuese dhe më pak se 1% kanë ndonjë investim të huaj të drejtpërdrejtë. Duke pasur parasysh madhësinë e vogël të ekonomisë së Kosovës, mungesa e qasjes në tregje ndërkombëtare lë të kuptohet që disa firma janë në gjendje ta zgjerojnë dukshëm prodhimin ose fuqinë e tyre punëtore (Banka Botërore, 2019).

Në vitin 2019, gati 60% e popullsisë në moshë pune (të moshës 15-64 vjeç) ishte joaktive (deri në 79% për gra), dhe vetëm rreth 30% ishin të punësuar. Brenda numrit të vogël të individëve aktivë, 25.7% ishin të papunë. Shkalla e papunësisë ishte më e larta te të rinjtë (49.4%) dhe gratë (34.4%). Dy të tretat e të papunëve ishin të papunë për më tepër se 12 muaj, me gati 80% të atyre të moshës 35-39 vjeç të papunë për më shumë se një vit. Një tjetër tipar shqetësues është shkalla e lartë e të rinjve që nuk janë të punësuar, nuk shkojnë në shkollë apo në trajnim (NEET), që përbënte një të tretën e të rinjve në vitin 2019 (rreth 31% për meshkuj dhe 34% për femra) (ASK, 2020). Treguesit e tranzicionit të të rinjve (% e moshës 15-24 vjeç) gjithashtu tregojnë për perspektiva shumë të ulëta në tregun e punës: vetëm 26% e të rinjve ishin aktivë (18% për femra) dhe vetëm 13% ishin të punësuar (7% për femra). Shkalla e papunësisë së të rinjve ishte gati 50% (60% për femra) (ETF, 2020b).

Arsimi është kontribues i rëndësishëm për punësim. Sipas të dhënave të AFP-së të vitit 2019, arritjet arsimore (nivele të gjera) të fuqisë punëtore (% 15 vjeç) janë me sa vijon: 16.5% janë me kualifikim të ulët, 56.3% me kualifikim të mesëm dhe 27.2% me kualifikim të lartë. Punësimi sipas grupeve profesionale gjithashtu tregon se 21.1% e të punësuarve u përkasin profesioneve me kualifikim të ulët, 48.2% punojnë në profesione me kualifikim të mesëm (ISCO 4-8) dhe 30.7% punojnë në profesione me kualifikim të lartë (ISCO 1-3). Shkalla e punësimit është më e larta për individët me arsim të lartë (62.2%) dhe arsim të mesëm të lartë të AAP-së (37.7%). E njëjta renditje vlen edhe për nivelet e papunësisë: individët me nivel të arsimit terciar kanë një shkallë papunësie prej 21.5%, ndërsa shifra 25.2% është për ata me arsim të mesëm të AAP-së, 32% për ata vetëm me arsim fillor dhe 49.4% për ata pa shkollë (shih Tabelën A5). Megjithatë, raporti nuk identifikon nëse individët e punësuar punojnë në punë

që përputhen me nivelin e tyre të shkollimit ose fushën e studimit. Përveç kësaj, përqindja e vetëpunësimit në punësimin e përgjithshëm është mjaft e lartë (27.1% në vitin 2019), dhe punësimi i cënueshëm është i madh (18.9% e të punësuarve janë punëtorë vetanake dhe anëtarë kontribuues të familjes) (ETF, 2020a).

Anketa e MCC LFTUS 2017 zbuloi se vetëm një në tre individë raportuan se puna e tyre aktuale ose më e fundit lidhej me fushën e tyre primare të studimit. Sipas fushës së studimit, përqindja më e ulët e individëve që punojnë në fushën e tyre të studimit ishte në programet e përgjithshme¹⁸ (8%), pasuar nga shkencat fizike (15%) dhe matematika e statistika (27%). Pjesa më e madhe e individëve që punojnë në fushën e tyre të studimit u gjet në trajnimin dhe arsimin e mesimdhënësve (76%), shëndetësi dhe mirëqenie (62%) dhe shkenca të jetës (51%). 66.2% e individëve që treguan se puna e tyre aktuale ose më e fundit nuk lidhej me fushën e tyre të studimit u pyetën pse. Pjesa dërrmuese e tyre (91.9%) tregoi se ishte për shkak se nuk kishte punë në dispozicion në fushën e tyre të studimit. Anketa STEP e Bankës Botërore¹⁹, që u realizua në vitin 2016/17, zbuloi se 23% e punëtorëve e konsideronin veten tepër të shkolluar dhe 11% të pashkolluar, ndërsa shumica e individëve me arsim të mesëm, jo-terciar, e konsideronin nivelin e tyre të arsimit shumë të ulët për çfarë kërkohej nga vendi i punës në Kosovë (Banka Botërore, 2019).

Sipas AFP 2019 (KAS, 2020), mungesa e vendeve të punës është arsyeja kryesore për të punuar me kohë të pjesshme, e që nuk ishte zgjedhje vullnetare e individëve, duke ditur që 75% deklaruan se arsyeja për punën e tyre me kohë të pjesshme ishte mungesa e vendeve të punës me orar të plotë. Përqindja e atyre që punojnë me kohë të pjesshme u rrit nga 4.4% në vitin 2018 në 6.7% në vitin 2019. Vështirësitë në gjetjen e vendit të punës paraqiten gjithashtu në Tabelën 4, e cila mbledh të dhëna për të papunët e regjistruar dhe vendet e lira të punës të administruara nga Agjencia e Punësimit të Kosovës (APRK)²⁰. Në vitin 2018, 25.3% e të papunëve të regjistruar nuk ishin fare të shkolluar, 25.3% kishin mbaruar vetëm arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, 32.9% kishin mbaruar arsimin e mesëm të lartë të AAP-së, 6.9% kishin mbaruar arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm në gjimnaz, 11.2% kishin mbaruar studimet BA dhe 0.7% kishin mbaruar studimet MA (APRK, 2019).

Sipas profesionit, 47% e të papunëve të regjistruar kishin përvojë pune në punë elementare, 12% kishin qenë zejtarë ose kishin pasur punë përkatëse, dhe 10% kishin punuar në nivel të teknikut. Sipas grupmoshës, gjysma ishin 25–29 vjeç. Rajoni i Prishtinës përbënte 25% të të papunëve të regjistruar. Në vitin 2018, 23% e vendeve të lira të punës u identifikuan në prodhim, të pasuara nga tregtia dhe bujqësia (pothuaj 19% secila). Për sa u përket profesioneve, gati 50% e vendeve të lira të punës ishin për punëtorë të tregtisë, operatorë të makinave dhe teknikë. Mbi një e treta e vendeve të lira të punës (35.1%) janë regjistruar në rajonin e Prishtinës. APRK u ndihmoi 29% të punëkërkuësve të papunë të gjenin punë në bujqësi, 20.9% në tregti dhe 20.3% në prodhim. Anketa STEP gjithashtu zbuloi mungesë të vendeve të reja të punës: vetëm 15% deri në 30% të të gjitha firmave u përpoqën ta punësonin së paku një person në vitin 2015 (Banka Botërore, 2019). Kërkesa ishte më e madhe për profesionet me kualifikim më të lartë (menaxherë, profesionistë, teknikë) dhe profesione me kualifikim të mesëm lidhur me shërbimet (nëpunës, punëtorë shitës dhe punëtorë shërbyes) sesa për profesione me kualifikim të ulët (ndërtimtari dhe zejtar, profesione elementare, vozitës dhe operatorë).

¹⁸ Programet dhe kualifikimet themelore, shkrim-leximi dhe numërimi, dhe shkathtësitë dhe zhvillimi personal.

¹⁹ Anketa STEP e Bankës Botërore (Aftësitë drejt punësimit dhe produktivitetit) përfshiu dy lloje të anketave: e para ishte një anketë e punëdhënësit që u administrua në një mostër të 500 vendeve të punës në Kosovë në nëntor – dhjetor 2015. E dyta ishte një anketë e familjeve që u administrua në një mostër prej 3 511 individëve të moshës 15–64 vjeç në Kosovë ndërmjet shtatorit 2016 dhe marsit 2017 (Banka Botërore, 2019).

²⁰ APRK-ja i regjistron individët e papunë, por regjistrimi nuk është i detyrueshëm (nuk ka nxitje për t'u regjistruar, sepse nuk ka sistem të përfitimit nga papunësia). Si rrjedhojë, numri i të papunëve mund të nënvlerësohet (sipas AFP-së, në vitin 2019 ishin 123 305 individë të papunë, krahasuar me 70 790 individë të regjistruar si të papunë në zyrat e punësimit). Nënvlërësimi i mundshëm i vendeve të lira të punës mbështetet nga anketa STEP, e cila zbuloi se pak më shumë se një e pesta e firmave lidhen me agjencinë publike të punësimit për rekrutim, qoftë për profesione të shkathtësive më të larta ose për profesione të mesme deri të ulëta.

Tabela 4: Të regjistruar si të papunë dhe vendet e lira të punës, siç raportohet nga APRK-ja, individët

Viti	Numri i të papunëve të regjistruar	Numri i vendeve të lira të punës	Numri i ndërmjetësimeve (me përjashtim të ALMP-ve)	Pjesa e vendeve të lira të punës të plotësuara nga APRK-ja
2015	112 179	11 506	3 574	31%
2016	101 773	14 137	4 022	28%
2017	93 866	12 511	3 215	26%
2018	95 890	14 847	3 764	25%
2019	70 790	9 462	4 160	44%

Burimi: APRK 2019, Puna dhe fuqia punëtore 2018 dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me APRK-në për të dhënat për vitin 2019

3.1. Mospërputhja ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë

Studime të shumta sugjerojnë se ekziston një mospërputhje ndërmjet ofertës dhe kërkesës për punë. Të dhënat në Tabelën 4 tregojnë se gjatë viteve 2015-2019, Agjencia e Punësimit arriti t'i plotësojë mesatarisht rreth 30% të vendeve të lira të punës, të cilat mund të përdoren si tregues i një mospërputhjeje ndërmjet shkathtësive të të papunëve dhe kërkesave të punëdhënësve²¹. Rezultatet e anketës STEP të Bankës Botërore 2016/2017 (2019) zbuluan se shkathtësitë dhe përvoja ishin pengesat kryesore për rekrutim, veçanërisht për profesionet e kërkuara nga firmat. Firmat novatore, firmat që kishin filluar të përdorin metoda të reja ose të përmirësuara për prodhimin ose përpunimin e mallrave ose të shërbimeve në tri vjetët e fundit, dhe firmat që kishin investuar në R&D kishin më shumë gjasa të përballeshin me kufizime të shkathtësive. Një anketë e vitit 2019, e mbështetur nga UNDP-ja dhe e administruar në 201 kompani, zbuloi se kompanitë kishin vështirësi 'të moderuara' për të gjetur punëtorë të kualifikuar (UNDP, 2020). Vështirësitë ishin më të theksuara në ndërmarrjet prodhuese, ndërtimore dhe të shërbimeve. Në pamundësi për të gjetur punëtorë të kualifikuar, pothuaj dy nga tri kompani kishin vendosur të punësonin punëtorë më pak të kualifikuar (63%), ndërsa 19% thanë se kishin caktuar detyra shtesë për stafin ekzistues. Raporti ndërmjet kërkesës dhe ofertës për shkathtësi dhe profile të caktuara shpesh nuk përputhej.

Anketa STEP zbuloi se firmat në pronësi të huaj përjetuan nivele të larta të mungesës së shkathtësive si për profesione më të larta, ashtu edhe për ato të mesme deri të ulëta. Prova për mungesën e shkathtësive gjenden edhe në një anketë të vitit 2019 të 38 ndërmarrjeve të regjistruara kosovare me një pjesë të kapitalit të huaj nëpër një sërë sektorësh; vetëm 21% e të anketuarve deklaruan se Kosova i plotëson tërësisht nevojat e tyre për një fuqi të kualifikuar punëtore (Zogaj-Gashi et al., 2019). Pakënaqësia me të diplomuarit pasqyrohet gjithashtu në anketën STEP 2016/17, e cila zbuloi se gati 60% e punëdhënësve raportuan se sistemi i arsimit të përgjithshëm nuk prodhon kuadro që kanë përvojë përkatëse praktike, dhe gati 50% e punëdhënësve raportuan për mungesë të njohurive bashkëkohore ose shkathtësive socio-emocionale, si disiplina, afatet kohore ose shkathtësitë ndërpersonale. Ndonëse ata ishin pak më të kënaqur me përvojën dhe shkathtësitë e fituara nga sistemi i arsimit profesional, ndërmjet 35% dhe 42% të firmave thanë se sistemet e arsimit dhe aftësimit të Kosovës nuk prodhojnë njerëz me shkathtësi të nevojshme (Banka Botërore, 2019).

Bashkëpunimi i dobët ndërmjet sistemit arsimor dhe tregut të punës konsiderohet si arsyeja kryesore për mospërputhjen e shkathtësive me nevojat e tregut të punës. Anketa STEP zbuloi se më pak se një në pesë firma, mesatarisht, janë në kontakt të rregullt me sistemet arsimore, dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre reagojnë për programet mësimore. Edhe pse sistemi arsimor nuk arrin t'i pajisë studentët me shkathtësi të kërkuara dhe programet e trajnimit kanë mbulim të kufizuar, zhvillimi i shkathtësive brenda firmave është gjithashtu i kufizuar. Anketa e UNDP-së 2019 zbuloi se vetëm 23% e firmave ofruan trajnim për zhvillimin e shkathtësive teknike, 20% ofruan trajnim për komunikim me klientë, dhe 19% ofruan trajnim në fushën e zhvillimit të udhëheqjes dhe menaxhimit ose trajnimit në lidhje me produktet dhe shërbimet (UNDP, 2020). Përkundër mandatit të saj për t'i përgatitur të papunët për tregun e punës në Kosovë, APRK-ja i ka ndihmuar vetëm një numri të kufizuar të përfituesve përmes masave aktive të tregut të punës për shkak të një buxheti të kufizuar deri në vitet e fundit, dhe

²¹ Agjencia nuk ka kryer asnjë vlerësim të përqindjes së ulët të vendeve të lira të plotësuara të punës.

janë ngritur shqetësime lidhur me rëndësinë e ofertës së saj për trajnim. Një vlerësim i fundit i ALMP-së (Rizvanolli et al., 2019) zbuloi se shkalla e punësimit në kohën e anketës (gjashtë muaj ose më shumë pas përfundimit të skemës) sillet ndërmjet 41% midis përfituesve të trajnimit në punë, 50.7% midis përfituesve të subvencionimit të pagave, dhe 43.4% midis praktikantëve. Këto gjetje mund të tregojnë se punëdhënësit e përdorin ALMP-në për t'i punësuar të papunët e regjistruar si fuqi punëtore relativisht të lirë.

Një lajm i mirë është ndryshimi në programet aktive të tregut të punës që i synojnë posaçërisht të rinjtë kosovarë. Aktualisht janë duke u zhvilluar negociata për zbatimin e skemave për të rinjtë në Kosovë, që është e ngjashme me skemën e BE-së "Youth Guarantee", mbase në kuadër të programit IPA 2022. Sipas skemës "Youth Guarantee", të gjithë të rinjtë nën moshën 30 vjeçare duhet ta marrin një ofertë të cilësisë së mirë për punësim, arsimim të vazhdueshëm, praktikë ose trajnim brenda një periudhe prej katër muajsh pasi të mbeten pa punë ose pasi ta mbarojnë arsimin formal.²² Duke pasur parasysh shkallën shumë të lartë të papunësisë së të rinjve në Kosovë, iniciativat, si "Youth Guarantee", janë shumë të nevojshme. Përveç kësaj, ekziston nevoja për një monitorim më të mirë të tregut të punës në Kosovë, kryesisht për sa i përket parashikimit të nevojave të tregut të punës për shkathtësi në sektorë të ndryshëm dhe për identifikimin e listave të profesioneve deficitare. Edhe pse po diskutohet për disa pilot iniciativa për projektet e financuara nga BE-ja në këtë fushë (p.sh. planet për prodhimin e një barometri të tregut të punës dhe/ose barometrit të shkathtësive), ai është larg nga profesionet dhe shkathtësitë për të cilat dihet se mungojnë për shkak të migrimit të fuqisë punëtore.

Kosova ka informata shumë të kufizuara për tregun e punës në nivel rajonal. Një përmbledhje e kushteve rajonale të tregut të punës mund të merret nga të dhënat e mbledhura përmes Agjencisë së Punësimit (APRK) dhe Anketës së fuqisë punëtore dhe shfrytëzimit të kohës të Korporatës Sfidat e Mijëvjeçarit (MCC LFTUS) (shih Tabelën 5). Të dhënat tregojnë se punësimi ndryshonte shumë sipas rajoneve, me shkallën më të lartë të punësimit të regjistruar në rajonin e Gjakovës (49.5%), ndërsa Prishtina raportoi shkallën më të ulët të punësimit, 36.5%. Megjithatë, kur shkallët e punësimit u ndanë nga zonat urbane dhe rurale brenda rajoneve, u zbulua se shkalla e punësimit për zonat urbane në Prishtinë ishte e dyta më e larta, 40.8%, dhe shkalla e punësimit për zonat rurale në Prishtinë ishte më e ulët ndër të gjitha rajonet, 34.2%. Situata në Gjakovë ishte ndryshe: zonat rurale raportuan një shkallë dukshëm më të lartë punësimi prej 50.2% krahasuar me 43.7% në zonat urbane. Në lidhje me numrin e individëve të papunë të regjistruar në zyrat komunale për punësim të APRK-së, rajoni i Prishtinës kryesoi me 23 698 të papunë të regjistruar, ndërsa numri më i ulët ishte në Ferizaj (9 862). Numri më i madh i vendeve të lira të punës u identifikua në rajonin e kryeqytetit (5 204), ndërsa numri më i vogël në Ferizaj, Prizren dhe Gjiilan.

Tabela 5: Pasqyra rajonale e treguesve të tregut të punës

	Shkalla e papunësisë, 2017	Shkalla e punësimit, 2017	Të papunë të regjistruar, 2018	Numri i vendeve të punës, 2018
Ferizaj	14.3%	37%	9 862	1 268
Gjakovë	9.4%	49.5%	10 520	2 017
Gjiilan	16.8%	43.2%	10 477	1 518
Mitrovicë	15.2%	42.2%	14 880	2 170
Pejë	15%	38.8%	10 366	1 336
Prishtinë	24.3%	36.5%	23 698	5 204
Prizren	14.2%	42.6%	16 087	1 334

Burimi: Vlerësimet e varfërisë nga ASK-ja, MCC LFTUS 2017 dhe MPMS-ja 2018

3.2. Kushtet e pakënaqshme të punës

Rritja ekonomike në Kosovë nuk është shoqëruar nga një rritje e konsiderueshme e vendeve të reja të punës, ndërsa punët ekzistuese karakterizohen nga cilësia e ulët. Punët në sektorin privat karakterizohen nga mungesa e kontratave ose ato janë të shkurtra në kohëzgjatje. Paga minimale në Kosovë është më e ulët në Ballkanin Perëndimor (Banka Botërore dhe wiiw, 2019). Pavarësisht presionit nga përfaqësuesit e punëtorëve dhe të

²² Shih ["Youth Guarantee" e forcuar – Punësimi, Çështjet Sociale dhe Përfshirja – Komisioni Evropian \(europa.eu\)](#). Rekomandimi për krijimin e një "Youth Guarantee" (YG) u miratua nga Rekomandimi i Këshillit Evropian në vitin 2013, i cili u përforcua më tej në një Rekomandim të Këshillit të tetorit 2020.

punonjësve, paga minimale nuk është rregulluar që nga fillimi i zbatimit të saj në vitin 2011, kryesisht për shkak të rezistencës nga punëdhënësit. Në vitin 2019, paga mesatare bruto në Kosovë ishte 477 euro (ASK, 2020), e cila ishte e dyta më e ulëta në rajon pas Shqipërisë, me një pagë mesatare bruto prej 426 eurove. Nga ana tjetër, paga mesatare bruto në Maqedoninë e Veriut ishte 609 euro, në Serbi 643 euro, në Bosnjë dhe Hercegovinë 728 euro, dhe në Mal të Zi 773 euro (baza e të dhënave vjetore, 2021)²³.

Në Kosovë, paga mesatare në sektorin publik është 42% më e lartë se paga mesatare në sektorin privat, ndërsa ndërmarrjet publike paguajnë një pagë mesatare që është 83% më e lartë se në sektorin privat. Burimi i vetëm zyrtar për pagat sipas sektorëve vjen nga gjetjet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve 2018²⁴ (ASK, 2019), që raportoi për një pagë mesatare bruto prej 378. eurove. Përveç sektorit të TI-së, pagat më të larta janë në sektorët që janë kryesisht publikë (minierat, energjia, uji). Pagat në sektorin privat sillen prej 254 eurove në akomodim deri në 440 euro në ndërtimtarë. Gjetjet e anketës së MCC LFTUS tregojnë se paga mesatare mujore neto e punonjësve publikë ishte 415 euro, ndërsa ata që punojnë në sektorin privat merrnin një pagë mesatare prej 304 eurove.

Pagat më të ulëta në sektorin privat mund të shpjegohen nga fuqia punëtore më pak e kualifikuar e sektorit: sipas AFP-së, në vitin 2019, 59.6% e të punësuarve në sektorin publik dhe 50.2% e të punësuarve në ndërmarrjet publike kishin përfunduar arsimin e lartë, krahasuar me vetëm 19.7 % në sektorin privat. Shumica e të punësuarve në sektorin privat (50.6%) kishin përfunduar arsimin e AAP-së, i cili vuan nga mungesa e shkathtësive të harmonizuara me nevojat e tregut të punës dhe në përgjithësi ka reputacion të keq në vend. Vështirësitë për gjetjen e një vendi të punës në sektorin publik dhe pagat e ulëta në dispozicion në sektorin privat janë faktorë të rëndësishëm që i shtojnë punëtorët me shkathtësi të mesme t'i ndjekin mundësitë për migrim. Pagat mujore neto dallonin sipas rajoneve. Banorët e Prishtinës, burra dhe gra, marrin paga më të larta se homologët e tyre në gjashtë rajonet e tjera. Banorët e Gjakovës i raportuan pagat më të ulëta se çdo rajon tjetër, me një mesatare prej 299 eurove, kryesisht për shkak të dominimit të vendeve të punës në bujqësi në atë rajon.

Pagat e ulëta konsiderohen ndër përcaktuesit kryesorë të varfërisë së lartë të të punësuarve në Kosovë. Duke u bazuar në të dhënat e Anketës së Buxhetit të Familjeve 2017, Haxhikadrija et al. (2019) vlerësojnë se shkalla e varfërisë së të punësuarve është 15.2%. Shkalla më e madhe e varfërisë së të punësuarve është ndër burra, individë të vetëpunësuar, punonjës të rinj dhe të moshës së mesme, dhe punëtorë me arsim të ulët. Sipas autorëve, varfëria e lartë e të punësuarve është rezultat i një sërë faktorësh, pra e një shkalle në përgjithësi të ulët të punësimit të moshës 15+ vjeç, e një shkalle veçanërisht të ulët të punësimit ndër gra, e një fuqie punëtore të dominuar nga individë me arsim të mesëm dhe të ulët, e një page minimale ligjore që shpesh nuk respektohet nga sektori privat, e mungesës së sigurimeve shëndetësore publike dhe institucioneve për mbrojtjen e papunësisë për t'i mbështetur kushtet e punëtorëve më të varfër (Haxhikadrija et al., 2019).

Prandaj, punëtorët janë shumë të pakënaqur me kushtet e punës në Kosovë. Gjetja e një vendi të punës në Kosovë nuk është punë e lehtë dhe ata që kanë një vend të punës nuk janë të kënaqur me kushtet e tyre të punës: një studim i fundit (EPPC, 2020) zbuloi se 60% e kosovarëve të punësuar nuk ishin të kënaqur me punën e tyre dhe arsyeja më e rëndomtë ishte pakënaqësia me pagat e tyre (59%). Anëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian përballen me sfida edhe më të mëdha në punësim, duke rezultuar në rrezik më të madh të migrimit ndër këto grupe (Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve, 2016).

Ka edhe prova të emigrimit nga individë të punësuar bazuar në gjetjet e anketës së UNDP-së 2019, që u administrua në një mostër përfaqësuese të 201 ndërmarrjeve (UNDP, 2020). Rezultatet e anketës²⁵ zbulojnë se gati gjysma e të gjitha kompanive të anketuara (49%) ballafaqoheshin me emigrimin e punonjësve të tyre në tri vjetët e fundit. Kompanitë më të mëdha duket se janë goditur bukur shumë nga ky fenomen. Pothuaj tri në katër

²³ <http://wiiw.ac.at/annual-database.html>

²⁴ Anketa nuk i përfshiu sektorët e mbuluar nga anketat e tjera, veçanërisht bujqësinë, gjuetinë dhe pylltarinë, peshkatarinë, financat, administratën publike, arsimin, shëndetësinë dhe aktivitetet familjare.

²⁵ Mostra e mbivendosjes/marrjes së kuotave u përdor për ta ndërmarrë një analizë krahasuese të segmenteve me madhësi të ndryshme, por rezultatet u ponderuan për mostrën totale.

ndërmarrje të mesme dhe të mëdha (73%) kishin dëshmuar emigrimin e punonjësve të tyre, ndërsa 70% e ndërmarrjeve të vogla raportuan të njëjtën gjë. Mikro kompanitë kishin më pak gjasa të hasnin në emigrimin e të punësuarve. Shumica e punonjësve që u larguan nga kompanitë për qëllime emigrimi shkuan në Gjermani (83%) dhe kishin pozita teknike në kompanitë e tyre të mëparshme (52%). Vetëm rreth një e treta e tyre kishte pozita profesionale. Përveç shpresës për mundësi më të mira pune dhe zhvillimit më të mirë ekonomik personal, bashkimi familjar gjithashtu luajti një rol të madh për shumë individë që emigruan në Gjermani. Rezultatet e marra nga kompanitë e anketuara tregojnë se rreth tre në katër punonjës që emigruan kishin arsim të mesëm (75%), rreth 12% arsim fillor ose universitar. Megjithatë, anketa e MCC LFTUS zbuloi se nivelet e papunësisë për ata që synojnë të punojnë jashtë janë 2.4 herë më të larta se për ata që nuk synojnë ta bëjnë këtë, që lë të kuptohet se ata që nuk kanë mundur të gjejnë punë në Kosovë kanë më shumë gjasa të dëshirojnë të kërkojnë punësim jashtë vendit.

Gjetja e një vendi të punës në Kosovë nuk është punë e lehtë, posaçërisht për ata që nuk kanë lidhje të forta. Kjo është për shkak se firmat në Kosovë rekrutojnë kryesisht përmes kanaleve joformale, shpesh përmes rrjeteve joformale, kontakteve personale, rekomandimeve nga miqtë dhe joshjes (d.m.th. duke iu afruar punëtorëve që tashmë janë të punësuar në firma të tjera) (Anketa STEP 2015 e Bankës Botërore, 2019). Pakicat etnike, individët nga zonat rurale dhe anëtarët e familjeve më të varfra janë në rrezik më të lartë për t'u marginalizuar. Dy të tretat e kosovarëve besojnë se faktorët jomeritorë, si lidhjet familjare, ryshfetet dhe lidhjet partiake, janë më të rëndësishmet për të gjetur punë, madje edhe në sektorin privat (përqindja është 79% për vendet e punës në sektorin publik) (Anketa STEP 2016/17 e Bankës Botërore, 2019). Prandaj, vetëm 34% e të anketuarve besojnë se arsimimi, trajnimi dhe përvoja e punës çojnë peshë.

Përkundër këtij sfondi, synimet për emigrim mbeten të larta dhe emigrimi i kosovarëve do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Anketa e Gallup International, e realizuar ndërmjet vitit 2015 dhe 2017, vlerëson se rreth 46% e kosovarëve do të dëshironin të emigronin. Sipas ekspertëve, papunësia, pagat e ulëta, nivelet e larta të korrupsionit, mungesa e sundimit të së drejtës dhe mungesa e mundësive u konsideruan si arsye kryesore pse njerëzit në Ballkan dëshirojnë të ikin. Të dhënat nga Barometri Ballkanik i Këshillit për Bashkëpunim Rajonal 2019 (RCC, 2019) tregojnë se 42% e kosovarëve mendojnë të shkojnë jashtë vendit për të punuar, ndërsa 58% nuk mendojnë të largohen nga vendi. Në grupin e parë, 62% mendojnë vetëm të largohen, por jo të informohen në mënyrë aktive për mundësitë/opsionet ose të ndërmarrin hapa konkretë për të migruar. Arsyeja më e përhapur e dëshirës për të emigruar janë kushtet ekonomike (për rreth 75% të atyre që dëshirojnë të emigrojnë), ndërsa rreth 10% e citojnë arsimin dhe 10% të tjerë i citojnë arsyet që lidhen me diversitetin kulturor. Vendet më tërheqëse për të rinjtë janë Gjermania (34%) dhe Zvicra (27%).

Sipas një studimi tjetër të realizuar në fillim të vitit 2018 dhe të mbështetur nga Friedrich-Ebert-Stiftung (Lavrič et al., 2019), 34% e të rinjve kosovarë shprehën dëshirë të fortë ose shumë të fortë për të shkuar në një vend tjetër për më shumë se gjashtë muaj. Shumica kërkonin të shkonin për një periudhë afatshkurtër dhe afatmesme, prej gjashtë muajve (37%) deri në dy vjet (34%). Një grup i madh i të rinjve (44%), të cilët thanë se do të dëshironin të shkonin jashtë vendit, pohuan se ishin ftuar ose e kishin mbështetjen e individëve që jetonin në vendin e tyre të dëshiruar të destinacionit, duke sugjeruar që ekzistenca e një diaspore të kosovarëve që tashmë kanë emigruar në një vend pritës i kontribuon shumë emigrimit të ardhshëm në vendin në fjalë. Sipas studimit, numri i kosovarëve që janë potencialisht të gatshëm të emigrojnë është rreth 129 000. Një anketë tjetër e 1 100 personave, e realizuar në dhjetor 2019 nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D), zbuloi se 59.4% e të anketuarve do të dëshironin të largoheshin nga Kosova, me 31.4% që dëshirojnë të largohen përgjithmonë. Arsytet më të theksuara për largim nga vendi ishin pamundësia e të anketuarve për të gjetur punë që përputhej me profilin e tyre arsimor (26%), arsyet e lidhura me familjen (24%) dhe kërkimi i mundësive më të mira për zhvillim profesional dhe karrierë (22%). Gjermania dhe Zvicra ishin vendet kryesore të destinacionit (55%), pasuar nga SHBA-ja (10%).

3.3. Punësimi dhe papunësia sipas profesionit: karakteristikat kryesore

Individët në profesione të shërbimeve, të shitjes dhe në profesione elementare karakterizohen nga përqindjet më të larta të punësimit. Sipas statistikave të AFP-së së Kosovës, Tabela A7 në Shtojcën 2 tregon përqindjet e grupeve profesionale nga punësimi i përgjithshëm ndërmjet vitit 2014 dhe 2019. Në vitin 2019, punëtorët e shërbimit dhe

punëtorët e shitjes në dyqane dhe në treg (23.3%) dominonin në punësim, të pasuar nga ata në profesionet elementare (21.1%) dhe profesionistët (15.9%). Siç tregohet në studimin e Bankës Botërore dhe wiiw (2020), punëtorët e përqendruar në sektorët me shkathtësi të ulëta dhe me intensitet të lartë të punës nuk janë aq të përgatitur për t'u ballafaquar me ndryshimin e natyrës së vendit të punës. Edhe pse ata përfaqësojnë kosto të ulët të punës, ata nuk janë konkurrues në një botë në të cilën teknologjia e nxit produktivitetin. Përbërja e të papunëve sipas profesionit, që është në dispozicion nga anketa e MCC LFTUS 2017, tregohet në Tabelën A7. Është interesant se profesionet që janë më të përhapura ndër individët e punësuar janë gjithashtu më të përhapurat në mesin e të papunëve: 31.3% e të papunëve janë punëtorë të shërbimeve dhe shitjeve, dhe 23.6% janë të profesioneve elementare.

Shkalla e papunësisë ndryshon sipas fushës së studimit. Sipas gjetjeve të MCC LFTUS 2017, nivelet më të larta të papunësisë u gjetën ndër individët që studiojnë biznes (31.1%), prodhimtari dhe ndërtimtari (28.8%) dhe shkenca të jetës (25.9%), ndërsa nivelet më të ulëta të papunësisë u gjetën ndër individët që studiojnë për shërbime (12%), programe të përgjithshme²⁶ (12.3%) dhe inxhinieri (13.2%). Arsytet për papunësi dallonin, në një farë mase, për meshkuj dhe femra. Ndërsa arsyet për meshkujt lidheshin kryesisht me faktorët dhe rregulloret e tregut të punës (largimi nga puna ose teprica, kontrata të kufizuara, arsim ose trajnim etj.), femrat gjithashtu theksuan përgjegjësitë familjare, si kujdesi për fëmijët (6.5%), familja/bashkëshorti (bashkëshortja) nuk e mbështet punën (4.6%) dhe shtatzënia/lindja (1.7%)²⁷. Një mjedis diskriminues ose i pasigurt i punës u përmend nga vetëm 5.4% e individëve të papunë, dhe vlerësimi ndryshonte pak ndërmjet meshkujve dhe femrave. Mungesa e transportit të sigurt u përmend nga 1.6% e individëve të papunë.

Rezultatet e anketës së MCC LFTUS tregojnë se sektorët më të popullarizuar për individët e papunë për të kërkuar punë ishin aktivitetet e shërbimit (16.8%), tregtia me shumicë e pakicë – riparimi i automjeteve dhe motoçikletave (16.7%), dhe ndërtimtaria (12.6%). Sektorët më tërheqës për gratë ishin tregtia me shumicë e pakicë (23.7%), aktivitetet e shërbimeve të tjera (21.5%) dhe arsimi (12%). Nga ana tjetër, sektorët për të cilët burrat ishin më të interesuar ishin ndërtimtaria (22.2%), aktivitetet e shërbimeve të tjera (13%) dhe tregtia me shumicë e pakicë (11.3%). Sipas vlerësimit të GAP-it (2020), shërbimet administrative dhe mbështetëse dhe ndërtimtaria janë ndër pesë profesionet më të mira në Kosovë me një shkallë të ulët të papunësisë dhe tendencë të lartë për migrim. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të papunësisë në profesionet si bujqësia, pylltaria dhe peshkataria, dhe financat dhe sigurimet, individët me këto profesione mund të kenë më shumë gjasa për të migruar.

Kutia 1: Emigrimi i profesionistëve shëndetësorë kosovarë

Sipas Agjencisë Federale Gjermane të Punësimit, 7 204 kosovarë ishin duke punuar në sektorin mjekësor në vitin 2019, që pasqyron një rritje prej 809 krahasuar me vitin e kaluar²⁸. I njëjti burim thekson se kërkesa për punëtorë të kujdesit shëndetësor pritet të rritet, sepse, sipas parashikimeve, Gjermania do të ketë mungesë të përafërsisht 200 000 punëtorëve të kujdesit shëndetësor brenda pesë vjetësh. Sektori i kujdesit shëndetësor në Kosovë ka më shumë punëtorë se që mund t'i akomodojë (GAP, 2020). Sipas Odës së Mjekëve të Kosovës, në dhjetor 2019 kishte më shumë se 600 mjekë në vend. Prej tyre, 60 ishin specialistë të papunë si pasojë e mospërputhjes/kufizimeve buxhetore midis numrit të studentëve në fusha specifike dhe vendeve të lira të punës. Oda lëshoi 115 dokumente mbështetëse të migrimit për mjekë në vitin 2019, por vetëm 5 në vitin 2018 (GAP, 2020). Sfidat shtesë të ngutshme për Kosovën janë mosha mesatare e mjekëve, e cila është 53 vjet, dhe fakti që Ministria e Shëndetësisë nuk po hap pozita të reja.

Siç u raportua nga Ahmetxhekaj (2019), një profesor i neuropsikiatrisë në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Prishtinës ka deklaruar se 95% e studentëve janë duke mësuar gjermanisht dhe synojnë të shkojnë në Gjermani. Kryetari i Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) tha në një intervistë për Institutin GAP se çdo vit rreth 350 studentë të infermierisë diplomohen nga sistemi arsimor publik dhe 4 000 diplomohen nga

²⁶ Programet dhe kualifikimet themelore, shkrim-leximi dhe numërimi, dhe shkathtësitë dhe zhvillimi personal.

²⁷ Përgjigjet e grave duket se kanë të bëjnë më shumë me arsyet e pasivitetit sesa me papunësinë, sepse statusi i papunësisë nënkupton që një person kërkon aktivisht punë. Nëse jo, personi konsiderohet joaktiv.

²⁸ Shih raportin e lajmeve në DW: <https://www.dw.com/en/balkan-nurses-headed-to-german-hospitals-a-lush-business-for-intermediaries/a-51960206>

sistemi privat. Në vitin 2018, 1 400 të diplomuar konkurruan për 100 pozita të lira të infermierisë. Në vitin 2020, 608 mjekë të rinj u punësuan për të ndihmuar gjatë pandemisë, dhe 1 500 të diplomuar në shëndetësi u angazhuan në fusha të specializuara. Në një anketë të zhvilluar nga FSSHK-ja në vitin 2014, 60.6% e infermierëve të anketuar u përgjigjën se ishin të gatshëm të emigronin, arsyet kryesore të tyre ishin paga më e lartë (29%) dhe zhvillimi profesional (27%). Sipas Institutit Gjerman për Hulumtime të Punësimit (2019), kërkesa për punësim në kujdesin shëndetësor do të vazhdojë të rritet në të ardhmen për shkak të trendeve aktualë sociale dhe ekonomike. Ministri gjerman i Shëndetësisë, Jens Spahn, e vizitoi Kosovën në korrik 2019, me ç'rast njoftoi se Gjermania ka nevojë për 70 000 infermierë. Shqetësimi i ngritur nga kryetari i FSSHK-së është se infermierët fillimisht rekrutohen për të ofruar kujdes për të moshuarit dhe për të kryer detyra të tjera të ngjashme, d.m.th. shkathtësitë e tyre janë të pashfrytëzuara. Arsyeja kryesore është se këto profesione nuk plotësohen lehtësisht në Gjermani, por gjithashtu sepse shumica e kualifikimeve që jepen në Kosovë nuk njihen në Gjermani (GAP, 2020).

4. Formimi dhe migrimi i kapitalit njerëzor

Nivelet e arritjes arsimore në Kosovë janë përmirësuar dukshëm. Braktisja e shkollës para kohe²⁹ nga individët e moshës 18–24 vjeç ka rënë nga 18.4% në vitin 2012 në 8.2% në vitin 2019. Përmirësime më të mëdha janë vërejtur te femrat, te të cilat braktisja e shkollës para kohe ra për 11.7 pikë përqindjeje nga viti 2012 në vitin 2018, në krahasim me 6.4 pikë përqindjeje për meshkuj (shih Tabelën A8). Megjithatë, pjesëmarrja e të rriturve në mësimin gjatë tërë jetës (% e moshës 25–64 vjeç) ka qenë në përgjithësi e ulët (2.7% në vitin 2019) (shih Tabelën A13, nga ETF, 2020a).

Ndonëse qasja në arsim është rritur, cilësia e arsimit në Kosovë mbetet problem. Sipas një studimi të fundit nga Banka Botërore³⁰, një fëmijë që e fillon shkollën në moshën 4 vjeçare në Kosovë mund të presë t'i përfundojë 13.2 vjet shkollë deri në ditëlindjen e vet të 18-të. Megjithatë, me rastin e faktorizimit të asaj që fëmijët vërtet mësojnë, vitet e pritshme të shkollimit ulen në vetëm 7.9 vjet, që do të thotë se ka një mospërputhje të të nxëniet prej 5.3 vjetësh. Një fëmijë i lindur në Kosovë sot do të jetë 57% produktiv, sa edhe do të mund të ishte kur të rritej po të gëzonte arsim të nivelit të mesëm dhe shëndet të plotë. Kjo përqindje është më e ulët se mesatarja për rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore, por pak më e lartë se mesatarja për vendet me të ardhura të mesme të larta.

Sipas testit PISA, në vitin 2018, 78.7% e nxënësve të moshës 15 vjeçare nuk ia dolën t'i arrijnë shkathtësitë minimale në lexim, ndërsa në matematikë shifra ishte 77.7% dhe në shkenca 67.7%. Edhe pse rezultatet e nxënësve në matematikë u përmirësuan pak në krahasim me vitin 2015, rezultatet e tyre në lexim dhe shkencë u përkeqësuan (shih Tabelën A6). Në testet e harmonizuara, nxënësit në Kosovë shënojnë 374 pikë në një shkallë ku 625 pikë janë arritje e përparuar dhe 300 pikë janë arritje minimale.

Statistikat e AFP-së tregojnë se përqindja e popullsisë së moshës 30–34 vjeç me arsim të lartë u rrit nga 9.3% në vitin 2012 në 20.9% në vitin 2018. Një përmirësim më i madh vërehet te femrat, përqindja e të cilave u rrit nga 6.5% në vitin 2012 në 20.8% në vitin 2018, në krahasim me 12.1% për meshkuj në vitin 2012 dhe 20.9% në vitin 2018 (shih Tabelën 6). Ndërsa arritjet në arsimin e lartë janë përmirësuar, numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë në institucionet private dhe publike të arsimit të lartë (IAL) ra nga 33 526 në vitin 2015/16 në 20 461 në vitin 2019/2020 (shih Tabelën A10). Në shpjegime të mundshme për këtë rënie përfshihen nivelet më të ulëta të lindjeve (nga 22.8 lindje për 1000 persona në vitin 2000 dhe 21.7 në vitin 2001 deri në 18.3 në vitin 2003)³¹, tendencat për migrim dhe planet e të rinjve. Kjo pasqyrohet në një rënie të ndjeshme të numrit të përgjithshëm të studentëve nga 101 959 në vitin 2014/15 në 62 905 në vitin 2019/2020. Ndërsa regjistrimi në arsimin e lartë ka

²⁹ Braktisja e hershme e arsimit dhe aftësimin definohet si përqindja e popullsisë së moshës 18–24 vjeç me arsim të mesëm të ulët që nuk ishin regjistruar në arsim ose aftësim të mëtejshëm gjatë katër javëve para kësaj ankete. ETF-ja e bëri këtë vlerësim duke i përdorur të dhënat e ASK-së.

³⁰ Kumtesa për shtyp e Bankës Botërore: <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2020/09/16/kosovo-human-capital-index-lower-than-regional-average-but-higher-than-the-average-for-its-income-group-says-world-bank-report>

³¹ Shih <https://data.worldbank.org/indicator/SP.DYN.CBRT.IN?locations=XK&view=chart>

qenë i lartë (përkundër numrit në rënie e sipër), një numër i vogël i studentëve diplomon çdo vit, që arrin në gjithsej 47 519³² në katër vjet akademike, pra 2014/15, 2015/16, 2017/18 dhe 2018/19 (shih Tabelën A11).

Tabela 6: Arritja në arsimin terciar (% e moshës 30–34 vjeç)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	9.3	12.0	14.8	17.2	19.1	21.8	20.9
Meshkuj	12.1	14.2	16.6	19.5	18.9	22.4	20.9
Femra	6.5	9.9	13.0	14.7	19.4	21.2	20.8


Burimi: ASK, Anketa e fuqisë punëtore, marrë nga ETF 2020a

Në vitin 2018, më shumë se gjysma e nxënësve të shkollave të mesme të larta (52.9%) ishin regjistruar në shkollat e AAP-së. Programet e AAP-së ishin më tërheqëse për djem (61.5% ishin të regjistruar në shkollat e AAP-së) sesa për vajza (44.1%), (shih Tabelën A12). Në numra absolutë, 42 888 nxënës mësonin në shkolla profesionale në vitin 2018. Sipas fushës së studimit, në vitin shkollor 2017/18, 36.4% e nxënësve ishin regjistruar në fushën e ekonomisë, 34.5% në fushat teknike dhe 17.3% në mjekësi (shih Tabelën A16). Dallimet gjinore u vunë re në fushën e mjekësisë, e cila përfshinte gati 30% të të gjitha femrave të regjistruara (por vetëm 9.4% të meshkujve), ndërsa përfaqësimi i femrave në fushat teknike ishte shumë më i ulët se ai i meshkujve (20.9% në krahasim me 43.7 %).

4.1. Rrjedha e migrimit sipas nivelit arsimor

Në përgjithësi, periudha prej vitit 2016 deri në vitin 2018 karakterizohet nga emigrimi i konsiderueshëm neto, i cili vlerësohet në rreth 53 000 individë (shuma e të gjitha grupeve, përfshirë grupin e të porsaardhurve) bazuar në qasjen e grupit të Leitner-it (për më shumë shpjegime, shih Aneksin 1, dhe Leitner, 2021). Pothuaj gjysma e këtyre emigrantëve ishin kosovarë me arsim të mesëm të përgjithshëm (26 000 persona), të pasuar nga kosovarët me arsim të ulët (17 000 persona) dhe ata me arsim të lartë (11 000) (shih Figurën 8). Për dallim, ekziston imigrimi neto i individëve, niveli më i lartë i arsimit të të cilëve është arsimi profesional.

Figura 8: Migrimi neto sipas arritjes arsimore, 2016–2018




Burimi: Leitner (2021), llogaritjet janë bazuar në të dhënat e AFP-së të siguruar nga ASK-ja.

Në periudhën 2016–2018, të gjitha grupet, përveç atyre të moshës 30–34 dhe 35–39 vjeç, përjetuan emigrim neto të individëve me arsim të mesëm të përgjithshëm. Emigrimi neto është më i larti ndër grupet e moshës 15–19 dhe 20–24 vjeç, posaçërisht të atyre në të 20-at e tyre, në periudhën e analizuar (d.m.th. grupi i moshës 15–19 vjeç). Për dallim, kishte imigrim neto ndër grupet e moshës 30–34 dhe 35–39 vjeç, posaçërisht midis grupit më të vjetër

³² Të dhënat për vitin 2014/15 për institucionet private të arsimit të lartë mungojnë, prandaj ky numër është i nënvlerësuar.

të moshës 35–39 vjeç, që i përfshin personat në 40-at e tyre ndërmjet vitit 2016 dhe 2018. Ngjashëm, përveç grupit të të porsaardhurve, të gjitha grupet përjetuan emigrim neto ndër personat me arsim të ulët. Ngjashëm me grupin e mëparshëm, emigrimi neto i personave me arsim të ulët është gjithashtu më i lartë ndër individët që ishin në të 20-at e tyre në periudhën e analizuar (d.m.th. grupi i moshës 15–19 vjeç) Në funksion të moshës së tyre të re, emigrimi i konsiderueshëm neto i personave me arsim të mesëm të përgjithshëm ose arsim të ulët ka të ngjarë të nxitet kryesisht nga ribashkimi familjar dhe vazhdimi i arsimit të mëtejshëm dhe punësimit jashtë vendit. Për dallim, ka imigrim neto edhe te individët, niveli më i lartë i arsimit të të cilëve është arsimi profesional: përveç grupeve të moshës 20–24 dhe 35–39 vjeç, të gjitha grupet përjetuan imigrim neto, posaçërisht grupet e moshës 15–19 dhe 30–34 vjeç³³.

Figura 9: Migrimi neto sipas grupmoshës dhe arritjes arsimore, 2016–2018



Burimi: Leitner (2021), llogaritjet janë bazuar në të dhënat e AFP-së të siguruar nga ASK-ja.

Shënim: Kllapat e moshës i referohen moshës në fillim të periudhës në vitin 2010. Prandaj, të gjitha grupmoshat kanë qenë të moshës ndërmjet gjashtë dhe tetë vjet deri në periudhën 2016-2018. Qasja e grupit e përaftron migrimin neto përmes ndryshimeve në madhësinë e grupit ndërmjet dy vjetëve radhazi. Prandaj, viti 2016 – viti i parë i raportuar këtu – i referohet ndryshimit midis viteve 2015 dhe 2016. Nivelet arsimore ndahen në katër kategori: i ulët (arsimi fillor ose i mesëm i ulët), i mesëm i përgjithshëm (arsimi i përgjithshëm i mesëm i lartë /gjimnazi), AAP i mesëm (arsimi dhe aftësimi profesional i mesëm i lartë), dhe i lartë (arsimi terciar), bazuar në ISCED. Numrat negativë tregojnë emigrimin neto, ndërsa numrat pozitivë tregojnë imigrimin neto.

Ka edhe dëshmi të ikjes së trurit gjatë periudhës 2016-2018 (shih Figurën 9). Emigrimi neto i personave me arsim të lartë vërehet në të gjitha grupmoshat, përveç grupmoshave 30–34 dhe 35–39 vjeç. Dy grupet e fundit tregojnë një imigrim neto (d.m.th. fitim të trurit), i cili është më i lartë në grupmoshën 30–34 vjeç, por i papërfillshëm në grupmoshën 35–39 vjeç. Në përgjithësi, ikja e trurit është më e larta në grupmoshën 15-19 vjeç, e cila i përfshin personat që ishin në të njëzetat në periudhën e analizuar. Kjo sugjeron që shumica e personave me arsim të lartë largohen nga Kosova menjëherë pas mbarimit të arsimit terciar. Perspektivat më të mira të punësimit dhe paga më e lartë jashtë vendit konsiderohen motivet e tyre kryesore për migrim. Në përgjithësi, emigrimi neto kumulativ i personave shumë të arsimuar gjatë periudhës vlerësohet në 11 000 persona.

4.2. Programet për arsim dhe aftësim të (bashkë)financuara ndërkombëtarisht

Skema “Young Cell” është një projekt i financuar nga BE-ja që u ka ofruar të rinjve kosovarë bursa në institucionet arsimore më me reputacion të BE-së për shumë vjet. Skema synon ta mbështesë Qeverinë e Kosovës në ndërtimin e një shërbimi civil profesional, të bazuar në merita, të përgjegjshëm dhe apolitik në të gjitha nivelet përmes një

³³ Imigrimi neto i kosovarëve me arsim profesional mund të lidhet me eksodin masiv të vitit 2014/15 për në BE dhe me kthimin pasues të azilkërkuesve të dështuar kosovarë gjatë viteve në vijim. Për më shumë diskutim, shih Leitner, 2021.

programi të bursave që mëton ta përmirësojë kapacitetin profesional të shërbimit civil për t'u shërbyer më mirë qytetarëve të Kosovës dhe për t'i përmbushur sfidat dhe detyrimet që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së. Prej vitit 2004 deri në vitin 2019, projekti organizoi 12 raunde përzgjedhëse dhe ndau 363 bursa për qytetarët e rinj të Kosovës që kanë diplomë BA, në mënyrë që ata të regjistrohen në programe specifike MA, MSc dhe LLM në universitetet e BE-së³⁴. Fituesit e bursave morën pjesë në programet master në shumë universitete të BE-së dhe patën mundësi të specializohen në fusha të ndryshme, si në ekonomi, drejtësi dhe politikë, dhe në shkencat të mjedisit, studime bujqësore, statistikë, siguri dhe rregulla të aviacionit, inxhinieri, telekomunikacion, siguri ushqimore etj. Prej 200 studentëve që e kanë përfunduar programin e bursave, rreth 85% tani punojnë për qeverinë e Kosovës në nivele të ndryshme në një sërë zyrash, në ministritë e linjës, në Ministrinë e Integritetit Evropian dhe në autoritete të pavarura, si në Bankën Qendrore (Këshilli Britanik, 2015). Pas kthimit të tyre, ata kanë për obligim kontraktual të qëndrojnë të punësuar për së paku tri vjet rresht në shërbimin civil të Kosovës. Kjo konsiderohet si një praktikë e mirë që duhet të vazhdohet dhe të zgjerohet për një numër më të madh të përfituesve.

Erasmus+ ka qenë një nga programet kryesore për lëvizshmërinë afatshkurtër të studentëve dhe të stafit akademik të Kosovës. Studentët zakonisht e kalojnë një semestër në një universitet evropian dhe më pas i vazhdojnë studimet në shtëpi. Gjatë periudhës 2015–2019, numri i stafit dhe studentëve nga Kosova që morën bursa Erasmus+ Lëvizshmëria ndërkombëtare e kredive (ICM) ishte 4 177. Disa dëshmi mbi statusin e punësimit të alumneve që e kanë kaluar një pjesë të studimeve, praktikës ose aktiviteteve vullnetare në një nga vendet e programit Erasmus+, qoftë si bursist i një vendi të BE-së ose jo të BE-së, ose si individ i vetëfinancuar, u vunë në dispozicion përmes një ankete të realizuar nga Shoqata e Alumneve të Ballkanit Perëndimor në vitin 2017. Studimi përfshiu 145 të anketuar nga Kosova, 83 % e të cilëve kishin studiuar në një nga vendet³⁵ e programit Erasmus+. Anketa zbuloi se 28% kanë diplomë në shkencat shoqërore dhe sociale, 8% në shkencat humane, 14.5% në inxhinieri, 12.4% në administrim të biznesit dhe 10.3% në informatikë dhe TI. Në mesin e të anketuarve, 62% ishin të punësuar ose të vetëpunësuar në kohën e realizimit të anketës, që është një shkallë më e lartë se në vendet e tjera (mesatarja është 58.5%), dhe gjysma prej tyre ofronin shërbime arsimore.

Kosova ka një numër të madh të institucioneve të arsimit të lartë, 17 institucione për një milion banorë krahasuar me shtatë për një milion banorë në BE (KEEN, 2017). Siç u cek më lart, numri i studentëve të regjistruar rishtazi është duke rënë, dhe kjo rënie reflektohet gjithashtu në një numër në përgjithësi më të ulët të studentëve në arsimin e lartë (si privat, ashtu dhe publik). Deri më tani, sistemi arsimor publik nuk i ka marrë parasysh tendencat e migrimit, ndërsa disa IAL private ofrojnë programe studimi – kryesisht në sektorin e shëndetësisë – që e përgatisin fuqinë punëtore për emigrim. Përveç kësaj, sistemi arsimor nuk ka bërë asnjë përparim në përmirësimin e cilësisë së arsimit (Komisioni Evropian, 2020a) në mënyrë që ta rrisë perspektivën e të diplomuarve në Kosovë dhe t'i përgatisë për punë të denjë në vendet kryesore të destinacionit.

Tani janë duke u zhvilluar disa projekte për ta përmirësuar rëndësinë e arsimit për nevojat e tregut të punës. Për shembull, ALLED 2 (Përafrimi i arsimit për punësim) është një projekt i financuar nga BE-ja brenda zarfit financiar IPA II 2017 për Kosovën me bashkëfinancim nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA). ALLED 2 synon t'i zhvillojë dhe modernizojë programet e arsimit të lartë sipas nevojave të tregut të punës; t'i përmirësojë programet e trajnimit për mësimdhënës sipas kërkesave të kurrikulës së re të Kosovës dhe prioriteteve të Ministrisë së Arsimit; dhe ta rrisë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies praktike dhe të aplikuar në shkollat e AFP-së dhe Qendrat e Aftësimit Profesional (QAP) në sektorët kryesorë të profesionit, që janë të rëndësishëm për nevojat e tregut, përfshirë udhëzimet për karrierë dhe këshillim³⁶. Dy projekte të LuxDev-it, përfshirë një të financuar nga IPA II 2018, e mbështesin riorganizimin dhe forcimin e strukturave qeverisëse të AAP-së në Kosovë përmes ndihmës në fushat e përgjegjësisë, organizimit të brendshëm të palëve të interesuara, një modeli të ri të biznesit për

³⁴ <http://eyca-kosova.org/about-us/>

³⁵ BE-28 shtete anëtare, Maqedonia e Veriut, Islanda, Norvegjia, Lihtenshtajni, Turqia

³⁶ Për më shumë informata, shih [Alled2](#), në ueb faqen zyrtare të projektit "Përafrimi i arsimit dhe aftësimin me nevojat e tregut të punës – ALLED Faza II", zbatuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Tani diskutimet janë duke u zhvilluar për vazhdimin e projektit si ALLED 3.

menaxhimin e shkollave, partneriteteve publiko-private, zhvillimit të kapacitetit dhe digjitalizimit të proceseve. Projektet e LuxDev-it i mbështesin tetë institucione të AAP-së që specializohen, ndër fusha të tjera, në kujdesin shëndetësor dhe në ekonomi.

Duke pasur parasysh kërkesën për infermierë në Evropë, posaçërisht në Gjermani, disa institucione private të arsimit të lartë e kanë zgjeruar ofertën e tyre arsimore. Një praktikë e mirë është zbatuar nga Kolegji Heimerer, i cili është themeluar në Prishtinë në vitin 2010 dhe është në bashkëpunësi të dy partnerëve, një gjerman dhe një kosovar. Kolegji zbaton një model plotësisht operacional me dy drejtime, duke i trajnuar studentët në Kosovë për mundësi pune si në Gjermani, ashtu edhe në tregjet lokale të Kosovës (Clemens, 2019). Kolegji specializohet në shkathtësitë shëndetësore, duke ofruar programe në fushat si infermieri dhe terapi e të folurit, si dhe diplomë master në menaxhimin e shëndetit. Në dhjetor 2018, Kolegji kishte 1 700 studentë. Prej tyre, 960 u regjistruan në programin e infermierisë dhe 60% e studentëve të infermierisë, synonin të diplomonin dhe të kishin qasje në mundësitë për migrim për punë në tregjet gjermane. Është më e zakonshme për punëdhënësit e parashikuar që ta paguajnë tarifën për mësimin e gjuhës, ndërsa vetë kolegji financohet nga pagesat e shkollimit. Kostoja e trajnimit të pjesëmarrësve dhe e funksionimit të institucionit është dukshëm më e ulët sesa trajnimi dhe operimi në Gjermani. Kolegji gjithashtu ka pasur përfitime më të gjera për ndërtimin e kapaciteteve. Ai ka sjellë shkathtësi dhe pedagogji të reja të kujdesit shëndetësor në tregun e trajnimeve të kujdesit shëndetësor në Kosovë, të cilat kanë hyrë në rrjetet e ofruesve lokalë dhe kjo i ka ndihmuar Ministrinë e Shëndetësisë që t'u shtojë sektorë të rinj prioritetive të saj të trajnimit dhe njohjes. Si mënyrë për menaxhimin e migrimit, Kolegji gjithashtu ka krijuar një rrugë ligjore përveç flukseve të migrimit të parregullt që janë të zakonshme nga Kosova për në Gjermani. Kjo i ka lehtësuar kanalet e rregullta, duke çuar në punë më të mira dhe më të sigurta për migrantët kosovarë.

Një tjetër praktikë e mirë që është zbatuar në Kosovë nga GIZ-i është Trajnimi në vendin e prejardhjes. Ky projekt e zhvendos një pjesë të madhe të trajnimit të migrantëve jashtë Gjermanisë në vendin e tyre prejardhjes, duke sjellë përfitime për Kosovën përmes kërimit të bashkëpunimit teknik për ta rritur cilësinë dhe anën teknike të mjediseve të trajnimit, nga i cili përfitojnë migrantët e mundshëm dhe vendasit (Clemens, 2019). Projekti e bashkon trajnimin e migrantëve të mundshëm me trajnimin e jo-migrantëve, rritjen e kapitalit njerëzor në Kosovë dhe futjen e shkathtësive dhe të teknologjisë së re në tregun e brendshëm të punës. Pilot projekti financohet 60% nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe pjesërisht nga Ministria e Ekonomisë në Bavari. Qasja është duke u zhvilluar në sektorin e ndërtimtarisë, duke u mbështetur në një projekt ekzistues që i solli pjesëmarrësit kosovarë në Gjermani për t'u trajnuar. Në këtë projekt të ri me mënyrë të dyfishtë, pjesa më e madhe e trajnimit teknik do të kryhet në Kosovë, me mundësi të përfshirjes së disa vizitave tremujore të punës praktike në Gjermani për pjesëmarrësit e mënyrave 'të largëta' për të fituar përvojë praktike. Pjesëmarrësit në mënyrën 'e largët' do të trajnohen në Institutin e GIZ-it në Prishtinë dhe më pas do të migrojnë në Gjermani për të punuar në sektorin e ndërtimtarisë. Trajnimet në 'shtëpi' do të mbahen në të njëjtin Institut në Prishtinë dhe do të riintegrohen në tregjet lokale të Kosovës, ku ka kërkesë të madhe për punëtorë në ndërtimtarë.

Edhe pse kuptohet që rinia ka më shumë të ngjarë të emigrojë, janë bërë përpjekje të kufizuara për t'i përmirësuar mundësitë për punësim dhe për t'i korrigjuar faktorët shtytës për të rinjtë. Në prill 2019, Parlamenti i Kosovës e mbajti një seancë të posaçme mbi eksodin e të rinjve, i cili, sipas deputetëve, kishte ndikim shumë të dëmshëm në ekonominë dhe në të ardhmen e vendit (Begisholli, 2019). Megjithatë, asnjë hap nuk është ndërmarrë për ta adresuar këtë sfidë urgjente për Kosovën.

Edhe pse vendi nuk ka ndonjë orientim strategjik për reformimin e sistemit të arsimit dhe aftësimin në kontekst të migrimit, disa zhvillime mund të ndikojnë në rezultate në këtë drejtim. Për shkak të kërkesës së madhe, Agjencia e Punësimit është në proces të organizimit të njohjes së shkathtësive të mësimin paraprak. Një përfaqësues i Agjencisë së Punësimit raporton se, me mbështetjen e GIZ-it në Kosovë, planifikojnë të fillojnë ta njohin mësimin paraprak për saldim, i cili kërkohet në Gjermani, posa ta marrin akreditimin përkatës nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit (AKK). Certifikatat e tilla mund të përdoren për të gjetur punë jashtë vendit. Ata tashmë kanë përgatitur aplikacione dhe personel të trajnuar në Kosovë dhe Gjermani, dhe GIZ-i ka ndihmuar në pajisjen e një punëtorie

për saldim. Shumë shpejt AKK-ja do t'i trajnojë koordinatorët, mentorët dhe një ekip vlerësues, që do të jetë i gatshëm të kryejë vlerësime për njohjen e mësimit paraparak, pasi të kenë përfunduar certifikimi dhe akreditimi. Sipas përfaqësuesit të Agjencisë së Punësimit, planifikohet që ky shërbim të përfshihet si masë e re aktive e tregut të punës dhe më pas të zgjerohet në shërbim për profesione të tjera. Përveç kësaj, Agjencia e Punësimit vazhdimisht i përditëson kurrikulat e trajnimit për t'u përshtatur me ndryshimet në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe certifikatat që lëshohen dhe vulosen nga Agjencia njihen në shtetet anëtare të BE-së. Një projekt i LuxDev-it, që është pjesë e projektit të BE-së për Rikualifikim Profesional dhe Profesion, ofron mbështetje shtesë për njohjen e mësimit paraparak. Ai kërkon ta sigurojë njohjen e mësimit paraparak në Kosovë në sektorët dhe profesionet më të nevojshme ekonomike. Qëllimi është të rritet punësimi dhe të sigurohen mundësi për mësim gjatë tërë jetës për të rriturit.

4.3. Efekti i përzier i migrimit në arsim

Mundësia e migrimit ndikon në zgjedhjen e studimeve për profesione, veçanërisht të rinjtë. Sipas një përfaqësuesi të Departamentit për Aftësim Profesional të Agjencisë së Punësimit, kërkesa për studime në profesionet si industria e metaleve (kryesisht saldimi), ndërtimtaria dhe gastronomia (pjekja, pastat dhe ëmbëlsirat) është rritur viteve të fundit (intervistë me Agjencinë e Punësimit). Edhe pse aplikantët nuk tregojnë se trajnimi i tyre është për qëllime të emigrimit, ata kërkojnë certifikata të vulosura që nevojiten për njoftimin dhe njohjen e certifikatave nga Ministria e Punëve të Jashtme. Si rrjedhojë, numri gjithnjë e më i madh i certifikatave të nënshkruara është shenjë e dëshirës së madhe për të emigruar.

Remitencat mbeten burim i rëndësishëm financiar për familjet e Kosovës. Rezultatet e anketës së MCC LFTUS 2017 tregojnë se 20.2% e familjeve kanë marrë remitencë nga jashtë. Frekuenca e remitencave është më e lartë në zonat rurale (21.4% e familjeve) sesa në zonat urbane (16.1%). Për marrësit e remitencave, ato përbëjnë 47.7% të ardhurave të përgjithshme të familjes dhe përqindja për zonat rurale (48.4%) është më e madhe sesa për zonat urbane (44.6%). Në përputhje me provat e mëparshme, anketa zbuloi se remitencat përdoren kryesisht për t'i mbuluar nevojat e konsumit (61.4%), ndërsa vetëm 4.7% e marrësve të remitencave raportojnë për shpenzime të lidhura me arsimin. Anketa e paraqitur në Raportin e Zhvillimit Njerëzor në Kosovë (UNDP, 2014a) tregon se edhe pse shuma është e vogël të terma të vlerës absolute, në terma relativë marrësit e remitencave shpenzuan 11% më shumë në arsim sesa jo-përfituesit. Megjithatë, anketa më tej tregon se remitencat nuk konsideroheshin si parashikuese të rëndësishme të arritjes arsimore për të rinjtë e moshës 16-25 vjeç në Kosovë. Shumica e individëve që marrin remitencë raportuan se dërguesi i remitencave ishte ose një djalë ose një vëlla më i madh, mungesa e të cilit ndikon negativisht në arritje arsimore në dy mënyra: (i) krijon kushte për djemtë adoleshentë më të rinj për t'u marrë me veprimtari që nuk lidhen me arsimin; dhe (ii) synon të ushtrojë presion mbi fëmijët që qëndrojnë në shtëpi, duke e rritur nivelin e përgjegjësi të tyre familjare dhe duke prodhuar efekt negativ në aspiratat e tyre arsimore (UNDP, 2014a).

5. Marrëdhëniet trekëndore

Cilësia e dobët e arsimit mund të jetë një nga arsytet e emigrimit gjatë dekadës së kaluar. Arritjet arsimore në Kosovë janë rritur me kalimin e kohës, kryesisht përmes zgjerimit të institucioneve private dhe publike të arsimit të lartë. Siç raportohet në KEEN (2017), Kosova kishte 17 institucione të arsimit të lartë për një milion banorë dhe renditej më lart se të gjitha vendet e tjera fqinje (16 në Bosnje dhe Hercegovinë, 13 në Shqipëri, 12 në Kroaci, 10 në Maqedoninë e Veriut, 5 në Serbi etj.). Për sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm, raporti i vitit 2017 gjithashtu dokumentoi që nxënësve kosovarë u mungojnë shkathtësitë themelore (siç tregohet nga rezultatet e tyre në PISA 2015 dhe 2018). Mospërputhja e politikave arsimore, eksperimentet me reforma të ndryshme dhe mungesa e mësimdhënësve cilësorë janë disa nga faktorët që kanë kontribuar në performancën e dobët. Duke pasur parasysh mungesën e analizës sistematike të nevojave të tregut të punës qoftë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), qoftë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), oferta arsimore nuk i pasqyron plotësisht nevojat e tregut të punës. Nga ana tjetër, kjo ndikon negativisht te punëdhënësit, por gjithashtu i detyron të diplomuarit të punojnë në profesione që nuk përputhen me shkathtësitë dhe kompetencat e tyre. Në efekte të tjera kryesore përfshihen pasiviteti i lartë dhe nivelet e ulëta të punësimit në vend. Një sistem i mësimi gjatë tërë jetës nuk është duke u zhvilluar në Kosovë dhe ka ofertë të kufizuar të trajnimit në vend të punës dhe të trajnimit për të rriturit për ta përmirësuar mospërputhjen e shkathtësive.

Disa praktika të mira kanë ndikuar në marrëdhëniet trekëndore ndërmjet migrimit, kapitalit njerëzor dhe tregut të punës. Skema “Young Cell”, që u përshkrua më herët, është një praktikë e mirë që ka ofruar mundësi studimi për kosovarët, të cilët, pas përfundimit të studimeve, janë të detyruar të punojnë për qeverinë për disa vjet. Bazuar në informatat e mbledhura për këtë studim, kërkesa për punë e ka stimuluar kthimin e studentëve në Kosovë, ka kontribuar në bartjen e njohurive dhe ka ndikuar në përhapjen e njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve në tregun e punës në Kosovë. Angazhimi i akademikëve dhe ekspertëve të diasporës ka qenë një nga qëllimet e Ministrisë së Diasporës, por ende nuk është raportuar për rezultate. Programet e tilla do të ishin të dobishme për Kosovën duke nxitur bartjen e shkathtësive teknike jo vetëm në sektorin publik dhe privat, por edhe në institucionet e arsimit të lartë përmes ndikimit të tyre në përditësimin e kurrikulës së studimeve dhe metodologjive të mësimdhënies. Këto gjithashtu do ta forconin lidhjen e diasporës me vendlindjen e tyre.

Përveç kësaj, ekziston mungesa e të dhënave për migrantët e kthyer të cilat do të mundësonin që Kosova t’i profilizojë migrantët, t’i kuptojë arsytet e tyre për kthim dhe t’i identifikojë sfidat dhe mundësitë me të cilat ata përballen me rastin e kthimit të tyre.

Pagat relativisht të ulëta që ofrohen në Kosovë mund të shpjegohen nga kënaqësia e ulët e punëdhënësve me shkathtësitë e punëtorëve. Paga mesatare në vitin 2018 ishte 411 euro, por ishte më e lartë në sektorët si TIK-u, ku cilësia e fuqisë punëtore konsiderohet e mirë. Pagat e ulëta janë një nga faktorët shtytës për emigrim, posaçërisht ndër të rinjtë. Paga minimale e caktuar në 170 euro në vitin 2011 nuk është përshtatur asnjëherë me kushtet e jetesës ose me situatën e tregut të punës. Debatet aktuale (kryesisht premtimet) që dëgjohen në kohën e zgjedhjeve propozojnë rritjen e pagës minimale në 300 euro, por një rritje e tillë është kundërshtuar fuqimisht nga punëdhënësit, të cilët konsiderojnë se nuk do të përputhej me produktivitetin e fuqisë punëtore dhe aftësinë e tyre për të paguar për rritje.

Një zhvillim pozitiv ka qenë rritja në nënkontraktimin e shërbimeve, veçanërisht në sektorin e TI-së, që është një komponent i rëndësishëm në marrëdhëniet trekëndore ndërmjet migrimit, kapitalit njerëzor dhe tregut të punës. Në vend se të emigrojnë jashtë vendit, disa të rinj kosovarë punojnë për tregje ose kompani ndërkombëtare. Kjo kontribuon në punësim, por gjithashtu ushtron presion për ta avancuar kapitalin njerëzor në mënyrë që Kosova të bëhet një nga destinacionet më tërheqëse për shërbime të biznesit, veçanërisht në nënkontraktimin e procesit të biznesit dhe të procesit të informacionit (Proper ICT, 2019). Faktorët kryesorë që i kontribuojnë një avantazhi krahasues në këto fusha u raportuan të jenë efektiviteti i kostos, profesionistë shumë të aftë dhe të arsimuar mirë të TI-së, shkathtësitë gjuhësore, zona e përshtatshme kohore dhe lehtësia e fillimit të një biznesi dhe e të bërit biznes.

Deri vonë, Kosova kishte një Ministri të veçantë për Inovacion dhe Ndërmarrësi, që përqendrohej në mbështetjen e ideve inovative dhe start-up-eve [ndërmarrjeve] të reja. Duke pasur parasysh mundësinë për të punuar për kompani ndërkombëtare, kërkesa për studime në fushën e TIK-ut është rritur viteve të fundit. Një studim i vitit 2019, i realizuar nga STIKK (2019) në 38 kompani të TIK-ut, zbuloi se 61% punojnë me klientë ndërkombëtarë, kryesisht në këto shërbime: zhvillim me porosi/nënkontraktim (42%), optimizim i procesit të biznesit (34%), dizajnim i uebit, zhvillim dhe këshillim për TI-në. Promovimi dhe mbështetja e zhvillimit të sektorit të TIK-ut do të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës, në uljen e emigrimit dhe në zhvillimin e shkathtësive sipas kërkesave të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar. Një projekt i financuar nga BE-ja, *Përkrahja e BE-së për konkurrueshmërinë e Kosovës në sektorin e TIK-ut*, synon ta rrisë konkurrueshmërinë e bizneseve digjitale dhe tradicionale të Kosovës duke e përkrahur rritjen e sektorit të TIK-ut të Kosovës që shpie në rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës. Ky projekt u përqendrua në ofrimin e trajnimeve dhe kurseve për TIK, shkathtësi digjitale dhe menaxhim të Biznesit³⁷.

Tendenca e lartë për të emigruar, e cila tregohet nga disa studime të përmendura në këtë raport, mund të ushtrojë presion në tregun e punës, së paku në periudhën afatmesme, veçanërisht ndër individët me arsim më të ulët se terciar. Ligji i ri i Gjermanisë për imigrimin e fuqisë punëtore të kualifikuar, i vitit 2020, pritet t'i inkurajojë punëtorët e kualifikuar për të emigruar. Përveç kësaj, sapo të përfundojë pandemia dhe kriza ekonomike që lidhet me të dhe të bëhet liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, mund të ketë flukse në vendet e tjera si Kroaci, që vuajnë nga emigrimi dhe/ose demografia e përkeqësuar (d.m.th. një popullsi në plakje). Rreziku i emigrimit të vazhdueshëm ndër profesionistët shëndetësorë përmendet shpesh nga mediat dhe kjo çështje është ngritur nga Shoqata e Profesionistëve të Shëndetësisë. Megjithatë, nuk ka plane konkrete për t'i rritur pagat e mjekëve dhe infermierëve, që është faktori kryesor shtytës.

Vendimet e arsimit për t'u trajnuar për tregun gjerman të punës nuk janë strategjia më e mirë. Ndërsa kishte kërkesë për disa profesione në Gjermani (si vendi kryesor i destinacionit), kjo mund të mos jetë kështu në vitet në vijim, pasi situata me pandeminë COVID-19 ka ndryshuar. PBB real i Gjermanisë ka rënë për 11.3% ndërmjet tremujorit të parë dhe të dytë të vitit 2020, ndërsa papunësia arriti kulmin në 6.4% në gusht të vitit 2020 dhe niveli i vendeve të lira të punës ka rënë nga 3.3% në fund të 2019 në 2.1% në fund të vitit tremujorit të dytë të vitit 2020 për shkak të kërkesës më të ulët për fuqi të re punëtore (GAP, 2021). Përveç kësaj, rregulli i ri i Rregullores së Ballkanit Perëndimor për t'i vendosur aprovimet e Agjencisë Federale të Punësimit në 25,000 në vit për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2023 do ta ulë migrimin nga secili vend i synuar, përfshirë Kosovën. Raporti i GAP-it (2021) vlerëson rreth 7,500 aprovime paraprake nga Kosova çdo vit deri në vitin 2023 krahasuar me 17,000 mesatarisht para kufizimit. Duke qenë se jo të gjithë aplikantët do të marrin viza pune, vetëm rreth 2,000 migrantë potencialë priten në vit nga Kosova. Si rrjedhojë, kjo do të thotë se të diplomuarve në disa profesione nuk do t'u realizohen ëndrrat e tyre për emigrim, por do të qëndrojnë në Kosovë (ku ka mungesë të kërkesës për kualifikimet e tyre, të cilat janë marrë për tregjet ndërkombëtare) ose do të detyrohen të punojnë punë të pakualifikuara në vendet pritëse. Si rrjedhojë, të rinjtë mund të dekurajohen nga vlerësimi i arsimit dhe stimulimi i tyre për të studiuar mund të zvogëlohet. Midis rrezikut të njohur të emigrimit të të rinjve, Qeverisë së Kosovës i mungon një politikë gjithëpërfshirëse e migrimit që i merr parasysh marrëdhëniet trekëndore ndërmjet migrimit, kapitalit njerëzor dhe tregut të punës. Siç u përmend më lart, Parlamenti i Kosovës e miratoi një rezolutë për ta luftuar emigrimin e të rinjve, por ende nuk janë marrë hapa konkretë. Nuk ka pasur asnjë zbatim të Planit të Veprimit për Punësimin e të Rinjve 2018-2020, i cili supozohej të dizajnohej të detyrohej që synonin posaçërisht të rinjtë. Së fundi, Strategjia për Diasporën 2019-2023 nuk përfshin ndonjë masë për ta trajtuar emigrimin, por është e përqendruar plotësisht në marrëdhëniet me diasporën aktuale. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale siguron informacion për migrantët e mundshëm, por nuk ka statistika dhe nuk i përcjell klientët e saj. Përveç kësaj,

³⁷ Ka filluar në janar 2020 dhe zgjat deri në korrik 2023. Zbatohet nga WeGlobal në partneritet me European Projects Management [Menaxhimi i Projekteve Evropiane] dhe Prishtina REA. Projekti synon ta plotësojë boshllëkun e shkathtësive digjitale dhe të biznesit në një mënyrë të qëndrueshme që i plotëson nevojat e tregut dhe e rrit konkurrueshmërinë e bizneseve digjitale dhe tradicionale të Kosovës, dhe që e rrit eksportin e bizneseve kosovare të TIK-ut dhe të bizneseve tradicionale përmes përdorimit të TIK-ut. Për më tepër informata, shih <https://ictkosovo.eu/>.

Shërbimet Publike të Punësimit mund të kontribuojnë në zhvillimin e shkathtësive dhe ta mbështesin integrimin e të papunëve në tregun e punës, të cilët, tani për tani, nuk shohin zgjidhje tjetër përveç emigrimit.

6. Ndikimi i pandemisë COVID-19

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, PBB-ja ra për 4.1% në vitin 2020, që është më pak sesa pritej fillimisht. Megjithatë, pandemia e ka vënë tregun e punës nën presion të fortë. Për sa i përket situatës së punësimit, statistikat për tre tremujorët e parë të vitit 2020 tregojnë se punësimi shënoi rënie për 4%, ndërsa papunësia u rrit për një pikë përqindjeje në 26.5%. Sektorët që i ofrojnë burimet kryesore të punësimit – tregtia me pakicë dhe ndërtimtaria – janë sektorët që janë goditur më së shumti nga pandemia. Anketa e Bankës Botërore Puls i Biznesit në Kosovë (Banka Botërore, 2020b) tregon se shumica e bizneseve e shkurtojnë orarin e punës, ndërsa rruga e tyre kryesore për rregullimin e punësimit ishte t'u jepnin pushim të punësuarve.

Për ta matur ndikimin e krizës COVID-19 në Kosovë, UNDP-ja realizoi një anketë me 1 412 familje dhe 212 biznese në maj dhe nëntor 2020 (UNDP, 2021). Në nëntor 2020, 11% e të anketuarve raportuan se e kishin humbur punën, krahasuar me 8% në maj. Shumica e atyre që e humbën punën nuk morën mbështetje financiare ose përfitime papunësie nga institucionet qendrore (81%) ose komunat (91%). Në maj 2020, 23% e bizneseve deklaruan se pandemia kishte ndikim shumë negativ. Numri u rrit për 32 pikë përqindjeje në 55% në nëntor 2020. Mungesa e klientëve (89%), vështirësitë në pagimin e pagave (39%) dhe vështirësitë në përmbushjen e detyrimeve tatimore (33%) u dalluan si tri sfidat kryesore për bizneset në nëntor 2020. Arsimi ishte një sektor tjetër i goditur rëndë nga pandemia. Pati vështirësi në qasje në platformat e mësimin në internet; teknologjia nuk ishte në dispozicion as për mësimdhënës, as për studentë në shumë raste; dhe një numër i mësimdhënësve nuk i kishin shkathtësitë e nevojshme teknike dhe pedagogjike për t'i përdorur pajisjet digjitale në procesin e mësimin.

Konsumi i qeverisë pritet të rritet dukshëm bazuar në buxhet, por edhe për shkak të reagimit të duhur ndaj COVID-19, ndërsa disa projekte të mëdha të investimeve publike, që pritej të shpiheshin përpara, si projektet për hekurudha dhe rrugë të financuara nga institucionet financiare ndërkombëtare, mund të vonohen (Banka Botërore, 2020c). Qeveria e ka hartuar Ligjin për rimëkëmbjen ekonomike, që u miratua në fillim të dhjetorit 2020, për ta rritur ekonominë; një nga masat e parashikuara në plan është lejimi i qytetarëve për t'i tërhequr deri në 10% të kursimeve të tyre nga Trusti Pensional. Megjithatë, bazuar në analizën statistikore, ndikimi mund të jetë i kufizuar sepse gjysma e të gjithë kontribuuesve të pensioneve mund t'i tërheqin vetëm deri në 73 euro (dhe 30% vetëm deri në 9 euro). Qeveria i ka zbatuar disa masa për t'i mbështetur bizneset (përmes subvencionimit të pagave) dhe familjet (përmes paradhënies dhe mbështetjes shtesë për përfituesit e ndihmës sociale dhe pensionistët). Këto masa dhe masat e tjera të parashikuara në Programin për rimëkëmbjen ekonomike dhe në Ligjin për rimëkëmbjen ekonomike pritet ta ofrojnë një shtysë të rëndësishme financiare për ekonominë. Mirëpo, nëse gjendja me COVID-19 përkeqësohet, masa të reja kufizuese mund të zbatohen dhe ta rrisin nivelin tashmë të lartë të papunësisë.

Pasi sistemi i përfitimeve sociale në Kosovë është i dobët, remitencat shihen si rrjeti kryesor i sigurisë gjatë pandemisë; kjo e shpjegon rritjen e remitencave (shih më lart).

7. Konkluzionet dhe implikimet politike

7.1. Konkluzionet

Migrimi është një tipar i Kosovës që është zgjeruar dhe bërë më i rëndësishëm viteve të fundit. Nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e emigrantëve, por llogaritet të jenë ndërmjet 550 000 (bazuar në regjistrimin e vitit 2011) dhe 700 000 (ose madje deri në 900 000). Arsyet për migrim që lidhen me punën po rriten me ritëm të shpejtë, duke përbërë 38% të lejeve për herë të parë në vitin 2019 krahasuar me 17% në vitin 2010, ndërsa arsyet që lidhen me familjen kanë rënë nga 63% në 21% gjatë të njëjtës periudhë. Planet e emigrantëve kosovarë për të jetuar jashtë

nuk duket të jenë të përkohshme, pasi 60% e lejeve për herë të parë në vitin 2019 ishin lëshuar për më shumë se 12 muaj, 32% për 6 deri në 11 muaj dhe vetëm 8% për 3 deri në 5 muaj (Eurostat) Prandaj, emigrimi pritet të ketë ndikim afatgjatë në demografinë dhe fuqinë punëtore të Kosovës.

Të rinjtë dhe personat me arsim të mesëm dhe të ulët e kanë tendencën më të lartë për të emigruar. Kjo është gjetja kryesore nga një qasje e grupit duke i përdorur të dhënat e AFP-së për periudhën 2016–2018 (Leitner, 2021). Rezultatet sugjerojnë që emigrimi neto është më i larti te të rinjtë (d.m.th. grupet e moshës 15-19 dhe 20-24 vjeç), të cilët përballen me një shkallë shumë të lartë të papunësisë dhe me perspektiva të dobëta për punësim në të ardhmen. Përveç kësaj, emigrimi neto është më i larti ndër personat me arsim të mesëm të përgjithshëm dhe arsim të ulët, ndërsa personat me arsim të mesëm profesional përjetuan imigrim të lehtë neto (kryesisht migrantët që kthehen pas përvojës së punës jashtë vendit). Në përputhje me gjetjet e Komisionit Evropian (2020a) se emigrimi i punëtorëve të kualifikuar paraqet një sfidë të madhe për perspektivat ekonomike afatmesme, qasja e grupit gjen prova të ikjes së trurit gjatë periudhës 2016-2018. Sipas Leitner (2021), kjo periudhë e karakterizon emigrimin neto të të shkolluarve në të gjitha grupet, përveç dy grupeve më të vjetra. Emigrimi neto i personave shumë të arsimuar është përgjithësisht më i larti ndër individët në të njëzetat e tyre (d.m.th. grupi i moshës 15-19 vjeç), që sugjeron se shumica largohen menjëherë pas diplomimit në kërkim të perspektivave më të mira për punësim dhe paga më të larta jashtë vendit. Gjatë pesë vjetëve të fundit ka pasur rritje të interesit ndër profesionistët shëndetësorë për të emigruar, kryesisht për shkak të pagave relativisht të ulëta në Kosovë (vetëm 600 euro në muaj) dhe rritjes së kërkesës në vendet si Gjermania.

Gjermania mbetet vendi kryesor i destinacionit. Në vitin 2019, gjysma e 43 677 lejeve për herë të parë, të lëshuara në BE-28 për qytetarët kosovarë, u lëshuan nga Gjermania. Megjithatë, të dhënat e fundit tregojnë se kosovarët po zgjedhin gjithashtu të shkojnë në Kroaci, Slloveni dhe Francë. Hapja e tregut të punës në Gjermani për vendet e Ballkanit Perëndimor ka çuar në rritje të numrit të aplikimeve për punë në Gjermani. Ligji i Gjermanisë për imigrimin e kualifikuar, i vitit 2020, i ka lehtësuar procedurat për punëtorët e kualifikuar, duke i dhënë leje pune secilit që arrin ta marrë një kontratë pune në profesionet e mbuluara. Lidhjet e forta me diasporën në Gjermani do ta mbështesin emigrimin e kosovarëve pas përfundimit të krizës COVID-19.

Kosova nuk ka përfituar nga arritjet arsimore, kryesisht për shkak të dështimit për ta përshtatur arsimin me nevojat e tregut të punës. Në vitin 2018, rreth 21% e personave të moshës 30–34 vjeç e kishin përfunduar arsimin e lartë, krahasuar me 9.3% në vitin 2012. Zgjerimi i arsimit të lartë ka qenë rezultat i një numri të madh të institucioneve të arsimit të lartë publik dhe privat dhe gjithashtu i tarifave shumë të ulëta të shkollimit në IAL-të publike (pa pagesë për studentët e vitit të parë dhe 50 euro në vit për vitet vijuese). Megjithatë, të dhënat e paraqitura në këtë raport tregojnë për një trend në rënie në numrin absolut të studentëve në arsimin e lartë, i cili potencialisht ndikohet nga nivelet e ulura të lindshmërisë, mungesa e besimit në përfitimet nga diplomat e arsimit të lartë dhe planet për të emigruar. Cilësia e arsimit mbetet sfidë urgjente për Kosovën, siç tregojnë rezultatet e PISA-s 2018. Deri më tani, asnjë analizë nuk i ka ekzaminuar arsyet dhe faktorët që e shpjegojnë performancën e dobët, dhe nuk ka ndonjë plan ose strategji për ta përmirësuar gjendjen. Anketat ekzistuese të punëdhënësve tregojnë për mungesë të stafit të kualifikuar, që sugjeron një mospërputhje ndërmjet arsimit dhe nevojave të tregut të punës. Përveç kësaj, ofrimi i kufizuar i trajnimit në ndërmarrje dhe mbulimi i ulët i të papunëve nga masat aktive të tregut të punës lënë të kuptohet që sistemi në tërësi nuk arrin t'i plotësojë boshllëqet e shkathtësive që rezultojnë nga sistemi arsimor.

Gjendja në tregun e punës në Kosovë nuk është premtuese. Rritja e qëndrueshme pozitive ekonomike e vendit nuk është përkthyer në krijim të duhur të vendeve të punës. Përkundër kostove të ulëta të fuqisë punëtore, një përqindjeje të lartë të popullsisë së re, një pozite të favorshme gjeografike dhe një sistemi të favorshëm tatimor, Kosova nuk ka arritur t'i tërheqë IHD-të, të cilat mund të sigurojnë stimuj për reformimin e sistemit të arsimit dhe/ose të aftësisë. Siç është raportuar nga Jovanović et al. (2021), ndërsa të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor kanë stimuj të drejtpërdrejtë financiarë për IHD-të, Kosova ende nuk ofron stimuj të drejtpërdrejtë financiarë për IHD-të. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor paraqesin dobësi sa i përket qeverisjes, infrastrukturës dhe arsimit, duke treguar për rëndësinë e përmirësimit të cilësisë së fuqisë punëtore si një aspekt të rëndësishëm

për t'i tërhequr IHD-të (Jovanović et al., 2021). Dhjetë zona ekzistuese ekonomike në Kosovë ende nuk kanë dhënë rezultate, ndërsa vendet fqinje kanë përfituar (p.sh. Maqedonia e Veriut dhe Serbia).

Mundësitë e vogla për gjetjen e një vendi të punës, mungesa e vendeve të mira të punës, dhe kushtet e përgjithshme të këqija të jetesës (përfshirë shëndetin, mbrojtjen sociale dhe aspekte të tjera) janë faktorët kryesorë shtytës të kosovarëve për emigrim. Vështirësitë për të gjetur punë në sektorin publik për shkak të nepotizmit dhe përkatësisë politike, pagat e ulëta në sektorin privat, shkalla e lartë e varfërisë në punë, mungesa e sigurisë në punë dhe e kushteve të mira të punës për shkak të punësimit të përkohshëm dhe joformal, dhe nën-punësimi janë sfida urgjente për kosovarët. Edhe pse një nga pasuritë kryesore të Kosovës, potenciali i të rinjve të saj mbetet shumë i papërdorur, me vetëm 13% të të rinjve ishin të punësuar në vitin 2019 (ASK). Si rrjedhojë, të rinjtë vendosin të emigrojnë dhe ka rritje të kërkesave për kurse të gjuhës, kryesisht për gjuhën gjermane

Mungesa e informacionit sistematik për nevojat e shkathtësive po i pengon përfitimet reciproke nga migrimi. Edhe pse emigrimi konsiderohet si kërcënim për zhvillimin ekonomik të Kosovës në periudhën afatmesme dhe afatgjate, asnjë hap konkret nuk është ndërmarrë për ta adresuar këtë sfidë serioze, përveç disa rezolutave deklarative. Siç është raportuar në Strategjinë Sektoriale 2018-2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ka informacion të kufizuar mbi nevojat aktuale dhe afatmesme (strukture ose të përkohshme) të tregut të punës në sektorë të ndryshëm ekonomikë dhe profesione, dhe ka informacion të kufizuar mbi mungesën e shkathtësive. Qasja në një analizë të tillë mund të ndihmojë në ndalimin e largimit nga profesionet ku ka mungesë të fuqisë punëtore dhe ta lehtësojë migrimin e individëve në profesionet ku ka tepri të fuqisë punëtore, e që kërkohen në vendet e tjera. Kufiri i imigrimit i vendosur rishtas nga Gjermania për 25,000 migrantë nga vendet e Ballkanit Perëndimor deri në vitin 2023 sugjeron që vendimet e arsimit të përqendruara vetëm për tregjet ndërkombëtare mund të mos jenë strategjia më e mirë dhe mund të sjell rreziqe.

7.2. Implikimet politike

1. Kosova duhet të zhvillojë politika për migrimin ekonomik. Aparati administrativ që merret me diasporën, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duhet t'i zgjerojë aktivitetet e saj përtej mbështetjes së diasporës në vendet pritëse. Ministria duhet ta adresojë gjithashtu rritjen e mundshme të emigrimit të fuqisë punëtore, si fuqinë punëtore me shkathtësi të ulët deri në të mesme, ashtu edhe fuqinë punëtore me shkathtësi të mesme deri në të lartë. Kjo posaçërisht është e rëndësishme në lidhje me Gjermaninë, që është vendi kryesor i destinacionit për shumë kosovarë që planifikojnë të emigrojnë.
2. Institucionet e Kosovës si Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencia e Punësimit duhet t'i koordinojnë përpjekjet e tyre për ta trajtuar migrimin ekonomik. Përfaqësuesit e biznesit dhe këshillat dhe organizatat e rinisë gjithashtu duhet të angazhohen në mënyrë aktive në këtë proces. Plani i veprimit për punësimin e të rinjve 2018-2020, i cili u hartua në përgjigje të një kërkesë nga Komisioni Evropian, nuk është zbatuar ende. Plani i veprimit duhet të rishikohet për të shërbyer si udhëzues për secilin institucion përgjegjës dhe të monitorohet siç duhet për të siguruar që punësimi dhe shkathtësitë e të rinjve mbështeten.
3. Institucionet e Kosovës duhet t'i intensifikojnë përpjekjet e tyre për ta menaxhuar migrimin ekonomik. Së pari, duhet të bëhet një analizë e duhur dhe të zbatohen masa për ta parandaluar ikjen e profesioneve deficitare dhe për ta lehtësuar migrimin e individëve në profesionet suficitare që kërkohen në vendet e tjera. Së dyti, mund të nënshkruhen marrëveshje bilaterale të punës me vendet kryesore të destinacionit për ta lehtësuar migrimin qarkor duke i mbrojtur të drejtat e migrantëve, duke e ndarë koston e migrimit (për udhëtim, mësim të gjuhës etj.), dhe duke hartuar procedura të shpejta dhe të parashikueshme të migrimit. Së treti, duhet të rriten kapacitetet e institucioneve, si Divizioni për Shërbime të Migrimit brenda Agjencisë së Punësimit, për të siguruar që emigrantët e mundshëm të marrin udhëzime të përditësuara. Roli i Agjencisë së Punësimit në ofrimin e shërbimeve këshillimore është gjithashtu me interes kryesor për t'i informuar individët e papunë për perspektivat e tyre në tregun e punës dhe përfshirjen e tyre të mundshme në programet e trajnimit që janë në përputhje me nevojat e tregut të punës.

4. Duhet të forcohen marrëdhëniet me Gjermaninë. Ka prova që Ligji i Gjermanisë për imigrimin e kualifikuar do ta inkurajojë emigrimin ekonomik nga Kosova për në Gjermani. Duke pasur parasysh faktin që diaspora e Kosovës është mjaft e organizuar dhe e lidhur me Kosovën, roli i qeverisë duhet të jetë të krijojë stimuj për diasporën që të kthehet përgjithmonë ose përkohësisht për t'i bartur njohuritë në Kosovë. Pakti i ri i BE-së për Migrimin dhe Azilin, që u shpall nga Komisioni Evropian më 23 shtator 2020, mund ta ofrojë një mundësi në këtë drejtim, për shkak se ai i përfshin dy propozime për menaxhimin e migrimit të fuqisë punëtore në BE (KE, 2020b). Propozimi i parë është fillimi i Partneriteteve të Talenteve me vendet e treta të interesuara për të krijuar mundësi më të mira pune në shtëpi dhe rrugë ligjore për në BE, duke filluar së pari me vendet fqinje të BE-së, Ballkanin Perëndimor, dhe Afrikën. Kjo do ta përfshinte bashkëpunim gjithëpërfshirës me vendet partnere për të ndihmuar në rritjen e lëvizshmërisë së dobishme ndërkombëtare. Propozimi i dytë është krijimi i një Grupi të Talenteve të BE-së për shtetas të kualifikuar të vendeve të treta që do të mund të shërbente si platformë e gjerë e BE-së për rekrutime ndërkombëtare, duke u mundësuar punëtorëve të kualifikuar për ta shprehur interesin e tyre për të migruar në BE dhe më pas për t'u identifikuar nga autoritetet e BE-së për migrim dhe nga punëdhënësit bazuar në nevojat e tyre.
5. Praktikën e mira të zbatuara nga Kolegji Gjerman Heimerer dhe GIZ-i mund të mbështeten, inkurajohen dhe zgjerohen, pasi ato investojnë në zhvillimin e shkathtësive jo vetëm të migrantëve të mundshëm, por edhe të jo-migrantëve; ato i inkurajojnë investimet në institucionet e trajnimit në Kosovë dhe shërbejnë si burim për institucionet që kërkojnë t'i përditësojnë kurrikulat e tyre të arsimit dhe aftësisë.
6. Nismat për zhvillimin e kapitalit njerëzor, si skema Young Cell dhe programi Erasmus+, duhet të mbështeten dhe zgjerohen edhe më tej. Duhet të forcohet kërkesa për të diplomuarit që të kthehen në shtëpi dhe për institucionet publike që t'i punësojnë të diplomuarit pas kthimit të tyre. Kjo do ta mundësojë bartjen e shkathtësive dhe do të ndihmojë në rritjen e cilësisë së institucioneve publike. Përveç kësaj, duhet të zhvillohen dhe përkrahen nismat që i nxisin emigrantët të kthehen. Qëllimi i Strategjisë Kombëtare për Diasporën për ta lehtësuar angazhimin e ekspertëve të diasporës në Kosovë duhet të zbatohet me masa konkrete dhe mekanizma nxitës.
7. Ndërsa menaxhimi i migrimit është një aspekt i rëndësishëm, qëllimi kryesor i politikave dhe ndërhyrjeve të Kosovës duhet të drejtohet në krijimin e vendeve të punës. Përveç mbështetjes së sektorit të TIK-ut për zgjerimin e tij të mëtutjeshëm, qeveria e Kosovës duhet të identifikojë sektorë të tjerë dhe të prezantojë stimuj për zhvillimin e rrjeteve/grupeve të furnizuesve. Politikën për zhvillim industrial duhet të jenë përparësi për qeverinë. Ndërsa programet fillestare janë zbatuar nga ministri të ndryshme të linjës dhe organizata ndërkombëtare, fokusi duhet të drejtohet në mbështetjen e NVM-ve ekzistuese në transformimin e tyre në kompani me rritje të shpejtë që janë kryesore për gjenerimin e punësimit. Tërheqja e IHD-ve është e një rëndësie qendrore për krijimin e vendeve të punës, por edhe për zhvillimin e kapitalit njerëzor, prandaj, qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë hapa dhe masa konkrete për ta përmirësuar infrastrukturën, qeverisjen dhe cilësinë e arsimit. Në këtë drejtim, Kosova duhet të mësojë nga praktikën e suksesshme të zonave ekonomike në rajon (d.m.th. Maqedonia e Veriut dhe Serbia).
8. Duke pasur parasysh shkallën shumë të lartë të papunësisë dhe pasivitetit ekonomik, politikëbërësit duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të rinjve kosovarë. Plani për ta prezantuar zbatimin e skemave "Youth Guarantee" në kuadër të programit IPA 2022 në Kosovë është premtues. Nëse zbatohet, të gjithë të rinjtë nën moshën 30 vjeçare do ta marrin një ofertë cilësore për punësim, arsimim të vazhdueshëm, punë praktike ose trajnim brenda një periudhe të shkurtër kohore pasi të kenë mbetur pa punë ose pasi ta kenë mbaruar arsimin formal. Kjo gjithashtu do t'i rriste shërbimet për udhëzim dhe këshillim në karrierë, programet e zhvillimit të shkathtësive në sektorë premtues si TIK-u, mbështetjen për kërkim të punës, subvencione për punësim, si dhe programe për vetëpunësim dhe themelimin e bizneseve/start-up për të rinjtë. Angazhimi i nxënësve/studentëve në programe të praktikës ka qenë premtim i shumë qeverive, por ka pasur sukses vetëm në një masë të kufizuar. Sapo të mbarojë kriza COVID-19, është shumë me rëndësi të bëhet përparim në këtë fushë në mënyrë që studentët të aftësohen në fushat e tyre të studimit.

9. Zgjerimi i politikave aktive të tregut të punës për të rriturit ka rëndësi të madhe për ta rritur shkallën e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore, e cila ishte 40.5% në vitin 2019 dhe vetëm 21.1% për gratë. Përditësimi i skemave ekzistuese të trajnimit është një nga qëllimet e përcaktuara në Strategjinë Sektoriale 2018-2020 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, nuk është bërë asnjë përparim që vlen të përmendet dhe Qendrat për Aftësim Profesional vazhdojnë të ofrojnë trajnime tradicionale që kanë lidhje të kufizuar me nevojat e tregut të punës.
10. Ekziston nevoja për monitorim më të mirë të tregut të punës në Kosovë, kryesisht për sa i përket parashikimit të nevojave të tregut të punës për shkathtësi në sektorë të ndryshëm dhe identifikimit të listave të profesioneve deficitare. Edhe pse po diskutohet për disa pilot iniciativa për projektet e financuara nga BE-ja në këtë fushë (p.sh. planet për prodhimin e një barometri të tregut të punës), ai është larg nga profesionet dhe shkathtësitë për të cilat dihet se mungojnë për shkak të migrimit të fuqisë punëtore. Nevojiten hapa konkretë për ta harmonizuar më mirë arsimin me nevojat e tregut të punës të vendit. Përveç monitorimit më sistematik të tregut të punës, kjo kërkon krijimin e aleancave të forta me punëdhënësit dhe angazhimin e tyre të plotë e cilësor në këtë proces.
11. E fundit, por jo më pak e rëndësishmja, Kosova duhet të mbledhë të dhëna sistematike për emigrantët dhe emigrantët që kthehen. Të dhënat e tilla do ta ofronin një bazë për hartimin e politikave të bazuara në të dhëna. Regjistrimi i ardhshëm i popullsisë, i planifikuar për vitin 2022, mund ta plotësojë këtë boshllëk nëse mblidhen informatat përkatëse. Pyetësi ekzistues i regjistrimit për të afërmit e familjeve që jetojnë jashtë Kosovës për më shumë se 12 muaj kërkon informata për: marrëdhëniet me kryefamiljarin, vitin e lindjes, vendin e lindjes, vitet që kur janë larguar nga Kosova, vendin e qëndrimit të zakonshëm, arsyet e largimit nga Kosova, dhe shpeshësinë e vizitave në Kosovë. Mund të shtohen më shumë pyetje në pyetësor për t'i trajtuar arritjet arsimore dhe përvojën e punësimit të emigrantëve dhe të të kthyerve kosovarë.

Referencat

- Ahmetxhekaj, Sh. (2019), 'I kja e trurit: A do t'i fikë dritat mjeku i fundit që largohet nga Kosova?', BIRN, 4 dhjetor 2019: <https://balkaninsight.com/2019/12/04/brain-drain-will-the-last-doctor-in-kosovo-turn-out-the-lights/>
- Bami, X. (2019), 'Kosova nuk arrin t'i mbrojë të drejtat e diasporës dhe ta shfrytëzojë potencialin', BIRN, 1 nëntor 2019: <https://balkaninsight.com/2019/11/01/kosovo-failing-to-protect-diaspora-rights-and-tap-potential/>
- Begisholli, B. (2019), 'Parlamenti i Kosovës debaton për eksodin masiv të të rinjve', Balkan Insight, 11 prill 2019: <https://balkaninsight.com/2019/04/11/kosovo-parliament-debates-mass-exodus-of-young/>
- Bither, J. and Ziebarth, A. (2018), *Krijimi i rrugëve ligjore për ta zvogëluar migrimin e parregullt? Çfarë mund të mësojmë nga "Rregullorja e Ballkanit Perëndimor" e Gjermanisë*, Grupi i Strategjisë së Migrimit për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ndërkombëtar, Bertelsmann Stiftung, Fondi Marshall Gjerman i Shteteve të Bashkuara, Robert Bosch Stiftung: <http://www.gmfus.org/sites/default/files/Creating%20Legal%20Pathways%20to%20Reduce%20Irregular%20Migration.PDF>
- Këshilli Britanik (2015), *Arsimi i lartë për reformën e administratës publike në Kosovë*: https://ycskosovo.eu/wp-content/uploads/2015/11/YCS_Expert-Study.pdf
- Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (2020), Buletini Mujor Statistikor, Nr. 230, Prishtinë, Tetor: https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2020/12/CBK_MSB_230_en.pdf
- Clemens M., Dempster H. dhe Gough K. (2019), *Rritja e përfitimeve të përbashkëta të rrugëve të migrimit të ligjshëm: Mësim nga partneritetet e shkathtësive të Gjermanisë*, Qendra për Zhvillim Global Dokumenti Politik 151, Uashington DC: <https://www.cgdev.org/sites/default/files/maximizing-shared-benefits-legal-migration-pathways.pdf>
- Demokraci për Zhvillim (2020), *Planet për emigrim*: <https://d4d-ks.org/infografika/>
- APRK (Agjencia e Punësimit e Kosovës) (2019), *Puna dhe fuqia punëtore 2018*.
- EBRD (2020), *Perspektivat ekonomike rajonale, COVID-19: Nga tronditja në rimëkëmbje, Përditësim i majit 2020*: <https://www.ebrd.com/news/2020/ebd-economies-seen-contracting-by-35-per-cent-in-2020-48-per-cent-rebound-in-2021.html>
- EPIK- Instituti i Politikave Evropiane (2019). *Statistikat e azilit në Bashkimin Evropian*: <https://cdn.website-editor.net/82b242c12494d76b2b60e65852e5f4/files/uploaded/ASYLUM%2520STATISTICS%2520IN%2520THE%2520EUROPEAN%2520UNION.pdf>
- ETF (2019). *Politikat për zhvillimin e kapitalit njerëzor: Kosovë: Një vlerësim i procesit ETF Torino*: https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/2020-03/04_trp_etf_assessment_2019_kosovo_160320.pdf
- ETF (2020a), *Treguesit kryesorë mbi arsimin, shkathtësitë dhe punësimin (KIESE) 2020*, ETF, Turin, 2020a: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/key-indicators-education-skills-and-employment-2020>
- ETF (2020b), *Zhblllokimi i potencialit rinor në Evropën Juglindore dhe Turqi: Zhvillimi i shkathtësive për tregun e punës dhe përfshirja sociale*, 2020b: <https://www.etf.europa.eu/en/publications-and-resources/publications/unlocking-youth-potential-south-eastern-europe-and-turkey>
- ETF (2020c), *Zhvillimet në arsim, trajnim dhe punësim 2020*: <https://www.etf.europa.eu/sites/default/files/document/Country%20Fiche%202020%20Kosovo%20Education%20Training%20and%20Employment%20Developments.pdf>

- Komisioni Evropian (2020a), *Dokumenti i punës së stafit të Komisionit Kosovë* Raporti i vitit 2020* Shoqërimi i komunikimit nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve, Komunikatë e vitit 2020 për politikën e BE-së për zgjerim: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf
- Komisioni Evropian (2020b), *Komunikata e KE-së lidhur me marrëveshjen e re për migrimin dhe azilin*, Bruksel, 23 shtator 2020, COM(2020) 609 final: https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/1_en_act_part1_v7_1.pdf
- Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (2016), Një 'Qasje e sforcuar': http://www.errc.org/uploads/upload_en/file/ec-submission-on-roma-inclusion-in-the-western-balkans-july-2016.pdf
- Eurostat (2019), *Vendet e zgjerimit – statistikat për migrimin, lejet e qëndrimit, shtetësinë dhe azilin*: https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Enlargement_countries_statistics_on_migration_residence_permits_citizenship_and_asylum&oldid=485831#Asylum_applicants_and_first_instance_decisions_in_the_EU
- FES (2015), *Rrjedha e migrimit të Kosovës në Bashkimin Evropian 2015: Kush, Pse dhe Si*: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/13857.pdf>
- GAP (2021), Si do të ndikojë pandemia COVID-19 dhe kufiri i ri i imigracionit të Gjermanisë në migrimin nga Kosova?: [https://www.institutigap.org/documents/5238_immigration_cap\(1\).pdf](https://www.institutigap.org/documents/5238_immigration_cap(1).pdf)
- GAP (2020), *Emigrimi i fuqisë punëtore të Kosovës në Gjermani: Vlerësim i shkurtër i kthimeve pozitive dhe negative*, Instituti GAP, mbështetur nga Njësia Hulumtuese e Këshillit të Ekspertëve të Fondacioneve Gjermane për Integrimin dhe Migracionin (SVR): https://www.institutigap.org/documents/38227_emigration-.pdf
- Gallup International (2019), *Anketë mbi migrimin dhe ikjen e trurit*: <https://exit.al/en/2019/01/05/gallup-survey-on-migration-and-brain-drain/>, Gallup international
- Haxhikadrija A., Mustafa A. dhe Loxha A. (2019), *Varfëria në punë në Kosovë*: [https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=21105&langId=en#:~:text=Kosovo%20has%20a%20high%20in,Household%20Budget%20Survey%20\(HBS\).&text=The%20highest%20decline%20in%20in,%2Deducated%20employees%2C%20and%20women.](https://ec.europa.eu/social/BlobServlet?docId=21105&langId=en#:~:text=Kosovo%20has%20a%20high%20in,Household%20Budget%20Survey%20(HBS).&text=The%20highest%20decline%20in%20in,%2Deducated%20employees%2C%20and%20women.)
- Fondi Monetar Ndërkombëtar FMN (2020), *Perspektiva ekonomike botërore, Bllokimi i madh*, Uashington, Pril: <https://www.imf.org/en/Publications/WEO/Issues/2020/04/14/weo-april-2020>
- Instituti për Kërkime të Punësimit (IAB) (2019), Fuchs, M. and Fritsche B., *Die Gesundheitswirtschaft in Sachsen-Anhalt: Eine Betrachtung des Arbeitsmarktes*: <https://bit.ly/2ktUSIK>
- Jovanović, B., Ghodsi, M., Zijverden, O., Kluge, S., Gaber, M., Mima, R., Hasić, B., Lalović, O., Ibrahim, M., Manova, A.S., Nikolova, S., Čulafić, B., Vasić, J. dhe Mandić, M. (2021), *Forcimi pas COVID-19: Potenciali i afërsisë në Ballkanin Perëndimor*: <https://wiiw.ac.at/getting-stronger-after-covid-19-nearshoring-potential-in-the-western-balkans-dlp-5814.pdf>
- ASK (2013), *Studim për remitencat në Kosovë*: <https://ask.rks-gov.net/media/1712/remittance-2013.pdf>
- ASK (2014), *Migrimi kosovar*: <https://ask.rks-gov.net/media/1379/migrimi-kosovar-2014.pdf>
- ASK (2017), *Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017–2061*: <https://ask.rks-gov.net/media/3741/kosovo-population-projection-2017-2061.pdf>
- ASK (2020). *Niveli i pagave në Kosovë 2012–2019*: <https://ask.rks-gov.net/media/5831/niveli-i-pagave-ne-kosove-2012-2019.pdf>

- ASK (2019), *Rezultatet e Anketës strukturore të ndërmarrjeve 2018*: <https://ask.rks-gov.net/media/5308/results-of-the-structural-business-survey-2018.pdf>
- ASK (2020), *Rezultatet e Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës 2018*, SILC Seria 5: Statistikat Sociale, Agjencia e Statistikave e Kosovës: [AFP2007 \(rks-gov.net\)](AFP2007(rks-gov.net))
- ASK (2021), *Anketa e fuqisë punëtore, Rezultatet TM3 2020*: <https://ask.rks-gov.net/media/5826/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-tm3-2020.pdf>
- Rrjeti i Kosovës për arsim dhe punësim (KEEN), (2017): Vlerësimi i Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 201-2016.
- Zyra Erasmus+ Kosovë. Projektet Erasmus+ për lëvizshmëri ndërkombëtare (2019): <http://erasmuspluskosovo.org/en/erasmus/projects/>
- Qeveria e Kosovës (2019), Projekt strategjia për diasporën 2019–2023: http://konsultimet.rks-gov.net/Storage/Consultations/11-39-02-21062019/State%20Startegy%20on%20Migration_18_06_19_ENG%20-.docx
- Qeveria e Kosovës (2018), Strategjia kombëtare për riintegrim të qëndrueshëm të personave të riatdhesuar në Kosovë: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/54/NATIONAL%20STRATEGY%20FOR%20SUSTAINABLE%20REINTEGRATION%20OF%20REPATRIATED%20PERSONS%20IN%20KOSOVO%202018-2022.pdf>
- Qeveria e Kosovës (2013), *Strategjia shtetërore për migrim dhe Plani i veprimit 2013–2018*: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STATE_STRATEGY_ON_MIRGRATION_ACTION_PLAN_2013-2018.pdf
- Qeveria e Kosovës (2009), *Strategjia kombëtare për migrim 2009–2012*: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_Migracionit_Shqip_Final.pdf
- Kotorri, M., Rizvanolli, A., Peci, F., Kotorri, V., Çitaku, F., Zherka, P. dhe Morina, D. (2013), *Migrimi dhe ndikimet e tij nga perspektiva e zhvillimit ekonomik të vendit të prejardhjes: Me referencë të veçantë për Kosovën*. Projekt i mbështetur nga Universiteti i Friburgut dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Friburg: Universiteti i Friburgut, Instituti i fakultete për Evropën Qendrore dhe Lindore.
- Lavrić, M., Tomanović, S. dhe Jusić, M. (2019), *Studimet për të rinjtë në Evropën Juglindore 2018/2019*. Bon: Friedrich-Ebert-Stiftung.
- Leitner, S. (2021), *Migrimi neto dhe përbërja e shkathtësive të tij në vendet e Ballkanit Perëndimor ndërmjet viteve 2010 dhe 2019: Rezultatet nga një qasje e grupit*, wiiw Dokumenti i Punës nr. 197, [Net Migration and its Skill Composition in the Western Balkan Countries between 2010 and 2019: Results from a Cohort Approach Analysis \(wiiw.ac.at\)](http://www.wiiw.ac.at/Net_Migration_and_its_Skill_Composition_in_the_Western_Balkan_Countries_between_2010_and_2019:_Results_from_a_Cohort_Approach_Analysis)
- Ministria e Punëve të Brendshme (2018), *Profili i lehtë i migrimit në Kosovë*: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/36/Light%20Migration%20Profile%202018.pdf>
- Ministria e Punëve të Brendshme (2019), *Raporti statistikor vjetor*: https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/35/WEB_Raport_2019_English_e.pdf
- OECD (2020), *Kriza Covid-19 në Kosovë*: <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-in-Kosovo.pdf>
- Proper ICT (2019), *Arsyet prapa suksesit të nënkontraktimit të TI-së në Kosovë*, blog i botuar më 11 shkurt 2019: <https://proper-ict.com/reasons-behind-the-success-of-it-outsourcing-in-kosovo/>
- Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (2019), *Barometri i Ballkanit: Raport Analitik i Opinionit Publik*: https://www.rcc.int/seeds/files/RCC_BalkanBarometer_PublicOpinion_2019.pdf
- Rizvanolli, A., Gashi, A., dhe Joshua, L. (2019), *Masat aktive të tregut të punës: A janë vegla efektive për adresimin e sfidave të punësimit dhe aftësimit të fuqisë punëtore në Kosovë?* <https://yesforkosovo.org/wp-content/uploads/2019/12/Report-ENG.pdf>

- SchengenVisaInfo.com: <https://www.schengenvisa.info/news/kosovars-file-less-asylum-applications-in-eu-than-12-visa-free-countries/>
- Siddiqui H., Gashi A., Higgins J., Dasgupta B., dhe Pucilowski M. (2018), *Anketa e fuqisë punëtore dhe shfrytëzimit të kohës në Kosovë*, studim i realizuar sipas kërkesës së Korporatës Sfidat e Mijëvjeçarit: <https://millenniumkosovo.org/wp-content/uploads/2018/11/MCC-Kosovo-Labor-Force-and-Time-Use-Study-Final-Research-Report-1.pdf>
- STIKK-Shoqata e TIK-ut e Kosovës (2019), *Barometri i TI-së në Kosovë 2019*: <https://stikk.org/wp-content/uploads/2020/01/IT-Barometer-2019.pdf>
- STIKK (2018), *Barometri i TI-së në Kosovë 2018*: https://stikk.org/wp-content/uploads/2018/12/Publications_2018_-_IT_Barometer_EN.pdf
- UNDP (2021), *Vlerësimi i shpejtë socio-ekonomik i COVID-19 në Kosovë: Vala 2*: https://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/ResearchAndPublications/SEIA2/SEIA2_Final_eng.pdf
- UNDP (2020), *Analiza e Pulsit Publik: Korrelacioni midis tregut të punës në Kosovës dhe Emigrimit*: <https://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/PPAnalysis19/PPAnalysisEng.pdf>
- UNDP (2015), *Pulsi Publik*: <https://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/pp10/ENG%20version%20Public%20Pulse%20X.pdf>
- UNDP (2014a), *Pulsi Publik*: https://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/PublicPulse/PP7/Public%20Pulse%207%20eng_web.pdf
- UNDP (2014b), *Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë (KHDR) 2014*: <http://hdr.undp.org/sites/default/files/khdr2014english.pdf>
- Shoqata e Alumnive të Ballkanit Perëndimor (2017), *Planifikimi i Alumnive*: <https://www.western-balkans-alumni.eu/research/alumni-mapping/>
- Banka Botërore (2020a), *Indeksi i kapitalit njerëzor 2020, Përditësim: Kapitali njerëzor në kohën e COVID-19*. Banka Botërore, Uashington, DC. © Banka Botërore: <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/34432>
Licenca: CC BY 3.0
- Banka Botërore (2020b), *Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr. 17, Pranverë 2020: Ndikimi ekonomik dhe social i COVID-19, Shënime të vendit*: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/457181588085856454/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-The-Country-Notes.pdf>
- Banka Botërore (2020c), *Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin Perëndimor Nr. 18, Vjeshtë 2020: Një rimëkëmbje e pasigurt*: <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/34644/153774.pdf?sequence=1&isAllowed=y>
- Banka Botërore (2019), *Raporti i vendit për Kosovën: Gjetjet e Anketës prej shkathtësive drejt punësimit dhe produktivitetit*: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/209751557432399449/pdf/Kosovo-Country-Report-Findings-from-the-Skills-towards-Employment-and-Productivity-Survey.pdf>
- Banka Botërore (2017), *Republika e Kosovës Diagnoza Sistematike e Vëndit*: <http://documents1.worldbank.org/curated/en/282091494340650708/pdf/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf>
- Banka Botërore dhe wiiw (2020), *Trendët e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor 2020*, Banka Botërore, Uashington, DC. Banka Botërore: <https://wiiw.ac.at/western-balkans-labor-market-trends-2020-dlp-5300.pdf>

- Banka Botërore dhe wiiw (2019), *Trendet e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor 2019*, Banka Botërore, Uashington, DC.
Banka Botërore: <https://documents.worldbank.org/en/publication/documents-reports/documentdetail/351461552915471917/western-balkans-labor-market-trends-2019>
- Banka Botërore dhe wiiw (2018), *Trendet e tregut të punës në Ballkanin Perëndimor 2018*, Banka Botërore, Uashington, DC.
Banka Botërore k: <http://documents.worldbank.org/curated/en/565231521435487923/pdf/124354-Western-Balkans-Labor-market-trends-2018-final.pdf>
- Zogaj-Gashi, B., Ajeti, S. dhe Beqiri, G. (2019), *Investimi i huaj i drejtpërdrejtë në Kosovë: Klima e investimeve, potenciali dhe barrierat*, Instituti për ekonomi të tregut të lirë (IETL): <https://www.kas.de/documents/286052/0/19-12-24+Foreign+Direct+Investment+in+Kosovo+-+The+Investment+Climate%2C+Potential+and+Barriers+%28ENG%29.pdf/b62d78dc-7871-1625-493c-7348e6b15560?version=1.0&t=1580216557746>

Aneksi 1 – Analiza statistikore e qasjes së grupit

Ekzistojnë statistika shumë të kufizuara zyrtare të migrimit për Kosovën, posaçërisht për sa i përket përbërjes së shkathtësive të migrantëve. Prandaj, për këtë raport, të dhënat mbi migrimin neto janë përafëruar dhe llogaritur përmes një qasjeje të grupit që i identifikon dhe përcjell grupmoshat me kalimin e kohës (për më shumë shpjegime, shih Leitner 2021).

Qasja e grupit mbështetet në idenë se në mungesë të lindshmërisë dhe vdekshmërisë, çdo ndryshim në popullsi është rezultat i migrimit, në mënyrë që dinamika e migrimit të mund të nxirret nga ndryshimet në popullsi që shihen në statistikat zyrtare. Ajo i përdor të dhënat e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), modeli rrrotullues i të cilës nuk lejon që një person të gjurmohet me kalimin e kohës, por skema e shtresimit dhe ponderimit e të cilës lejon identifikimin e grupeve përfaqësuese (grupmoshat) që mund të ndiqen me kalimin e kohës.

Duke pasur parasysh lindshmërinë zero dhe në mungesë të vdekshmërisë (substanciale), dallimet në madhësinë e një grupmoshe ndërmjet dy vjetëve radhazi japin një përafrim të mirë të migrimit neto (specifik për grupin) në një vit. Në këtë kontekst, një rritje në madhësinë e një grupmoshe është tregues i imigrimit neto ndërsa, anasjelltas, një rënie në madhësinë e një grupmoshe është tregues për emigrimin neto. Qasja i përdor të dhënat kombëtare të AFP-së për vitet 2010 deri në 2019 dhe përqendrohet në grupin e personave të moshës 15–39 vjeç, që karakterizohet nga lindshmëria zero, vdekshmëria e ulët dhe dinamika e fortë e migrimit. Në vitin e parë të periudhës që është duke u analizuar, popullata e mostrës është ndarë në pesë grupe të ndryshme pesëvjeçare: 15–19, 20–24, 25–29, 30–34 dhe 35–39, dhe secili grup më pas ndiqet me kalimin e kohës deri në vitin 2019.

Çdo vit, duke filluar nga viti 2011, një grup i ri i të rinjve të moshës 15 vjeç hyn në popullsinë e anketës (si të porsaardhur) dhe plakët për një vit. Secili grup i porsaardhur nga viti 2011 e tutje (d.m.th. ata që arrijnë moshën 15 vjeçare në nivelin e hyrjes në vitin 2011, 2012 etj.) ndiqet gjithashtu ndaras në baza vjetore deri në vitin 2019 për të garantuar që të gjitha grupmoshat përkatëse, përfshirë ata që janë më të rinj se grupmoshat e lartpërmendura pesëvjeçare (dhe që gjithashtu do të ishin pjesë e fuqisë punëtore potenciale), kapen dhe vlerësohet edhe migrimi neto i grupmoshave të porsaardhura. Për shkak të dinamikës më të fortë të migrimit në vitet e mëvonshme, vetëm ata individë që janë 18 vjeç ose më të vjetër janë analizuar për secilin nga grupet e porsaardhura.

Përveç qasjes së grupit të zbatuar për grupin e personave të moshës 15–39 vjeç, ne e zbërthejmë më tej informacionin në katër nivele të arritjes arsimore: i ulët (arsimi fillor ose i mesëm i ulët), i mesëm i përgjithshëm (arsimi i mesëm i lartë i përgjithshëm/gjimnazi), AAP i mesëm (arsimi dhe aftësimi profesional i mesëm i lartë), dhe i lartë (arsimi terciar).

Nga analiza e kryer në nivel më të detajuar të arritjes arsimore/ISCED, ndryshimet komplekse vërehen në përbërjen e shkathtësive/arsimit, veçanërisht ndërmjet dy grupmoshave më të reja dhe të porsaardhurve. Këto ndryshime shoqërohen me kalimet arsimore në nivele të arsimit më të lartë pasi individët diplomojnë në njërin nga dy nivelet e arsimit të mesëm dhe kalojnë ose nga AAP e ulët në të mesme të përgjithshme (gjimnaz) ose AAP të mesëm (arsim i mesëm i lartë i AAP-së) ose diplomojnë nga studimet terciare dhe më pas avancojnë nga AAP i mesëm i

përgjithshëm ose i mesëm në të lartë. Këto tranzicione arsimore janë korrigjuar përmes statistikave të detajuara të arsimit në mënyrë që të mos i atribuohen gabimisht migrimit neto.

Aneksi 2 – Tabelat statistikore

Tabela A1: Numri i lejeve të qëndrimit dhe i atyre që e morën shtetësinë, 2008–2018

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Numri i shtetasve të Kosovës me leje të vlefshme qëndrimi brenda BE-28 në fund të çdo viti	40 459	132 170	166 492	198 942	220 954	253 085	286 418	278 385	301 036	304 492
Numri i shtetasve të Kosovës që morën shtetësinë e një shteti anëtar të BE-së	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	n.d.	6 573	6 814	8 756	9 538	8 150
Numri i qytetarëve të Kosovës që janë aplikantë për herë të parë për azil brenda BE-28	n.d.	9 775	11 725	7 550	7 165	16 690	34 115	66 885	9 170	5 320

Burimi: Eurostat

Tabela A2: Numri i shtetasve të Kosovës që e morën shtetësinë e një shteti anëtar të BE-së, 2013–2017

2013	2014	2015	2016	2017
6 573	6 814	8 756	9 538	8 150

Burimi: Eurostat

Tabela A3: Lejet për herë të parë që u janë lëshuar qytetarëve të Kosovës, 2010–2019

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	
BE-27 shtete (nga viti 2020)	16 549	14 803	16 018	17 316	17 714	18 958	20 668	25 933	34 591	
BE-28 shtete (2013–2020)	16 867	15 104	16 232	17 526	18 062	19 270	21 009	26 168	34 727	
Belgjikë	998	721	476	403	395	471	377	393	496	
Bullgari	10	15	11	16	23	41	34	46	45	
Çeki	108	36	102	133	123	249	264	153	205	
Danimarkë	71	52	47	62	63	52	40	71	59	
Gjermani (deri në vitin 1990, ish-territori i RFGJ-së)	3 735	3 303	6 346	7 846	8 260	8 260	10 020	14 480	18 986	
Estoni	0	0	0	0	4	0	5	5	n.d.	
Irlandë	18	38	27	42	23	41	24	15	27	
Greqi	16	41	22	26	65	49	42	54	n.d.	
Spanjë	0	0	0	0	0	0	0	0	n.d.	
Francë	1 194	1 647	1 864	1 528	1 576	1 740	2 094	2 044	2 002	
Kroaci	n.d.	n.d.	n.d.	193	195	185	195	339	2 065	
Itali	5 978	4 126	2 961	2 461	2 078	2 786	2 599	2 677	2 842	
Qipro	0	0	0	0	0	0	0	0	n.d.	
Latvi	2	4	1	1	0	0	0	0	n.d.	
Lituani	2	2	1	2	0	0	0	1	n.d.	
Luksemburg	49	102	127	148	113	133	153	132	100	
Hungari	198	284	369	0	0	0	0	0	526	
Maltë	0	0	0	0	0	0	0	11	n.d.	
Holandë	62	72	79	111	75	62	102	85	98	
Austri	1 614	1 988	2 198	1 713	1 763	1 877	1 844	1 316	1 293	
Poloni	175	22	18	24	34	40	97	478	251	
Portugali	4	3	1	2	3	11	1	16	n.d.	
Rumani	0	0	0	0	0	0	0	0	n.d.	

Slloveni	1 118	1 075	15	1 246	1 555	1 612	1 397	2 016	3 819
Sllovaki	0	0	9	7	8	5	14	12	7
Finlandë	185	224	249	336	372	326	352	414	376
Suedi	1,012	1 048	1 095	1 016	986	1 018	1 014	1 175	1 335
Mbretëri e Bashkuar	318	301	214	210	348	312	341	235	136
Islandë	15	7	8	10	9	9	9	9	15
Lihtenshtajn	n.d.	n.d.	n.d.	34	17	23	17	22	n.d.
Norvegji	106	165	205	147	150	187	227	167	191
Zvicër	n.d.	n.d.	2 301	2 619	2 020	2 282	2 256	2 339	2 490

Burimi: Eurostat, 2020, nxjerrë më 22 shtator 2020, marrë nga: https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=migr_resfirst&lang=en, 27 janar 2021

Tabela A4: Lejet për herë të parë

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
BE-28 shtete (2013–2020) ^a	16 867	15 104	16 232	17 526	18 062	19 270	21 009	26 168	34 765
3–5 muaj	1 126	896	1 027	844	847	1 120	1 293	1 074	1 413
6–11 muaj	6 869	5 263	5 518	6 608	6 463	5 255	7 093	8 862	11 494
12+ muaj	8 872	8 945	9 687	9 903	10 343	12 591	12 185	16 088	21 858
Në %	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
3–5 muaj	7%	6%	6%	5%	5%	6%	6%	4%	4%
6–11 muaj	41%	35%	34%	38%	36%	27%	34%	34%	33%
12+ muaj	53%	59%	60%	57%	57%	65%	58%	61%	63%

Burimi: Eurostat^a për disa prej migrantëve, kohëzgjatja nuk dihej.

Tabela A5. Shkalla e punësimit dhe papunësisë sipas nivelit të arsimit, 2019, në %

	Shkalla e punësimit	Shkalla e papunësisë
Pa shkollim formal	3.7	49.4
Fillor	12.4	32.0
Arsim i mesëm, profesional	37.7	25.2
Arsim i mesëm, i përgjithshëm (gjimnaz)	28.6	27.0
Terciar	62.2	21.5
Gjithsej	30.1	25.7

Burimi: ASK, AFP 2019

Tabela A6: % e nxënësve që nuk e arritën nivelin minimal të kompetencës në rezultatet e PISA-s, 2015 dhe 2018

	2015	2018
Lexim	76.9	78.7
Matematikë	77.7	76.6
Shkenca	67.7	76.5

Burimi: PISA 2015 dhe 2018

Tabela A7: Përbërja e popullsisë së punësuar sipas profesioneve, 2014–2019

	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Profesioni i të papunëve, 2017
Ligjvënës, zyrtarë të lartë, menaxherë	8.2	8.6	7.6	7.1	7.2	8.8	4.2
Profesionistë	16.7	17.0	13.8	13.8	18.0	15.9	9.7
Teknikë/profesione të lidhura me ta	7.5	6.9	7.4	7.5	4.4	6	1.3

Nëpunës	4.7	5.2	5.5	5.7	5.9	5.8	5.1
Punëtorë shërbyes dhe punëtorë shitës në dyqane dhe tregje	18.4	17.4	18.1	18.2	25.2	23.3	31.3
Punëtorë të kualifikuar në bujqësi dhe peshkatari	1.5	0.9	2.2	3.1	2.6	2.8	0.6
Punëtorë zejtarie dhe të ngjashëm me ta	14.9	14.2	16.4	15.0	12.8	10.6	17.4
Operatorë fabrikash dhe makinerish dhe montues	6.8	6.7	6.9	5.8	5.1	5.7	6.8
Profesione elementare	21.2	21.1	22.0	23.9	18.8	21.1	23.6

Burimi: ASK, AFP 2014–2019 për profesionet e të punësuarve dhe anketa e MCC LFTUS 2017 për profesionet e të papunëve

Tabela A8: Personat që e braktisin shkollën para kohe (% e moshës 18–24 vjeç)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjithsej	18.4	18.4	16.5	14.5	12.7	12.2	9.6	8.2
Meshkuj	15.7	16.0	14.2	11.8	11.0	11.4	9.3	8.0
Femra	21.6	21.0	19.0	17.5	14.6	13.1	9.9	8.4

Burimi: ASK, AFP (ETF, 2020a)

Tabela A9: Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk shkojnë në shkollë apo në trajnim (NEETs) (% e moshës 15–24)

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjithsej	35.1	35.3	30.2	31.4	30.1	27.4	30.1	32.7
Meshkuj	30.7	30.0	26.6	28.3	26.5	23.8	30.2	31.4
Femra	40.1	40.9	34.0	34.9	34.2	31.4	30.0	34.2

Burimi: ASK, AFP (ETF, 2020a)

Tabela A10: Numri i studentëve të regjistruar në arsimin e lartë, sipas viteve dhe institucioneve publike/private

	IAL publik					IAL privat					Gjithsej
	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Viti V	
2015/2016	21 054	14,594	21 629	5 466	65	12 472	12 380	10 582	2 957	760	101 959
2016/2017	20 532	15 688	19 858	6 284	355	14 025	12 144	12 915	2 593	188	104 582
2017/2018	19 795	14 131	18 772	6 789	n.d.	11 697	11 380	10 011	2 799	62	95 436
2018/2019	19 883	11 854	18 073	7 160	891	13	9	9	1	34	57 927
2019/2020	15 415	10 593	16 094	6 755	795	5 046	4 555	3 631	21	n.d.	62 905

Burimi: Statistikat e Arsimit të ASK-së

Tabela A11: Numri i të diplomuarve BA nga IAL-të publike dhe private

	IAL-të publike			IAL-të private					
	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Gjithsej
2014/2015	3 621	2 361	6 036	n.d.	n.d.	n.d.	3 621	2 361	6 036
2015/2016	4 651	2 709	7 360	2 645	2 695	5 340	7 296	5 404	12 700
2016/2017	4 766	2 405	7 171	1 462	1 259	2 721	6 228	3 664	9 892
2017/2018	5 065	2 651	7 716	1 385	962	2 347	6 450	3 613	10 063
2018/2019	4 785	2 523	7 308	945	575	1 520	5 730	3 098	8 828

Burimi: Statistikat e arsimit të ASK-së

Shënim: n.d. tregon që të dhënat për arsimin e lartë privat mungojnë për vitin akademik 2014/15.

Tabela A12: % e studentëve në programet profesionale prej numrit të përgjithshëm të nxënësve të shkollave të mesme të larta (niveli ISCED 3), 2010–2018

	2010	2011	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	55.4	55.3	56.7	50.1	50.8	52.6	53.2	52.9
Meshkuj	61.8	61.3	63.3	58.0	58.8	60.7	61.7	61.5
Femra	47.7	48.2	49.0	41.1	41.9	43.8	44.3	44.1
Numri i nxënësve	2010	2011	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	57 386	58 981	55 800	41 940	42 600	45 462	46 205	42 888
Meshkuj	35 073	35 360	33 422	25 758	25 877	27 204	27 389	25 325
Femra	22 313	23 621	22 378	16 182	16 723	18 258	18 816	17 563

Burimi: MASHT/ASK, EMIS

Tabela A13. Pjesëmarrja në trajnim/mësim gjatë tërë jetës (% të moshës 25-64 vjeç), 2012–2019

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjithsej	4.1	4.3	4.9	4.9	4.4	3.9	3.5	2.7
Meshkuj	4.6	5.1	5.8	5.9	5.1	4.6	3.5	2.9
Femra	3.6	3.6	4.0	3.8	3.7	3.2	3.5	2.6

Burimi: ASK, Anketa e fuqisë punëtore, marrë nga ETF-ja (2020a dhe 2020c)

Tabela A14: Vlerësimet e popullsisë, 2012–2018

	Popullsia e përgjithshme	Popullsia e moshës për punë	Përqindja e popullsisë e moshës për punë	Popullsia e moshës 65+	Përqindja e popullsisë e moshës 65+
2012	1 807 126	1 189 019	66%	126 692	7%
2013	1 811 372	1 191 630	66%	141 085	8%
2014	1 811 521	1 202 489	66%	149 797	8%
2015	1 757 843	1 176 147	67%	152 599	9%
2016	1 771 604	1 184 529	67%	165 991	9%
2017	1 793 466	1 200 165	67%	188 498	11%
2018	1 793 467	1 198 273	67%	203 039	11%

Burimi: ASK, AFP 2012–2018

Tabela A15: Popullsia e Kosovës sipas grupmoshave dhe vitit, 2017–2061 (variant mesatar)

Viti	Popullsia sipas grupmoshës			
	Total	0–14	15–64	65+
2017	1 783 531	446 633	1 192 181	144 718
2021	1 809 458	431 526	1 211 592	166 341
2031	1 818 674	364 294	1 217 592	236 787
2041	1 759 492	290 436	1 150 779	318 277
2051	1 652 090	247 855	1 034 147	370 088
2061	1 492 192	199 518	892 803	399 871

Burimi: ASK 17, f. 21

Tabela A16. Regjistrimi në shkollën e mesme profesionale sipas fushës së studimit dhe gjinisë

Numrat sipas fushës së studimit	2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18
ART Gjithsej	958	424	461	795	125
Meshkuj	742	176	237	210	41

	Femra	216	248	224	585	84
BUJQËSI	Gjithsej	26 082	1 633	4 087	2 031	1 239
	Meshkuj	11 747	1 125	2 740	1 134	858
	Femra	14 335	508	1 347	897	381
EKONOMI	Gjithsej	14 463	9 049	15 685	10 824	17 030
	Meshkuj	8 486	4 592	7 767	5 772	9 464
	Femra	5 977	4 457	7 918	5 052	7 566
MJEKËSI	Gjithsej	3 480	6 493	4 427	8 868	8 092
	Meshkuj	2 636	2 014	1 424	3 508	2 617
	Femra	844	4 479	3 003	5 360	5 475
MUZIKË	Gjithsej	1 474	437	492	597	684
	Meshkuj	639	200	222	317	284
	Femra	835	237	270	280	400
TEKNIK	Gjithsej	m	21 246	16 325	20 137	16 118
	Meshkuj	m	15 663	12 589	14 949	12 141
	Femra	m	5 583	3 736	5 188	3 977
TREGTI	Gjithsej	2 196	3 162	1 496	2 838	3 395
	Meshkuj	1 321	2 335	1 167	1 774	2 310
	Femra	875	827	329	1 064	1 085
në %		2013/14	2014/15	2015/16	2016/17	2017/18
ART	Gjithsej	2%	1.0%	1.1%	1.7%	0.3%
	Meshkuj	2%	0.7%	0.9%	0.8%	0.1%
	Femra	1%	1.5%	1.3%	3.2%	0.4%
BUJQËSI	Gjithsej	47%	3.8%	9.5%	4.4%	2.6%
	Meshkuj	35%	4.3%	10.5%	4.1%	3.1%
	Femra	65%	3.1%	8.0%	4.9%	2.0%
EKONOMI	Gjithsej	26%	21.3%	36.5%	23.5%	36.4%
	Meshkuj	25%	17.6%	29.7%	20.9%	34.1%
	Femra	27%	27.3%	47.1%	27.4%	39.8%
MJEKËSI	Gjithsej	6%	15.3%	10.3%	19.2%	17.3%
	Meshkuj	8%	7.7%	5.4%	12.7%	9.4%
	Femra	4%	27.4%	17.8%	29.1%	28.8%
MUZIKË	Gjithsej	3%	1.0%	1.1%	1.3%	1.5%
	Meshkuj	2%	0.8%	0.8%	1.1%	1.0%
	Femra	4%	1.5%	1.6%	1.5%	2.1%
TEKNIK	Gjithsej	m	50.1%	38.0%	43.7%	34.5%
	Meshkuj	m	60.0%	48.1%	54.0%	43.7%
	Femra	m	34.2%	22.2%	28.2%	20.9%
TREGTI	Gjithsej	4%	7.4%	3.5%	6.2%	7.3%
	Meshkuj	4%	8.9%	4.5%	6.4%	8.3%
	Femra	4%	5.1%	2.0%	5.8%	5.7%

Burimi: MASHT, EMIS

Shënim: m qëndron për të dhënat që mungojnë.

Aneksi 3 – Sistemi i Kosovës për arsim dhe aftësim

